

Tetor 2019
Numri: 139
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

NAMAZI ËSHTË DRITË





revistaetika



progresibotime

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 2 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*



Tetor 2019

VITI: XIII
NUMRI: 139

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Aradian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 45 639 143
Prishtinë; Kosovë
Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar
Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Namazi që nga fillimi e deri në fund përfshin të gjitha llojet e dhikrit. Namazi është një dhikër gjithëpërfshirës me leximin e Kuranit Fisnik, madhërimin e Zotit, tekbiuret, tesbihet, lutjet dhe përgjërimin. Madje, ai mund të jetë dhikri më i madh. Namazi është një lloj dhikri i atillë që zemrat e arrijnë prehjen shpirtërore vetëm me të.¹ Zemra është qendra e perceptimit, mendimit dhe vetëdijes. Nëse kjo qendër është e fuqishme, atëherë ndjenjat janë pozitive dhe të ekuilibruara. Gjithashtu, edhe mendja dhe perceptimi shpëtojnë nga të qenët robër të dëshirave të padobishme. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar na ka njoftuar se "ata të cilët e falin namazin në kuptimin e vërtetë, do të kenë një mbrojtje kundrejt ndjenjave të ulëta, sjelljeve të pahijshme dhe çdo lloj ligësie që nuk përputhet me mendjen e shëndoshë".²

Namazi për shkak se është një ibadet mbrojtës, ruajtës dhe orientues drejt ndjenjave sublime, është një adhurim që kërkohet të fillohet që nga mosha e pubertetit e të vazhdojë deri në fund të jetës. Virtytet që namazi ia jep njeriut në çdo moshë dhe në çdo gradë janë të ndryshme. Nisur nga këto që thamë, çdo namaz është i ndryshëm në aspektin shpirtëror edhe pse është i njëjtë në formë. Andaj, edhe frytet e tij janë të ndryshme sipas njeriut dhe periudhave të jetës së këtij të fundit.

Veçanërisht periudha e rinisë së njeriut është një kohë kur ndjenjat arrijnë pikën kulmore. Ngjitjet dhe zbritjet janë absolute. Mbajtja e ekuilibrit në këtë periudhë është shumë më e vështirë. Ja namazi, edhe pse është i rëndësishëm për çdo moshë, ai shfaq një rëndësi shumë më të madhe në periudhën e rinisë për sa i përket aspektit të ruajtjes së personalitetit dhe zhvillimit të shëndetshëm. Nëse qëllimi i krijimit është që të jemi robër prej të cilëve është i kënaqur Allahu Teala brenda kornizës së aftësive dhe përgjegjësive që na ka dhënë Zoti, atëherë esencën e këtij nënshtrimi e përbëjnë besimi dhe tevhidi. Ndërsa shtyllën kryesore e përbën namazi. Për këtë arsye, është thënë: "Feja pa namaz nuk mund të jetë fetarizëm." Fakti që i Dërguari i Allahut (a.s.), ka kërkuar në lutjet e tij që brezat e ardhshëm të takohen me namazin, bazohet mbi këtë urtësi. Tashmë le të japim një recetë udhëzimi që një i urtë ia ka dhënë një të riu që ndjente dobësi dhe plogështi në çështjet fetare:

"Bir! Le të përqipemi t'i falim namazet me xhemat."

Po, namazi është kthimi i vetes në natyrshmërinë e saj. Për t'ju kthyer përsëri pastërtisë dhe dëlirjes së natyrshmërisë, për t'i rinovuar ndjenjat dhe për të hyrë në drejtimin e duhur, duhet ta drejtojmë trupin dhe zemrën nga kibla dhe Krijuesi i tyre.

Njëra prej cilësive më themelore që domosdo duhet të fitohet në rini është vetëdija dhe përgjegjshmëria për t'i falur në mënyrë të rregullt pesë kohët e namazit. Pjekuria e një rinie që i nxihet jeta kur i ikën një namaz dhe i mbetet për kaza është një pjekuri e shëndetshme. Një vetëdije e tillë e ndërton edhe personalitetin në formën më të mirë. Ata që takohen me Zotin në audiencën hyjnore pesë herë në ditë, sigurisht që Ai do ta edukojë dhe pastrojë në atë formë që është i kënaqur. Atëherë ajo që duhet të bëjmë është që ta perceptojmë namazin, ta duam dhe ta falim në formën që e ka falur i Dërguari i Allahut (a.s.).

1. Ra'd, 28.

2. Ankebut, 45.

Përmbajtja


Thirrje të rinjve për namaz
O të rinj! Ejani në namaz
Abdullah Jëlldëz

12



8

Besimtar i ri! Ti je ndryshe
Nuredin Jëlldëz



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34



14

26

Përsëri pendim,
përsëri pastrim nga mëkatet
Vahid Gektash



5 Bir!

Ahmet Tashgetiren

10 Drejtimi i kiblës për drejtimin e jetës
Dr. Adem Ergyl

14 Rëndësia e namazit

Prof. dr. Sulejman Derin

16 Të rinj që janë ndriçimi i syve
dhe namazi që është drita e syve
Ibrahim Bozbeshpamak

19 Sjellja e Imam Ebu Hanifes

Ali Riza Temel

22 Predikimi i Islamit nga umeti

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

24 Diçka që të afron te Allahu

M. Sami Ramazanollu

25 Namazi i cili na mbron nga mëkatet

Sadik Dana



19

Ai (a.s.) është udhëzuesi edhe për pastrimin e nefsit 29

Prof. dr. Mustafa Karabaxhak

Thesaret e humburua 30

Ferudun Ozdemir

Një Ajet - Një Hadith 32

Esh-Shekur 42

Ilir Hoxha

Një udhëtim me Sheherazaden 46

Nuredin Nazarko

Kultura e televizorit 47

Zahit Genç

Krenohu me Islamin 50

Ferit Piku

Pema e krasitur 54

Kybra Çoban

A ekziston te fëmija ynë

vështirësia në të mësuar?

Psik. Tuba Sëkmen

44



Sahabi bujar
Ebu'd Dähdah
Mustafa Erish

Kujtesa është çlirim
Edison Çeraj

48

BIR!

— Ahmet Tashgetiren —

Bir! Po dëshiroj të të shkruaj me përgjegjësinë e jetës pesëdhjetëvjeçare prej shkrimtari. Po dëshiroj të të shkruaj duke mos marrë parasysh se ku, në cilën kulturë apo në cilin rreth shoqëror gjendesh. Po dëshiroj të të shkruaj pa marrë parasysh se “fëmija i kujt je”. Po dëshiroj të të shkruaj vetëm duke marrë parasysh se je “fëmija i këtij vendi” dhe je “fëmijë njeriu”. Po dëshiroj të të shkruaj për të arritur te zemra jote e re.


Bir! Bëj kujdes dhe mos u huto. Mos e shiko këtë shkrim si të çuditshëm. Mos pyet se përse po më shkruan mua. Mos ma ndërprit fjalën që në fillim, duke thënë: “Përse dëshiroj të të flas?!”

Bir! Do të të ftoj për të falur namaz. Eja ta shohim njëri-tjetrin në sy. Eja t’ia hapim zemrën njëri-tjetrit. Bir! Zemrës tënde aktive i duhet emocioni i një namazi të gjallë. Namazi më së shumti të duhet ty, bir. Lutja më së shumti të duhet ty. Mos pandeh se mund të qëndrosh në

audiencën e Allahut Teala kur të plakesh. Mos pandeh se duart mund të ngrihen lart për të bërë lutje kur të plaken dhe të fillojnë të dridhen. Mos pandeh se të drejtuarit te Krijuesi është punë e atyre që janë të sëmure, e atyre që nuk rrinë dot në këmbë, e atyre që rrëzohen dhe e atyre që janë të dobët.

Pa shiko se i drejtohesh tësimi ndjen kur t’ia drej- Pa shiko se këtyre.

Bir! Ti varësisht se Ti je fëmija drejtohem të mi. Ti je i të bëj thirrje mazit, mos u vazhdoje na-përjetoje na- je fëmija i këtij umeti pakush janë prindërit e tu. i të gjithë neve. Ty po të siç u drejtohem fëmijëve yni. Për këtë arsye, po nga zemra. Drejtoju nashkëput nga namazi, mazin, fale namazin, mazin dhe mos rri pa



falur namaz. Domethënë, mos u shkëput nga Zoti, takohu me Zotin, lidhu me Zotin dhe përkujtoje Zotin. Namazi përbëhet prej të gjitha këtyre. Namazi është marrëdhënia jote me Zotin (xh.xh.).

Bir! Të përjetosh namazin do të thotë të qëndrosh i gjallë në këtë jetë, nëse e kupton. A është e mundur që të zvarritet për toke një njeri që ngrihet pesë herë në këmbë për çdo ditë? Pesë herë në ditë pastrohesh nga jashtë dhe nga brenda. A është e mundur të jesh i ndyrë në këtë situatë? A mund të ketë gjëra të ndyra apo papastërti te dikush që i pastron duart, fytyrën, veshët, gojën, gjuhën, kokën dhe mendjen nga papastërtitë e dukshme dhe të padukshme? Bir, namazi ta bën botën të ndritshme. Bota e namazit është bota në të cilën pastrohesh me ujë pesë herë në ditë dhe në të cilën arrin një pjekuri shpirtërore të dëlirë si uji.

Ti i drejtohesh kibles kur bëhesh gati për të falur namazin dhe e ripërtërin nijetin. Pesë herë në ditë

BIR! MENDO SIKUR PËR MOMENTIN JE NË NAMAZ. SUPIN E KE NGJITUR ME SUPIN E VËLLAIT TJETËR QË GJENDET PRANË TEJE. NAMAZIN PO E FAL ME NJË ZEMËR PLOT GJALLËRI. NË RRESHTAT E BESIMTARËVE KE VENDOSUR NJË ZEMËR KREJT TË GJALLË. GJYSHI ME MJEKËR TË BARDHË QË KE NË ANËN TJETËR MERR KURAJË PREJ TEJE, POR TI NUK E DI KËTË. I MOSHUARI QË MEZI QËNDRON NË KËMBË, MERR KURAJË PREJ TEJE. NJERIU QË E KA HUMBUR DRITËN E SYVE, I DUKET SIKUR PO E SHEH PËRSËRI KËTË BOTË KUR NDJEN SE TË KA AFËR TY. TI E USHQEN XHAMINË, BIR!

e ndjen se duhet të jesh në rrugën e drejtë. Pesë herë në ditë i jep zemrës edukimin shpirtëror. Në namazin e të riut nuk gjendet pavendosmëri dhe mendja e të riut nuk është e shpërqendruar. I riu mund të qëndrojë më fort në rrugën e drejtë. Në këtë moshë mund të ecësh drejt, mund të ecësh me vendosmëri dhe mund të shkosh drejt Zotit (xh.xh.).

Tashmë e kupton vlerën e kohës. Andaj pajisu me vetëdijen e faljes së namazit. Koha për një njeri që e fal namazin është një kalendar që sipas të cilit duhet të qëndrohet në audiencën e Allahut të Lartësuar. Koha nuk mund të çohet dëm. Koha është vetëdije. Koha është takim. Koha është vetë jeta. Koha është një amanet që kërkon kujdes edhe për sekondat e saj. Koha është disiplinë.

Bir! Nëse do të mendosh vetëm për momentet kur përgatitesh për namazin pesë herë në ditë, do të vësh re se edukimi hyjnor që të jepet ta mundëson të ndërtosh një njeri krejt aktiv. Ndryshimi ndërmjet njeriut që përgatitet pesë herë në ditë për namazin dhe atij që nuk përgatitet, është se i pari i përjeton ato që thashë më sipër, kurse i dyti jo.

Ti vazhdimisht duhet të qëndrosh në audiencën e Zotit tënd. Ti vazhdimisht duhet të thuash “Allahu ekber”. Ti duhet të marrësh një vetëdije superiore dhe sublime, sepse zemra e lirë e njeriut që beson jehon me të madhe: “Allahu ekber!”

Allahu është më i lartë se çdo gjë. Ai është më i lartë se ti dhe unë. Ai është më i lartë se të gjithë të fuqishmit. Allahu është Ai që e jep të gjithë fuqinë dhe që e dhuron rininë. Andaj shprehja “Allahu ekber” duhet të jehojë me zërin tënd. Sa shumë që të ka hije! Andaj thuaje me të madhe. Thuaje me të madhe këtë në audiencën e Zotit (xh.xh.). Le të lartësohet zëri yt drejt qiejve. Le të thotë zemra jote “Allahu ekber”.

Mendo sikur për momentin je në namaz. Je në audiencën e Zotit (xh.xh.). Pra, Zoti të ka thirrur dhe ti ke shkuar. Ti i thua Atij: “Erdha, o Zoti im! Ty nuk të kam harruar. Gjithashtu nuk e kam harruar edhe premtimin që të kam dhënë. Të kam ardhur me duar të pastra. Të kam ardhur pasi e kam pastruar botën e jashtme dhe të brendshme. Të kam ardhur duke i kapërcyer të gjitha pengesat. Të kam ardhur duke e mbrojtur zemrën nga ndikimet negative. Tashmë dëshiroj të kthehem prej këtu duke formatuar çdo gjë nga e para. Pra, dëshiroj të kthehem duke pasur një vullnet më të fortë dhe një vetëdijesim më të qartë.”



Mendo sikur për momentin je në namaz. Je duke kënduar suren Fatiha. Je duke iu përgjyruar Zotit (xh.sh.). Je duke iu lutur Atij. Je duke kënduar Kuranin. Je duke iu drejtuar një Qenieje që e ndjen se gjendet përballë teje. Pra, je duke iu drejtuar Krijuesit. Pra, pothuajse po flet me Të.

Ndijeje këtë afrimitet, bir! Kur të përfundosh namazin, formo kontakt me Fuqinë që iu afrove kaq shumë dhe që të kanë dhënë çdo gjë duke përfshirë këtu edhe rininë. Andaj, ndijeje këtë afrimitet, në mënyrë që atje (në botën e përtejme) të të jepet rinia e përhershme, të të jepet fuqia për të fluturuar në horizonte, të të jepet fuqia për t'u ngjitur sa më lart, të të jepet krenaria, të të dhurohet fisnikëria dhe të të falet fuqia.

Bir! Mendo sikur për momentin je në namaz, je duke qëndruar në kijam (qëndrimi në këmbë përgjatë namazit), je duke u lutur dhe je duke iu përgjyruar Zotit (xh.xh.). Ti sapo the: "Ijjake na'budu ve ijjake nestein / vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë." Zotit të Madhëruar iu drejtove me "Ti", sepse Ai të ka falur një gjuhë afrimiteti të tillë. Ti tashmë sapo u zhveshe nga të gjitha llojet e robërimit dhe ia shprehe Allahut Teala se je rob vetëm i Atij. Andaj, vetëm dera e Zotit është dera në të cilën mund të kërkohet ndihmë.

Bir! Mendo sikur për momentin je në namaz. Në ballin tënd gjendet gjurma e sexhdes. Të rinjtë e parë që e kapnin për dore të Dërguarin e Allahut (a.s.), ishin si kallinj të grurit. Me gjurmën që ke në ballë, edhe ti po u ngjan atyre.

Bir! Mendo sikur për momentin je në namaz. Supin e ke ngjitur me supin e vëllait tjetër që gjendet pranë teje. Namazin po e fal me një zemër plot gjallëri. Në rreshtat e besimtarëve ke vendosur një zemër krejt të gjallë. Gjyshi me mjekër të bardhë që ke në anën tjetër merr kurajë prej teje, por ti nuk e di këtë. I moshuari që mezi qëndron në këmbë, merr kurajë prej teje. Njeriu që e ka humbur dritën e syve, i duket sikur po e sheh përsëri këtë botë kur ndjen se të ka afër ty. Xhamia ushqehet prej teje, bir! Nëse nuk do të shkosh ti, xhamitë ngelin të uritura. Madje, ngelin të përmalluara për zemrat e gjalla.

Bir! Fale namazin! Fale namazin sikur po i përgjigjesh thirrjes së të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, hyr në rresht sikur po të fut ai me dorën e tij, jep tekbiir sikur po falesh pas Pejgamberit (a.s.). Ujdisja zemrën këtëj imami.

Se ku je tani, nuk mund ta di. Mos vallë je në rrugë, në ndonjë internetkafë, në ndonjë argëtim, apo diku tjetër. Këtë nuk e di. Namazi nuk është punë vetëm e imamit, bir. Namazi nuk është punë vetëm e atij të riu që marr edukim fetar. Namazi nuk është punë vetëm e fëmijëve të familjeve fetare. Namazi nuk është punë vetëm e atyre që lindin në Mekë dhe në Medine. Namazi nuk është punë vetëm e të varfërve dhe skamnorëve.

Kushdo qofsh dhe kudo qofsh, namazi po të thërret, bir. Nëse nuk duam ta shkëpusim lidhjen tonë me Krijuesin, atëherë nuk duhet ta shkëpusim duke filluar me namazin, bir.

Bir! Po sikur të ishe prej atyre që nuk e falin namazin? Po sikur t'i kishe harxhuar ditët dhe orët pa e kuptuar se po i harxhon? Të jetosh pa namaz do të thotë të mos e konceptosh kuptimin e jetës. "Përse ekziston vallë?!" A mund të jepet përgjigja e kësaj pa na e treguar Krijuesi? Me namaz realizon qëllimin e krijimit tënd. Ji i sigurt për këtë. Jeta nuk mund të lihet në mëshirë të fatit. Jeta nuk është diçka që mund të shpenzohet si para të shkoqura.

Nëse ia jep Krijuesit kohën më të vlefshme, edhe Ai (xh.xh.), do të të japë një jetë plot begati. Pastaj, do të gjesh kohë brenda kohës.

Të mos falësh namazin! Ta kalosh kohën e rinisë pa namaz! Kjo do të thotë t'i marrësh parasysh humbjet e mëdha pas dhjetë, njëzet, tridhjetë, dyzet apo pesëdhjetë viteve. Pastaj do të përpëlitesh për t'i kompensuar këto humbje, por vallë si mund të kompensohet të gjitha ato?

Bir! Fillo sot. Madje, fillo menjëherë tani. Nisu dhe shko drejt audiencës së Zotit (xh.xh.). Prej aty përpiqu që sexhdja të lërë gjurmë në ballin tënd. Përse ta lësh për më vonë? Mos u jep rëndësi fjalëve që thonë njerëzit. Fjalët si: "Çfarë pune ke ti me namazin dhe lutjet përderisa je i ri!", u përkasin armiqve të tu, të mi dhe të gjithë njerëzimit. Edhe pse këto fjalë dalin prej gojës së njerëzve, ato janë fjalë që i urdhëron shejtani për t'i thënë. Andaj, mos ua vë veshin atyre.

Ti vija veshin Zotit tënd. Ai është i Mëshirshmi dhe Mëshirëploti.

Thirrja "ejani në namaz, ejani në shpëtim" që thuhet kur bëhet ezani, le të jehojë edhe një herë tjetër brenda teje, bir i dashur. Namazet le të jenë gurët e kilometrave të udhëtimit tonë drejt shpëtimit, inshallah.



Besimtar i ri!

TI JE NDRYSHE

— Nuredin Jëlldëz —

Ti, o besimtar i ri! O besimtar i ri që je njeriu dinamik i këtij umeti të bekuar dhe shpresa e kauzës së tij! Ti je ndryshe.

Ti sot ekziston. Do të ekzistosh edhe nesër. Për këtë arsye, je ndryshe. Ti je fryti i djeshëm dhe shpresa e së nesërmes. Kur ti e mbron besimin, në fakt mbron edhe umetin. Kur ti thua “Allah”, nxjerr një zë më të pastër dhe të sigurtë. Kur ti thua “jam besimtar elhamdulillah”, e thua me gjithë shpirt, ngaqë jeta nuk ka arritur të të mposhtë me kamatën apo një mijë e një lloje haramesh të tjerash. Edhe ti i beson asaj fjale, edhe engjëjt. Për këtë arsye, Qabënë vazhdimisht e merr malli për ty dhe të tjerë si ti. Ti je ai që u ka hije më së shumti rrugëve të Medines. Ato rrugë janë mësuar me besimtarë si Ammari, Enesi, Zejdi dhe Usama. Frymëmarrjet e atyre përgjatë gjithë shekujve kanë qenë frymëmarrje për ne.

Andaj, ti je ndryshe, je krejt ndryshe me lejen e Allahut.

Pajisja jote me adhurime nuk i ngjan asnjë gjëje. Përderisa të jesh i pajisur me ibadete, i kalon edhe xhenetet dhe shkon drejt hijes së Arshit. Për këtë arsye, xhenetet janë të mbushura me emocionin tënd. Identiteti yt që nuk është mësuar me dyfytërsi, që nuk e ka përdorur gënjeshtrën dhe që nuk i ka hyrë në hak askujt, lartësohet drejt Arshit kur t'i vendosësh atij vulën e adhurimit. Sa njeri i begatë je ti, o i ri që kërkon hijen e Arshit të Allahut (xh. xh.)! Sa i begatë që je! Sa shpresë e madhe që je! Sa proces madhështor janë ditët e tua që rrjedhin nga e djeshmja për te e nesërmyja për ty, për prindërit e tu dhe për umetin!

Kur t'i bën ibadet, sytë e të gjithë engjëjve janë te ti. Kur ti bën sexhde, toka ndjehet sikur është lartësuar drejt teje. Kur ti bën dhikër, edhe gurët të dëgjojnë. Abdesti yt i pastron ndjenjat e tua. Ti je ndryshe, o besimtar i ri! Ty nuk të përshtatet asgjë përveç ibadetit në këtë botë. Parimet e tua janë namazi, rukuja dhe sexhdeja. Kur ti i shkatërron

barrikadat dhe idhujt me në krye nefsin, mban gjallë frymën e Ibrahimit (a.s.), në këto toka. Kur e mbron nderin, shndërrohet në Jusufin tonë. Andaj, ti je ndryshe, o besimtar i ri! Ti je një rob i pajisur me ibadet, i gjallëruar me namaz dhe i kthyer në origjinën e tij me sexhde. Andaj, xheneti është në pritjen tënde. Ti je mysafiri i Arshit.

Kur ti ngrihesh me vullnetin tënd për të falur namazin e mëngjesit, bëhesh diell në atë shtëpi ku gjendesh. Ekzistenca jote është shkak për begati. Kështu që bëhesh zgjidhje për problemet dhe dritë për sytë e të tjerëve. Nëna të do ngaqë je biri i saj. Ndërsa ky umet të do ngaqë je një dritë që ia ndriçon të ardhmen. Ti je ndryshe, o besimtar i ri. Namazi yt është ndryshe. Qëndrimi yt në krye të sixhadesë përgjatë namazit duket si qëndrimi i malit të Uhudit. Kur bie në ruku dhe në sexhde, dukesh si një hark që shigjetën ia ka drejtuar nefsit. Kur shejtani të shikon në atë gjendje, ndjehet i poshtëruar.

Ti je ndryshe, o besimtar i ri! Andaj, përpiku që vazhdimisht të jesh kështu ndryshe. Mos u lodh dhe mos u plogështo. Mos i neglizho adhurimet. Mos e prish moralin dhe bëj durim. Mbroje identitetin dhe emocionin duke bërë durim. Nëse ti plogështohesh, Zoti na ruajt, atëherë mërzhiten edhe engjëjt, edhe umeti. Andaj, duro derisa të takohesh me Zotin (xh.xh.), në hijen e Arshit. Abdesti le ta shfaqë durimin tënd. Ngrija jote për faljen e namazit të mëngjesit le të jetë legjendë për këto toka. Përgjatë rrugës që ti shkon në xhami, le të zbresë mëshirë në tokat tona. Andaj, ji burrë i përkushtuar ndaj namazit. Ji një i ri i përkushtuar ndaj namazit. Jeto me pjekurinë që të jep namazi. Namazet që i fal me frikërespekt ndaj Zotit (xh.xh.), le të të mbartin në një jetë plot prehje shpirtërore. Për të shpëtuar nga zjarri, sigurisht që do të falësh namaz, por mos harro se çdo namaz që fal në të njëjtën kohë është edhe një qëllim i madh që vazhdon ta realizojë edhe pas shumë shekujsh miraxhin e pejgamberit tënd, Muhamedit, alejhi's-selam. Kurdo që t'i i drejtohesh sixhadesë, do të rinovohet kuptimi i Kudsit dhe i lartësimit nga Kudsi drejt Miraxhit. Çdo namaz që ti e humbet, Zoti na ruajt, është si një tullë që bie nga Kudsi.

Ti je ndryshe, o i ri fisnik! Ibadeti të ka çliruar zemrën. Namazi të ka bërë t'i lësh pas gjërat e thjeshta të kësaj bote, të ka lartësuar dhe të ka çuar në pozitën e njerëzve si Enesi, Ammari dhe Usama. Andaj, bëj kujdes dhe mos u kthe pas nga vendet ku ke arritur. Ti qëndro atje dhe na prit edhe ne.

Andaj, selami qoftë për ty në çdo vakt që i drejtohesh namazit. Selami qoftë për ty kur të mos plogështohesh kundrejt nefsit dhe epshit të saj. Selami qoftë për ty kur të mos mashtrohesh nga dredhitë e shejtanit. Selami qoftë për ty përderisa ti e ruan namazin dhe namazi të lartëson ty. Allahu të ruajt siç e ruan ti namazin dhe adhurimin. Allahu të faltë te ky umet, o e ardhmja e namazit. Allahu të faltë e besimtari i ri që je shpresa e këtij umeti. Paqja e Zotit qoftë mbi ty.





DREJTIMI I KIBLËS për drejtimin e jetës

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Sadi Shirazi, i cili ka qenë prej dijetarëve të mëdhenj të traditës së mistikës, pyetjes: “Çfarë është njeriu?”, i është përgjigjur: “Njeriu është një pikë gjaku dhe një mijë e një shqetësime.” Po, ndërmjet dallgëve që formohen nga ndjenjat e ulëta dhe ato sublime, nxitjet, vesveset e brendshme e ato të jashtme, mendimet e ngatërruara, frika dhe shqetësimet, njeriu shpesh herë ngatërrohet, ndjenjat i bëhen lëmsh dhe si rezultat e ngatërron rrugën. Madje, ai ndoshta mund të shkojë drejt një dallge prej të cilës nuk mund të shpëtojë dot. Çdo periudhë ka dallgë me përmasa të ndryshme. Dallgët më të rrezikshme dhe më shkatërruese janë dallgët që fillojnë të shfaqen në adoleshencë dhe në periudhat e rinisë. Këto dallgë në përgjithësi nuk ndalen deri në moshën tridhjetë apo madje edhe dyzetvjeçare.

Anija e njeriut që lundron ndërmjet dallgëve të detit të jetës, në shumicën e rasteve mund të drejtohet jo nga jashtë, por me një mjeshtëri nga brenda. Ata të cilët nuk e kanë formuar ekuilibrin e tyre si individë, gjithmonë nuk është e mundur të administrohen nga jashtë. Edhe pse Allahu i Lartësuar ka dërguar udhërrëfyes (pejgamberë) dhe libra që na mësojnë rrugën e drejtë, prapëseprapë ka kërkuar që njeriu të ecë vetë dhe të shkojë drejt qëllimit. Brenda njeriut ka vendosur një busull (zembrën), me të cilën mund ta konceptojë e shikojë rrugën e drejtë dhe mund të lidhet me të vërtetën. E rëndësishme është që kjo busull të ruhet pa u dëmtuar, të mbahet në gjendje pune dhe të merren informacionet për funksionimin e saj.

Busulla e zemrës funksionon në vartësi të raportit që robi formon me Allahun (xh.xh.). Ky raport apo kjo lidhje fillon me besimin dhe bëhet e vazhdueshme me dhikrull-llahun që do të thotë përmendje e Allahut apo mbajtje në kujtesë e Allahut. Veprimi më i përsosur për përmendjen e Allahut Teala është namazi të cilin e shoqërojnë edhe zemra, edhe trupi. Në ajetin fisnik thuhet: **“Fale namazin për të më kujtuar Mua!”**¹ Gjithashtu, në Kuranin Fisnik thuhet se sexhdet janë mundësitë më të mëdha për afrimin te Zoti (xh.xh.).²

Musa Topbashi, i cili ka qenë prej të urtëve të shekullit, ka një shprehje tejet interesante: “Zemra jonë rinovohet me pesë vaktet e namazit në ditë.” Kjo shprehje është një shenjë e madhe që na e tërheq vëmendjen për rëndësinë e ibadetit të namazit, që është

1. Taha, 14.

2. Shik. Alak, 19.

çelësi i saktësisë së busullës së zemrës.

Namazi që nga fillimi e deri në fund përfshin të gjitha llojet e dhikrit. Namazi është një dhikër gjithëpërfshirës me leximin e Kuranit Fisnik, madhërimin e Zotit, tekbirot, tesbihet, lutjet dhe përgjërimet. Madje, ai mund të jetë dhikri më i madh. Namazi është një lloj dhikri i atillë që zemrat e arrijnë prehjen shpirtërore vetëm me të.³ Zemra është qendra e perceptimit, mendimit dhe vetëdijes. Nëse kjo qendër është e fuqishme, atëherë ndjenjat janë pozitive dhe të ekuilibruara. Gjithashtu, edhe mendja dhe perceptimi shpëtojnë nga të qenët robër të dëshirave të padobishme. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar na ka njoftuar se “ata të cilët e falin namazin në kuptimin e vërtetë, do të kenë një mbrojtje kundrejt ndjenjave të ulëta, sjelljeve të pahijshme dhe çdo lloj ligësie që nuk përputhet me mendjen e shëndoshë”.⁴

Namazi për shkak se është një ibadet mbrojtës, ruajtës dhe orientues drejt ndjenjave sublime, është një adhurim që kërkohet të fillohet që nga moshë e pubertetit e të vazhdojë deri në fund të jetës. Virtytet që namazi ia jep njeriut në çdo moshë dhe në çdo gradë janë të ndryshme. Nisur nga këto që thamë, çdo namaz është i ndryshëm në aspektin shpirtëror edhe pse është i njëjtë në formë. Andaj, edhe frytet e tij janë të ndryshme sipas njeriut dhe periudhave të jetës së këtij të fundit.

Veçanërisht periudha e rinisë së njeriut është një kohë kur ndjenjat arrijnë pikën kulmore. Ngjitjet dhe zbritjet janë absolute. Mbajtja e ekuilibrit në këtë periudhë është shumë më e vështirë. Ja namazi, edhe pse është i rëndësishëm për çdo moshë, ai shfaq një rëndësi shumë më të madhe në periudhën e rinisë për sa i përket aspektit të ruajtjes së personalitetit dhe zhvillimit të shëndetshëm. Nëse qëllimi i krijimit është që të jemi robër prej të cilëve është i kënaqur Allahu Teala brenda kornizës së aftësive dhe përgjegjësive që na ka dhënë Zoti, atëherë esencën e këtij nënshtrimi e përbëjnë besimi dhe tevhidi. Ndërsa shtyllën kryesore e përbën namazi. Për këtë arsye, është thënë: “Feja pa namaz nuk mund të jetë fetarizëm.” Fakti që i Dërguari i Allahut (a.s.), ka kërkuar në lutjet e tij që brezat e ardhshëm të takohen me namazin, bazohet mbi këtë urtësi.

Tashmë le të japim një recetë udhëzimi që një i urtë ia ka dhënë një të riu që ndjente dobësi dhe plogështi në çështjet fetare:

“Bir! Le të përpiqemi t’i falim namazet me xhemat.”

3. Ra’d, 28.

4. Ankebut, 45.

Po, namazi është kthimi i vetes në natyrshmërinë e saj. Për t’ju kthyer përsëri pastërtisë dhe dëlirjes së natyrshmërisë, për t’i rinovuar ndjenjat dhe për të hyrë në drejtimin e duhur, duhet ta drejtojmë trupin dhe zemrën nga kibla dhe Krijuesi i tyre.

Njëra prej cilësive më themelore që domosdo duhet të fitohet në rini është vetëdija dhe përgjegjshmëria për t’i falur në mënyrë të rregullt pesë kohët e namazit. Pjekuria e një rinie që i nxihet jeta kur i ikën një namaz dhe i mbetet për kaza është një pjekuri e shëndetshme. Një vetëdije e tillë e ndërton edhe personalitetin në formën më të mirë. Ata që takohen me Zotin në audiencën hyjnore pesë herë në ditë, sigurisht që Ai do ta edukojë dhe pastrojë në atë formë që është i kënaqur. Atëherë ajo që duhet të bëjmë është që ta perceptojmë namazin, ta duam dhe ta falim në formën që e ka falur i Dërguari i Allahut (a.s.).

Namazi nuk u vjen rëndë atyre që besojnë se do të takohen me Allahun dhe që e dinë se kthimi është vetëm te Zoti (xh.xh.).⁵ Atëherë zemrave duhet t’u injektohet vetëdija se një ditë do të kthehemi te Zoti (xh.xh.), në mënyrë që të japë efekt namazi. Gjithashtu në zemër duhet të gjendet edhe perceptimi se namazi në aspektin shpirtëror është një bisedë e fshehtë me Allahun e Madhëruar.

Namazi në Kuranin Fisnik shprehet me fjalën “salat”. Edhe një kuptim tjetër i fjalës “salat” është “lutje”. Zoti (xh.sh.), na njofton në ajetin e mëposhtëm se të gjitha krijesat kanë një lloj namazi që u është mësuar edhe pse forma e tij është e ndryshme:

“A nuk e vëren ti, se Allahun e lavdëron çdo krijesë që ndodhet në qiej dhe në Tokë, madje edhe shpezët krahëhapur?! Çdokush e di se si t’i falet e ta lavdërojë. Allahu e di mirë çfarë bëjnë ata.” (Nur, 41)

Nga ky ajet fisnik kuptojmë se një krijesë pa namaz është pothuajse si një qelizë prishjeje/kanceri që del jashtë sistemit të gjithësisë dhe që e prish këtë sistem. Krijesat e tilla as vetë nuk gjejnë prehje, as të tjerëve nuk ua japin diçka të tillë.

Përfundimisht, nderi më i madh që mund t’i bëhet një njeriu është të takuarit e tij me namazin. Sa më i hershëm të jetë ky takim, aq më shumë jep rezultate të begata. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka këshilluar që fëmijët tanë t’i takojmë me namazin që në moshën shtatë vjeçare. Ai na e ka tërhequr vërejtjen se nënvlerësimi i kësaj çështjeje bëhet shkak për rezultate të dhimbshme, sepse kur gjërave u kalon koha, është vështirë të kryhen.

5. Bakara, 45-46.

Thirrje të rinjve për namazin

O të rinj! Ejani në namaz!

— Abdullah Jëlldëz —

Për shkak se të rinjtë janë pjesa më aktive, më e gjallë, më e ndjeshme dhe më e hapur ndaj ndryshimit e shoqërisë, qendrat e ligësive i përdorin projektet djallëzore më së shumti kundrejt tyre. Ata bëjnë plane tinëzore për t'i degraduar, për t'i nxitur dhe për t'i shndërruar në robër të dëshirave vetjake. Qendrat e punëve të shëmtuara dhe baronët e ligësive që kanë ngritur salltanetet e tyre mbi haramet, gjithmonë i konsiderojnë të rinjtë si materiale me potencial për ligësitë e tyre. Nëse të rinjtë do t'u japin përparësi zemrave të tyre të zgjuara kundrejt ndjenjave, mund t'i ndryshojnë projektet e liga që po zbatohen në kurriz të tyre.

E vërteta është se shumica e atyre që u kanë besuar pejgamberëve dhe pejgamberit të fundit, Muhamedit (a.s.), është klasa e të rinjve dhe shtresat e ulëta të shoqërisë. Nëse edhe të rinjtë e so-

tëm i vendosin nën urdhrin e shpalljes hyjnore, energjitë dinamike dhe zemrat e zgjuara të tyre do të bëhen prijësit e ndryshimit profetik të këtij shekulli. Besojmë se kur të rinjtë tanë të takohen me frymën gjallëruese të shpalljes hyjnore dhe të prezantohen me moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ishte një “Kuran që ecte”, do të shndërrohen në kandidatë për t'u bërë “sahabët e shekullit”.

Në këtë kontekst, “këmisha që u gris nga pas” e Jusufit (a.s.), përbën një “rol model” për të rinjtë e sotëm. Ai rezistoi kundrejt pasionit të nefsit dhe shejtanit dhe shpëtoi nga kurthi i epshit me ndihmën e Allahut Teala, duke thënë: “Unë kam frikë nga Allahu / Unë i kërkoj mbrojtje Atij.” Jusufi, si një i ri shumë i bukur që preferoi të hynte në burgun e përkohshëm të kësaj bote, në vend që të humbte kënaqësinë e Allahut dhe të dënohej në burgun e përhershëm, shfaqti një shembull të mrekullueshëm se si mund ta mbrojnë nderin të rinjtë e periudhës sonë. Andaj, të rinjtë duhet ta

dinë se Allahu e ka bërë haram imoralitetin dhe t'u kujtohet ndëshkimi që jep për të. Në këtë mënyrë, duhet të hyjnë në mbrojtjen e Allahut Teala me një vetëdije që e preferon burgun kundrejt imoralitetit.

Për këtë arsye, të rinjtë tanë janë të detyruar të preferojnë punët e mira që kanë vlerë te Allahu dhe me të cilat do të fitojnë botën tjetër në vend të dëshirave të kësaj bote që janë afatshkurtra dhe momentale. Kushti kryesor i këtyre punëve të mira që gjenden edhe në pesë shtyllat e Islamit, është namazi. Besimi i tevhidit që mbështetet në themelin "La ilahe il-la'll-llah / Nuk ka zot tjetër përveç Allahut", shndërrohet në vepër me anë të namazit. Andaj, Allahu Teala të gjithë peygamberëve u ka dhënë namazin si hapin e parë të detyrës së luftës së teuhidit. Zoti (xh.xh.), që ia dha Musait detyrën e profecisë në Tuva, tha:

"Fale namazin për të më kujtuar Mua!"

(Taha, 14)

Kur Isai (a.s.), foli për herë të parë në krahët e nënës sonë, Merjemes, tha: **"...Ai (Zoti) më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë."** (Merjem, 31) Edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), në mëngjesin e natës së Kadrit ka falur namazin e parë që ia mësoi Xhebraili (a.s.), atyre që i besuan së pari u urdhëroi namazin dhe pastaj e ka cilësuar atë si "drita e syve të tij", "miraxhi i besimtarit", "çelësi i xhenetit", "shtylla e fesë", "perdja ndërmjet njeriut dhe kufrit" dhe "vepra e parë për të cilën robi do të merret në llogari". Shkurtimisht, namazi është urdhëruar nga të gjithë peygamberët. Ai është shtylla e Islamit që është feja e tevhidit.

Sipas një skene të kiametit që jepet në Kuranin Fisnik, mosfalja e namazit është ndër shkaqet primare të hyrjes në xhehenem: **"Çfarë ju ka sjellë në Sekar (xhehenem)?" Ata do të përgjigjen: "Nuk ishim nga ata që falnin namaz."** (Muddeththir, 42-43)

Të rinjtë tanë që e kanë harruar Allahun, botën e përtejme, vdekjen, detyrat dhe përgjegjësitë përgjatë rrjedhës marramendëse të kësaj jete, duhet t'ia kujtojnë vetes së tyre adhurimin në pesë vaktet me anë të ezanit që i thërret te Allahu Teala. Në të vërtetë, për njeriun që është një krijesë që harron (insan/njeri dhe nisjan/harresë vijnë nga e njëjta

rrënjë në arabisht), çdo kohë namazi është një gjallërim dhe ndryshim i madh.

Procesi i këtij gjallërimi fillon me abdestin. Besimtari i ri që pastrohet nga papastërtitë materiale dhe shpirtërore nëpërmjet abdestit, kthehet drejt Qabesë, i fokuson te Allahu Teala zemrën dhe ndjenjat e tij dhe u kthen kurrizin drejtimeve të tjera. Ndërsa ai që e kthen fytyrën drejt Qabesë, por që në zemër ka drejtime të tjera, në të vërtetë nuk është kthyer drejt Qabesë.

I riu që fal namaz e kryen adhurimin kundrejt Zotit (xh.xh.), edhe me gjuhë nëpërmjet ajeteve, lutjeve, dhikreve dhe tesbihateve, edhe me trup duke qëndruar në këmbë, duke bërë ruku, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar ulur në teshehud. Ai e rinovon marrëveshjen e adhurimit me Zotin (xh.sh.), duke lexuar suren Fatiha në çdo rekat të namazit që fal pesë herë në ditë dhe i jep drejtim jetës në bazë të urdhrave që gjenden në ajetet që i lexon. Një namaz që falet siç duhet, me rregull dhe në mënyrë sistematike, ia mundëson besimtarit të ri që të vazhdojë me vendosmëri dhe qëndrueshmëri në rrugën e drejtë. Namazi i tillë e shpëton besimtarin e ri nga sëmundja e të qenët rob i dikujt tjetër përveç Allahut Teala, për shembull, nga të qenët rob i robit, i nefsit, i parasë, i epshit apo i stomakut, i jep atij lirinë e vërtetë, e mban larg atë nga çdo lloj ligësie apo vepër të shëmtuar (Ankebut, 45) dhe i jep atij një identitet të zgjedhur e një personalitet të pastër. Në këtë mënyrë, bëhet shkak që besimtari i ri të bëjë një jetë me dinjitet në këtë botë dhe të shpëtojë në botën e përhershme. (Mu'minin, 1-2)

Përfundimisht, namazi i cili është shndërrimi i tevhidit në veprim, i jep besimtarit të ri një personalitet të pavarur, e shpëton atë nga të qenët një objekt pasiv dhe e bën një qenie aktive. Një namaz i gjallë dhe i reflektuar në jetë siç ishte ai i Hazreti Shuajbit, nuk e bën besimtarin e ri që të heqë dorë nga kjo botë, por përkundrazi bëhet burim i një dinamike, rezistence dhe gjallërie që e shtyn atë për të qëndruar kundër zullumit, politeizmit dhe mohimit të fesë.

Atëherë, thirrja jonë për rininë është kjo: O të rinj! Ejani në namaz! Gjallërohuni me namaz! Përrjetojeni namazin!





Rëndësia e namazit

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu Teala na e ka urdhëruar namazin si lidhjen më të fortë ndërmjet Tij dhe robit. Përmendja e namazit në Kuranin Fisnik menjëherë pas besimit në Zot, tregon se shfaqja e parë e besimit të besimtarit është namazi. Që në hyrje të këtij Libri të Shenjtë Zoti (xh.xh.), i përshkruan besimtarët: **“Ata besojnë në të fshehtë, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne.”** (Bakara, 3) Edhe në tasavuf, i cili do të thotë që ta jetosh fenë deri në detajet më të vogla të saj, namazi ka një vend dhe rëndësi të veçantë. Për një sufi rrjedha e jetës formohet me namaz. Sufitë nuk mjaftohen duke dalë në audiencën e Zotit me pesë vaktet e namazit që janë farz. Krahas këtyre, ata trokasin në derën e Mikut duke falur edhe namazin e tehexhudit, namazin e paradites, namazin evvabin (ky namaz falet pas sunetit të namazit të akshamit), namazin e përshëndetjes së xhamisë, namazin e falënderimit dhe namazet kaza nëse kanë. Siç shkon njeriu rreth e rrotull asaj gjëje që e do dhe siç kërkon çdo lloj mundësie për ta parë atë që e do, edhe sufitetë përpiqen me mish e me thua për ta parë (me syrin e zemrës) Zotin (xh.xh.), i Cii është i Dashuri i Vërtetë. Për këtë arsye, ata e falin me mallëngjim dhe kënaqësi shpirtërore namazin që do të thotë takim me të Vërtetin. Imam Rabbani e shpreh si më poshtë këtë marrëdhënie që sufitetë e kanë me namazin:

“Dije se grada e namazit është grada e shikimit të Allahut në ahiret. Pika përfundimtare e afrimitetit ndaj Allahut Teala në këtë botë gjendet vetëm në namaz. Ndërsa pika përfundimtare e afrimitetit ndaj Allahut në botën e përtejme është vetë shikimi i Allahut (xh.xh.). Ndërkohë, të gjitha ibadetet e tjera të drejtojnë nga namazi. Ndërsa namazi është qëllimi i tyre kryesor.” (Mektubat, 90:137)

Imam Rabbani këtu na e tërheq vëmendjen drejt një çështjeje të rëndësishme. Vetë ibadetet e tjera nuk janë qëllim, ndërsa namazi është qëllim, sepse në namaz

gjendet dëshmimi i Zotit dhe grada e lartësimit drejt miraxhit. Por ja që vlerën e kësaj grade e dinë vetëm ata që kanë arritur në kulmin e rrugës së mistikës. Për këtë arsye, ata i falin namazet pa ndërje aspak vështirësi.

“Dije se marrja e kënaqësisë nga adhurimet dhe veçanërisht kryerja e adhurimeve pa ndërje ndonjë vështirësi janë prej mirësive më të mëdha të Allahut Teala. Kjo gjendje shpirtërore është e pamundur sidomos kur bëhet fjalë për kryerjen e namazeve farz për ata që nuk e njohin këtë rrugë, sepse ata që gjenden në fillim të kësaj rruge marrin kënaqësi më shumë prej nafileve. Ndërsa te ata që kanë arritur në fundin e kësaj rruge, kjo kënaqësi lidhet me farzet. Për këtë arsye, preokupimi me nafilet te ata konsiderohet i padobishëm. Punë e madhe për ata që kanë arritur në fundin e kësaj rruge është vetëm kryerja e farzeve.” (Mektubat, 90:137)

Sipas Imamit, kënaqësia që merret nga namazi i përket shpirtit. Nefsi nuk ka asnjë pjesë në këtë çështje:

“Duhet të dihet se shija që merret përgjatë faljes së namazit absolutisht nuk ka asnjë lidhje me nefsin. Përkundrazi, kjo është e njëjta shije që ndjehet përgjatë qarjes dhe fatkeqësisë. Subhanall-llah/i lartësuar është Allahu! Sa gradë e lartë që është kjo! Këto mirësi gjithmonë i paçin njerëzit e devotshëm!”

Ismail Haki Burseviu e shpjegon kështu në tefsirin e tij çështjen që namazi është miraxhi i besimtarit: “Namazi është bërë farz natën e Miraxhit, sepse Miraxhi është prej kohëve më të vlefshme dhe prej momenteve më të virtytshme. Edhe namazi është prej bindjeve më të virtytshme pas besimit. Ibadeti më i bukur është bërë farz në kohën më të bukur, pra, është bërë farz në Miraxh që është koha kur Muhamedi (a.s.) është takuar dhe afruar me Zotin (xh.xh.).”

Por ja që çdo falës i namazit nuk e arrin dot të

fshehtë e Miraxhit. Sipas Imamatit, ka disa çështje për të cilat besimtari duhet të bëjë kujdes, në mënyrë që namazi të bëhet Miraxhi i tij. Në krye të këtyre vjen tadili erkan i namazit, domethënë, kryerja e çdo veprimi të namazit duke i dhënë hakun.

“Besimtari duhet të shfaqë kujdes në çështjen e prehes shpirtërore dhe zbatimit të tadili erkanit, sepse shumë njerëz i çojnë dëm namazet e tyre për shkak se nuk bëjnë kujdes në çështjen e prehes shpirtërore dhe zbatimit të tadili erkanit. Në lidhje me këta njerëz të tillë kanë ardhur shumë kërcënime. Kur namazi të falet me rregull dhe siç kërkohet, bëhet një burim i madh shprese për shpëtimin e përhershëm të besimtarit, sepse një gjendje e tillë argumenton që besimtari e mban në këmbë fenë e tij dhe se i është plotësuar miraxhi.” (Mektubat, 109:20)

Imami e shpjegon siç vijon më poshtë vendin e namazit ndërmjet adhurimeve të tjera: “Namazi është ibadeti më i lartë pas besimit në Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Edhe bukuria e namazit pikërisht si edhe bukuria e besimit, buron nga vetvetja. Ndërsa adhurimet e tjera nuk e kanë bukurinë nga vetvetja. Bukuria e tyre varet te disa shkaqe të tjera. Siç shpjegohet edhe në librat e jurisprudencës islame, namazet duhet t'i falim me një përkushtim dhe frikërespekt të jashtëzakonshëm pasi të bëjmë një pastrim të plotë fizik dhe shpirtëror (pasi të marrim abdest siç duhet). Në këndimin e Kuranit, në ruku, në sexhde, në qëndrimin në këmbë, në qëndrimin ulur dhe në veprimet e tjera përgjatë namazit, vazhdimisht duhet të jemi të përkushtuar, në mënyrë që këto t'i kryejmë në formën më të mirë të mundshme. Përgjatë kryerjes së këtyre veprimeve duhet të përpiqemi për të arritur prehes shpirtërore. Asnjëherë nuk duhet të ndjehemi të plogësht për namazin dhe gjithmonë duhet të shfaqim kujdes që ta falim sapo të hyjë koha. Robi i pranuar të Allahu Teala është ai që e zbaton urdhrin e Zotit pa pritur aspak dhe në mënyrën më të bukur. Plogështia në çështjen e zbatimit të urdhrin do të thotë mungesë e bindjes dhe e edukatës.” (Mektubat, 152:17)

Imam Rabbani i paralajmëron shpesh sufite për sa i përket çështjes së faljes së namazeve në kohën e tyre dhe me xhemat. Sipas tij, dhikri dhe veprat e tjera të tasavufit i bëjnë dobi sufiut pasi t'i falë namazet në formën më të mirë. Ata që nuk falin namaz apo që nuk janë të kujdesshëm në çështjen e namazit, nuk kanë dobi nga preokupimi me nafilet e tjera. Imami e mbështet këtë çështje me këtë ngjarje që e transmeton nga Omeri (r.a.):

“Një herë Emiru'l-Mu'minin, Omeri (r.a.), fali namazin e mëngjesit me xhemat. Pastaj u hodhi një shikim sahabëve të nderuar. Kur vuri re se njëri prej tyre nuk gjendej në xhami, pyeti se ku ishte. Përgjigja që mori ishte: “Ai e kalon të gjithë natën me adhurim. Me sa duket e ka zënë gjumi.” Nisur nga kjo përgjigje, Emiru'l-Mu'minin tha: “Ah sikur të kishte fjetur përgjatë gjithë natës dhe ta kishte falur namazin e mëngjesit me xhemat. Kjo do të ishte më e mirë për të.” (Mektubat, 77: 114)

Sipas Imamatit, mirësia që gjendet në namaz nuk gje-

ndet në asnjë adhurim tjetër. Nisur nga kjo, në mendje mund të na vijë kjo pyetje: “Përse sufite i japin shumë rëndësi dhikrit?” Sipas Imam Rabbanit, qëllimi i dhikrit është përgatitja për namaz, sepse besimtari nuk mund të përfitojë nga namazi para se zemra të dëliret krejtësisht. Kurdo që zemra të pastrohet me kuptimin e plotë të fjalës, atëherë ndodh edhe lartësimi me namaz. Dhikri që bëhet në fillim ka si synim arritjen e një përparimi sa më të madh me namaz. Dhikri u jep vetëm sevape sufive që e kanë arritur këtë gradë:

“Sufiu e plotëson me ndihmën e Zotit (xh.xh.), përparimin e tij të lidhur me dhikrin. Nëse ai arrin të shpëtojë nga dashuria e idhujve të nefsit, e kalon gradën e nefsu'l-emma dhe arrin në gradën e nefsit mutmaine, atëherë ky përparim nuk arrihet më me dhikër. Tashmë dhikri bëhet vetëm për sevap. Lartësimi në gradat e afrimitet ndaj Zotit në këtë pozitë është i lidhur me leximin e Kuranit Fisnik dhe me faljen e namazeve me këndim të gjatë e frikë-respekt ndaj Zotit. Ato që më parë arriheshin me dhikër, tashmë arrihen me këndimin e Kuranit dhe veçanërisht me këndimin e Kuranit në namaz.” (Mektubat, 155:25)

Bazuar në këto që thamë, edhe një rrugë tjetër për përgatitjen për namazin është marrja e njohurive rreth Kuranit Fisnik dhe mësimi përmendësh i sa më shumë sureve të tij. Më e pakta, suret që këndohen shpesh përgjatë namazeve duhet të mësohen me gjithë tefsirin e tyre, sepse në namaz duhet të meditojmë. Sa më shumë që ta njohim Kuranin dhe ta mësojmë, aq më shumë rritet cilësia e namazeve tona. Krahas kësaj, besimtari merr sevape për çdo ajet që e këndon edhe nëse ia di kuptimin, edhe nëse nuk ia di. Madje, ai merr sevape për çdo shkronjë të Kuranit Fisnik që këndon. Por nëse këndimin e Kuranit në namaz e bën duke medituar rreth kuptimit të tij, padyshim që do të përparojë më shumë shpirtërisht.

Nisur nga këto që thamë më sipër, detyra më kryesore e një myslimani të vetëdijshëm është që ta falë sa më bukur namazin, t'ua mësojë edhe fëmijëve rëndësinë e namazit që në moshë të vogël dhe t'ua shpjegojë atë edhe pjesëtarëve të familjes, edhe të afërmeve. Ne duhet t'ua mësojmë të rinjve tanë se namazi nuk është vetëm një obligim fetar, por se është një mundësi për t'u lartësuar në miraxh drejt Zotit (xh.xh.). Ndërkohë, ne duhet të jemi shembull për ata në këtë çështje. Ndoshta detyra më e rëndësishme e kryefamiljarëve, e nënave dhe e baballarëve në familja është kjo. Në ditët e sotme kur fitneja më e madhe është telashi për të fituar sa më shumë pasuri, nënat dhe baballarët u mësojnë fëmijëve të tyre rëndësinë e hyrjes në një shkollë shumë të mirë dhe të marrjes së një profesioni që ka shumë të ardhura. Allahu i Lartësuar që e di shumë mirë këtë psikologji të njeriut, e përshkruar kështu detyrën e vërtetë që duhet të kryejmë:

“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë! Ne nuk të kërkojmë ty ndonjë ushqim: jemi Ne që të ushqejmë! Përfundimi i lumtur qëndron në frikën ndaj Allahut.” (Taha, 132) Allahu Teala na e mundësoftë të gjithëve që të marrim mësim nga ky ajet dhe që ta vendosim namazin në qendrën e jetës sonë familjare! Amin!

TË RINJ QË JANË NDRIÇIM I SYVE DHE NAMAZI QË ËSHTË DRITA E SYVE

— Ibrahim Bozbeshpamak —

Megjithëse në vendin tonë po shtohen me shpejtësi medresetë, kurset e Kuranit dhe shoqatat që japin edukim fetar, shihet qartë se nuk ka një shtim të ndjeshëm të të rinjve nëpër xhami. Ankesat si: “Hoxhë, fëmijën tonë nuk po e bëjmë dot të falë namaz.”, të cilat i dëgjojmë shpesh herë, janë prej shenjave më të mëdha të kësaj gjendjeje. Atëherë, çfarë mund të bëjmë apo çfarë duhet të bëjmë për t’i afruar të rinjtë te namazi? Madje, çfarë nuk duhet të bëjmë? Fjalën “afirim” e kam zgjedhur me vetëdije të plotë, sepse të rinjtë tanë në fakt nuk janë prej atyre që nuk e dinë rrugën e xhamisë. Madje, xhamitë dhe rreshtat tanë mbushen plot e përplot me të rinj për namaz të Xhumasë. Këta të rinj veshin rrobat më të bukura, i krehin flokët, i lyejnë këpucët dhe herët në mëngjes nxitojnë për të shkuar nëpër xhami kur bëhet fjalë për namazin e festës së Bajramit. Në muajin e Ramazanit shtohen shumë fytyrat e reja që shndrisin në sexhde. Kjo dëshirë nuk ekziston për shkak se namazi i xhumasë gjendet një herë në javë, namazi i bajramit gjendet dy herë në vit dhe muaji i Ramazanit gjendet një herë në vit, por kjo dëshirë ekziston ngaqë në bazën e kësaj çështjeje gjendet një namaz xhumaje që fëmija e ka ndjerë domosdoshmërinë e tij në formën më të mirë nëpërmjet ritualeve dhe organizimeve. I riu ia ka dedikuar zemrën që në vegjëli emocionit të veçantë të namazit të bajramit. Tashmë i riu nuk mund të rrijë indiferent ndaj mobilizimit të adhurimit në shoqëri përgjatë muajit të Ramazanit. Nëse ky emocion dhe këto organizime nuk mund të mbarten te pesë kohët e namazit, atëherë duhet të ulemi dhe të mendojmë. Atëherë, si do t’i takojmë të rinjtë tanë, të cilët e duan xhaminë, me pesë kohët e namazit?

PARA SË GJITHASH DUHET TA NDJEJMË KËTË SHQETËSIM...

Në sistemin e edukimit Islam edukimi i fëmijës fillon që në barkun e nënës. Prindërit që dëshirojnë t’u japin përgjigje me fytyrë të bardhë për pyetjet që do t’u bëhen në lidhje me fëmijët e tyre në Gjykatën e Madhe, para së gjithash duhet t’i falin vetë namazet në formë të rregullt. Nëna dhe babai nuk duhet të shqetësohen vetëm për fëmijët e tyre që

u kanë lindur apo që do t’u lindin, por duhet ta mbartin këtë shqetësim për të gjithë brezat që do të vijnë prej tyre siç është shprehur edhe Ibrahim në përgjërimit të tij që përmendet në Kuranin Fisnik. Ndjeshmëritë e nënës e të babait si të ushqyerit vetëm me hallall, lënia e gjërave të panevojshme, të qëndruarit vazhdimisht me abdest, të qëndruarit me ata që falin namaz dhe të frekuentuarit në kuvendet e njerëzve të devotshëm, janë shumë të rëndësishme për sa i përket aspektit të lidhjes së fëmijët me namazin në vitet e ardhshme të jetës. Allahu Teala nuk do t’i refuzojë lutjet e nënave dhe të baballarëve që përgjërohen të shqetësuar dhe plot sinqeritet për një të ardhme sa më të mirë të fëmijëve të tyre.

FËMIJËRIA DHE NAMAZI...

Gjëja e parë që duhet të bëhet kur të lindë fëmija është praktikimi i një suneti të të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, i cili është harruar. Pra, duhet të



ftohet ndonjë i devotshëm prej të afërmeve apo prej të njohurve që njihet me ndjeshmërinë e tij ndaj namazit dhe t'i kërkohet që të përlypë një hurmë apo diçka tjetër të ëmbël, t'i fusë në gojë fëmijës dhe të lutet për të ardhmen, besimin, orientimin e duhur dhe ibadetin e të porsalindurit. Fëmija duhet të vendoset në një dhomë ku nuk shqetësohet nga zhurmat e televizorit, përgojimeve, thashethemeve dhe zënkave. Nënata dhe baballarët duhet t'i falin në prezencë të fëmijëve namazet ditore dhe namazet nafile. Gjithashtu, edhe leximin e Kuranit Fisnik duhet ta bëjnë në prezencë të tyre. Këto veprime do të jenë shumë të dobishme për sa i përket aspektit të formimit të një memorieje rreth namazit të fëmija. Pas kësaj, kundrejt namazit duhet të shfaqet një interes i madh që do ta bëjë fëmijën ta ndjejë rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij ibadeti. Andaj është shumë e rëndësishme që fëmijët të shkojnë në xhami me prindërit e tyre dhe t'u mbeten përshtypje të këndshme, të cilat do t'i kujtojnë edhe në vitet e ardhshme.

Dhuratat dhe organizimet e ndryshme që do t'ia ngrohin zemrën fëmijës ndaj namazit dhe që do t'ia shtojnë dashurinë për të shkruar në xhami, do ta parandalojnë çoroditjen e fëmijës në periudhën e adoleshencës. Ky vëllai juaj që ka shkruar këto rreshta, ka një kujtim të bukur në lidhje me këtë çështje. Këtë kujtim po e ndaj me ju me qëllimin

**PRINDËRIT QË
DËSHIROJNË T'U
JAPIN PËRGGJIGJE ME
FYTYRË TË BARDHË
PËR PYETJET QË
DO T'U BËHEN NË
LIDHJE ME FËMIJËT
E TYRE NË GJYKATËN
E MADHE, PARA SË
GJITHASH DUHET
T'I FALIN VETË
NAMAZET NË FORMË
TË RREGULLT.**

për t'ju dhënë një mendim: "Isha në moshën 7-8 vjeçare. Imami i lagjes për të më inkurajuar që të frekuentoja në xhami, më pati thënë të shkoja te ai ditën kur merrte rrogën. Topin e parave që gjendej në xhepin e këmishës së hoxhës së nderuar dhe buzëqeshja e ngrohtë që kishte në fytyrë atë ditë, akoma janë shumë të qartë në memorien time. Imami më pati blerë një kamion të madh lodër. Unë me atë kamion qoftë edhe pak mbarta rënë për ndërtimin e minares së xhamisë që ishte në ndërtim e sipër. Pas shumë vitesh e mësova se paratë e dhuratës ia kishte pas dhënë babai im. Ai kishte pasur si qëllim që të ma ngrohte zemrën ndaj xhamisë, imamit të nderuar dhe Islamit.

Takimet, shamitë dhe tesbihet që mund t'u bëhen dhuratë fëmijëve, do të formojnë vetëdijen për namazin te ata dhe do t'i bëjë të ndjehen mirë me identitetin Islam. Në këto çështje prindërit sipas mundësive mund të zhvillojnë strategji të ndryshme.

SHOQËRIA NË NAMAZ...

Lidhja që namazi ka me xhaminë dhe xhematin, në të vërtetë tregon edhe aspektin shoqëror të tij. Grupet e namazit që mund të formohen që në fëmijëri me shokët/shoqet e shkollës, me fëmijët e të afërmeve apo me fëmijët e fqinjëve, do të jenë të dobishëm për t'i inkurajuar fëmijët që të shkojnë në namaz dhe për ta kontrolluar njëri-tjetrin në lidhje me vazhdimësinë në namaz. Pas një studimi të shkurtër që mund të bëhet, do të vihet re se shokët/shoqet janë faktori i dytë më kryesor pas prindërve për sa i përket çështjes së fillimit të faljes së namazit dhe vazhdimësisë së kësaj pune. Këto lloj organizimesh siç mund të ndiqen nga imami i nderuar, mund të bëhen edhe me anë të njerëzve vullnetarë që ua kanë përkushtuar veten punëve të mira.

I RIU/E REJA DHE NAMAZI...

Me përparimin e moshës së fëmijës, fillon të pakësohet edhe ndikimi i familjes mbi të. Andaj, ligjëratat fetare dhe kuvendet islame në të cilat mund të frekuentojë familja, do të jenë faktori më kryesor për fëmijën që do ta nxisë për ta vazhduar namazin. I riu/e reja sa të kenë mundësi nuk duhet të qëndrojnë larg njerëzve që vazhdimisht përpiqen për Islamin. Në këtë pikë vakëfeve, shoqatave dhe xhemateve u bie një detyrë shumë e rëndësishme. Veçanërisht një shembull i shkëlqyer që mund ta fitojë zemrën e të riut/resë, do ta drejtojë atë në të gjitha punët e mira duke filluar me në krye namazin. Një shembull i shkëlqyer i tillë nuk duhet të



KUNDREJT NAMAZIT DUHET TË SHFAQET NJË INTERES I MADH QË DO TA BËJË FËMIJËN TA NDJEJË RËNDËSINË E JASHTËZAKONSHME TË KËTIJ IBADETI. ANDAJ ËSHTË SHUMË E RËNDËSISHME QË FËMIJËT TË SHKOJNË NË XHAMI ME PRINDËRIT E TYRE DHE T'U MBETEN PËRSHTYPJE TË KËNDSHME, TË CILAT DO T'I KUJTOJNË EDHE NË VITET E ARDHSHME.

nënvlerësohet në emër për të bërë një jetë sa më të bukur, sipas Islamit dhe në shërbimin të fitimit të ahiretit. Orientuesit janë shumë të rëndësishëm si në veset e këqija, për shembull në pirjen e duhanit, ashtu edhe në veprat e mira.

TAKIMET PËR NAMAZIN...

Takimet e singerta për namazin, të cilat organizohen me qerasje e koktejlje, ua shtojnë dashurinë të rinjve për namazin. Këto takime janë jetike edhe për të mos qëndruar në vetmi, edhe për të shuar efektin negativ të individualizimit që po përjeton periudhën e artë në kohën tonë. Gjithashtu këto takime janë kusht edhe për t'ua forcuar marrëdhënien të rinjve me namazin.

Mbartja e kuvendeve fetare në xhami veçanërisht për të rinjtë dhe organizimi i këtyre takimeve me në qendër xhaminë, do ta forconte lidhjen e të rinjve me xhaminë. Një grup të rinjsh që po përgatiteshin për provimin e matematikës në mbajtëset e Kuranit në xhami, më pati gëzuar pa masë. Lidhja e të rinjve me xhaminë nëpërmjet organizimeve të ndryshme në të njëjtën kohë do të forcojë edhe lidhjen e tyre me namazin.


PËRKUJDESJA...

Njerëzit që kanë ndjeshmëri prej myslimani nga njëherë përjetojnë vështirësi për t'i kuptuar ata që nuk janë prej botës së tyre. Në këtë pikë duhet të tolerohen gabimet e vogla të të rinjve që kanë gjetur rrugën e xhamisë dhe që u prek balli në sexhde. Më vonë këto gabime duhet të rregullohen në mënyrën e përshtatshme. Mungesa e njohurive të tyre në lidhje me çështjen e namazit dhe çështjet e ilmihalit, absolutisht nuk duhet të bëhen objekt përçmimi. Një buzëqeshje me ironi që mund t'i drejtohet një të riu që pyet rreth një çështjeje shumë të njohur për namazin, mund të bëhet shkak që ky i ri të

largohet plotësisht nga namazi. Edhe mosteprimi në këshillim është shumë i rëndësishëm, sepse një gjuhë lënduese dhe imponuese bën më shumë dëm sesa dobi.

DURIMI DHE LUTJA...

Ajetet në Kuranin Fisnik që urdhërojnë për vazhdimësinë në namaz, në përgjithësi theksojnë edhe durimin, sepse namazi që do të vazhdojë përgjatë gjithë jetës, në të njëjtën kohë kërkon një durim të përhershëm. Zemra e të riut ndryshon shumë shpejt. Ajo dashuron, kaplohet nga brenga të thella dhe gëzimin e lumturinë e përjeton në shkallën më të lartë. I riu duhet të inkurajohet që gjithmonë të vazhdojë ta falë namazin krahas të gjitha ditëve me furtuna që i përjeton dhe krahas të gjitha llojeve të dyshimeve që mund të ketë në zemër. Falja e namazit në mënyrë të vazhdueshme do ta mbrojnë të riun kundrejt sprovave edhe më të mëdha që mund të vijnë në ditët pasuese. Ky është durimi që i takon të riut që ta shfaqë. Gjithashtu durimi ka edhe dimensionin në lidhje me familjen. Namazi është një punë shumë e rëndë veçanërisht në këtë kohën tonë kur njerëzit janë të prirë vetëm për të kënaqur dëshirat vetjake të tyre. Andaj, duhet të kemi durim kundrejt mangësive dhe problemeve të të riut. Gjithashtu, duhet të kërkohen me insistim rrugët që të çojnë në zemrën e tij. I riu/e reja duhet të këshillohet që të falë namaz në bazë të mundësisë së tij. Së fundi, zemrat janë në dorën e Allahut Teala. Rëndësia e lutjes në këto çështje nuk duhet të harrohet. I vetmi burim udhëzimi është vetëm Ai. Para se të jepet selam në teshehudin e namazeve duhet të shtohet në arabisht edhe kjo lutje e Ibrahimit (a.s.): **“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!”** (Ibrahim, 40)



Sjellja e Imam Ebu Hanifes

Kënaqësia e Allahu Teala dhe dinjiteti e krenaria e dijes janë mbi çdo gjë. Po të mos e konsideronte Ebu Hanifja kënaqësinë e Allahut dhe dinjitetin e krenarinë e dijes mbi çdo gjë, nuk mund të bëhej Imam Azam /Imami më i madh dhe nuk do ta meritonte të kujtohej me mëshirë dhe nderim nëpër shekuj. Udhëheqësit nuk mund të gabojnë apo të bëjnë padrejtësi kur dijetarët mbrojnë të vërtetën.

— Ali Riza Temel —

Jo më kot, imami i medhhebit tonë, Ebu Hanifja është quajtur edhe Imam Azam- imami më i madh. Krahas dijes së madhe që kishte në jurisprudencën islame, zgjuarsisë së mprehtë dhe aftësisë për të bindur, pa diskutim kishte edhe një karakter të lartë dhe dinjitet.

Ndërkohë që shumë njerëz garonin për të kapur ndonjë post në shtet, Ebu Hanifja me frikën se mund të bëhej vegël e veprimeve të gabuara të pushtetit, nuk e kishte pranuar postin e kryegjykatësit që iu propozua nga kalifi Ebu Xhafer Mansuri. Për shkak të kësaj, ai u burgos dhe u torturua. Tani le ta dëgjojmë nga goja e tij se si e ka refuzuar postin e kryegjykatësit me mirësjellje:

“Kalifi më ftoi për të më propozuar postin e kryegjykatësit. Unë e njoftova atë se nuk isha i përshtatshëm për atë post. I thashë: ‘Nëse argumenti është betim për paditësin, bie mbi të paditurin, por për ta ditur këtë nuk është e mjaftueshme të jesh gjykatës. Ai që do të bëhet gjykatës

duhet të jetë një njeri që të ketë aq guxim, saqë të gjykojë edhe kundër teje, edhe kundër birit tënd, edhe kundër komandantëve të tu. Ndërsa unë nuk e kam këtë guxim. Zemra ime nuk është e kënaqur që ta pranojë propozimin për kryegjykatës.’”

Ndërsa sipas një transmetimi tjetër, Imam Azami i tha Ebu Xhaferit:

“Unë nuk i besoj dot vetes në këtë çështje. Nëse më vendos të zgjedh ndërmjet mbytjes në Eufrat dhe pranimit të këtij propozimi, do të zgjidhja mbytjen. Përreth teje ka shumë njerëz që e presin këtë nderim. Unë nuk jam i përshtatshëm për postin e kryegjykatësit.” Ebu Xhaferi u mërzit dhe i tha:

“Po gënjen. Ti je i përshtatshëm për këtë punë.” Ebu Hanifja menjëherë ia ktheu:

“Ja pra, vetë gjykoje. Si mund t’ia japësh postin e kryegjykatësit dikujt për të cilin sapo pohove se gënjen?”

Imam Azami nuk i pranoi dhuratat që i dërgoi



kalifi dhe i ktheu mbrapsht. Nisur nga kjo, Ebu Xhaferi e pyeti: “Përse nuk i pranon dhuratat e mia?” Ebu Hanifja iu përgjigj:

“Prijësi i besimtarëve nuk më ka dërguar diçka nga pasuria e tij. Po të më kishe dërguar diçka nga pasuria jote, do ta pranoja. Ndërsa ato që më dërguat ju ishin nga thesari, domethënë nga pasuria e myslimanëve. Unë nuk kam asnjë privilegj në thesar, sepse nuk jam prej atyre që kanë shkuar në luftë dhe kanë luftuar, që të marr ndonjë pjesë prej thesarit. Gjithashtu, nuk jam as prej fëmijëve të luftëtarëve, në mënyrë që të marr ndonjë pjesë si jetim. Mbi të gjitha, nuk jam as i varfër, që të marr ndonjë gjë si i varfër.”

Shkaku që Imam Azami, Ebu Hanifja insistonte për të mos e pranuar postin e kryegjykatësit, siç e shprehëm edhe në fillim, ishte shqetësimi se autoriteti të cilit nuk i besonte mund ta bënte vegël të veprimeve të gabuara. Po të ishte Ebu Xhafer Mansuri një kalif i drejtë si Omer ibn Abdulazizi, Ebu Hanifja sigurisht që nuk do ta refuzonte postin e kryegjykatësit.

Imam Azami ishte krejtësisht një monument morali. Asnjëherë nuk dëshironte që veten ta nxirrte në plan të parë. Herë pas herë bënte debate me kundërshtarët e tij, por të afërmit dhe

nxënësit e vet i mbante larg debateve. Një herë kur e pa birin e tij, Hamadin duke debatuar në çështjet e kelamit, menjëherë e ndaloi nga debati. Kur i biri i tha:

“Ne të shohim ty duke bërë debat. Atëherë, përse na ndalon ne?”, Ebu Hanifja i dha këtë përgjigje: “Kur ne bëjmë debat shfaqim një ndjeshmëri të madhe duke u frikësuar në mos gabohet apo humbet shoku që kemi përballë. Ndërsa ju e bëni debatin sipas parimit për ta mposhtur shokun tuaj.”

Imam Azami ishte biri i një familjeje të pasur. Babai i tij merrej me tregti. Tregtia e copave ishte një punë me fitime të majme. Edhe Ebu Hanifja e vazhdoi profesionin e babait të tij. Nisur nga këshilla e Sha’bit, i cili ishte prej të mëdhenjve të tabiinëve, vazhdoi t’i frekuentonte kuvendet e dijes. Ai u interesua për të gjitha shkencat e përhapura në periudhën e tij. Shkencën e jurisprudencës e vuri në plan të parë, ngaqë ajo interesoj për çdo fushë të jetës. Ebu Hanifja u bë specialist në këtë fushë. Për shkak se e njihnte mirë edhe tregtinë, fitoi objektivitet në dispozitat e kësaj të fundit. Ai nuk e ndërpreu krejtësisht marrëdhënien me tregtinë. Në përgjithësi tregtinë e bëri me anë të ortakëve.

Tani le të japim disa anekdota për moralin e tij në lidhje me tregtinë: Një grua i solli një copë mëndafshi për ta shitur. Ebu Hanifja e pyeti për çmimin e copës. Gruaja i tha: “Njëqind dirhemë.” Kur Ebu Hanifja i tha: “Vlera e kësaj është më shumë se njëqind dirhemë.”, grua shtoi edhe njëqind dirhemë të tjerë. Pasi Ebu Hanifja përsëri i tha: “Bën edhe më shumë.”, gruaja e ngriti çmimin deri në katërqind dirhemë. Ngaqë Ebu Hanifja përsëri i tha: “Bën edhe më shumë.”, gruaja ia ktheu: “A po tallesh me mua?” Imam Azami iu përgjigj: “Nuk po tallem me ju. Andaj

sillni një burrë dhe t'ia caktojme çmimin.” Gruaja solli dikë që e njihte këtë punë. Ai e caktoi çmimin. Ebu Hanifja e bleu copën prej mëndafshi me pesëqind dirhemë. Imam Azami në përgjithësi nuk merrte fitim nga klientët e varfër. Madje nganjëherë u jepte edhe pa pagesë. Ja pra, tregtia jonë që mbështetet te baza për ta mashtruar blerësin dhe tregtia e Imam Azamit që mbështetet te baza për ta favorizuar blerësin. Sjelljet e tilla njeriut të sotshëm mund t'i duken si përralla apo si utopi.

Ebu Hanifja e llogariste fitimin vjetor dhe i paguante të gjitha nevojat e njerëzve të dijes dhe të nxënësve të tyre. Ndërsa paratë që tepronin ua shpërndante përsëri atyre dhe pastaj u thoshte: “Harxhojini këto për gjëra të tjera që keni nevojë dhe falënderojeni Allahun. Këto para që po jua jap, në të vërtetë nuk janë të miat, por janë kështu juaj nga mirësia e begatia e Allahut që ua ka dërguar nëpërmjet meje.” Sa sjellje e mrekullueshme që mund të shfaqet për të mos i turpëruar njerëzit në nevojë!

Ebu Hanifja 52 vjet të jetës së tij i kaloi në periudhën Emevite, ndërsa 18 vjetët e tjera në periudhën Abasite. Në të dyja periudhat ka parë problemet dhe zhvillimet e tyre. Ai personalisht asnjëherë nuk u bë vegël e veprimeve të gabuara. Madje, për këtë preferoi burgosjen dhe torturimin. Gjithashtu, ai nuk ka kapur shpatën dhe nuk ka marrë pjesë personalisht në kryengritje. Këtë nuk e ka bërë jo për shkak të frikës, por ngaqë nuk besonte se një kryengritje e tillë do të përfundonte me sukses. Andaj, ai nuk dëshironte që të derdhej gjak për diçka të paarritshme. Ebu Hanifja e konsideroi të drejtë kryengritjen e Zejd ibn Zejnelabidinit kundër Hisham ibn Abdulmelikut në vitin 121 hixhri, por nuk mori pjesë personalisht në kryengritje ngaqë fundin nuk e shihte si të suksesshëm. Me të vërtetë, kjo kryengritje dështoi dhe Imam Zejd ibn Zejnelabidini u martirizua në vitin 122 hixhri. Hyrja në një luftë përfundimi i së cilës shihet se është i dështuar, është e papranueshme nga mendja. Ebu Hanifja gjithmonë u përpoq për daljen në pah të së vërtetës. Ai gjithmonë kërkonte që çdo gjë të diskutohet në mënyrë objektive dhe larg fanatizmit. Një herë kur e pyetën:

“A është një e vërtetë absolute kjo fetva që ke dhënë?”, ai u përgjigj: “Për Zotin nuk e di. Ndoshta është një gabim absolut.” Ebu Jusufit që i mbante shënim ato që thoshte, i pati thënë: “Çfarë bën ashtu? Mos shkruaj çdo gjë që dëgjon prej meje, sepse sot mund të kem këtë mendim, ndërsa nesër mund të kem një mendim tjetër.”

Për shkak se ishte një njeri jashtëzakonisht i sinqertë në kërkimin e të vërtetës, menjëherë e pranonte kur i thuhej ndonjë hadith i saktë apo thënie e sahabëve dhe hiqte dorë nga mendimi i vet. Ai debatonte me nxënësit e tij sikur t'i kishte shokë dhe askujt nuk ia impononte mendimin e vet. Ndërkohë, kundërshtimet e nxënësve të tij i pranonte me pjekuri.

Medhhebi i Imam Ebu Hanifes është medhhebi më i përhapur në botën islame. Ebu Hanifja është një shembull ideal për ne me dijen, moralin, qëndrimin, modestinë, mirësinë, tolerancën dhe cilësitë e tjera të larta të tij. Ata që thonë se i përkasin medhhebit Hanefi, krahas fetvave në formën “është e lejuar – nuk është e lejuar” që ka dhënë Imam Azami, duhet t'i marrin parasysh edhe cilësitë e larta të tij që i shprehëm më sipër dhe të përpiqen ta pasojnë atë në të gjitha aspektet. Përkatesia e vërtetë është kjo.

Sjellja e Imam Azamit veçanërisht duhet të merret si shembull nga dijetarët dhe gjykatësit e kohës së sotme. Ata që digjen e përvëlohen me pasionin për pozitë, famë dhe pasuri, të mos harrojnë se do të digjen e përvëlohen me zjarrin e xhehenemit kur të bëhen vegël e veprimeve të padrejta. Kënaqësia e Allahu Teala dhe dinjiteti e krenaria e dijes janë mbi çdo gjë. Po të mos e konsideronte Ebu Hanifja kënaqësinë e Allahut dhe dinjitetin e krenarinë e dijes mbi çdo gjë, nuk mund të bëhej Imam Azam /Imami më i madh dhe nuk do ta meritonte të kujtohej me mëshirë dhe nderim nëpër shekuj. Udhëheqësit nuk mund të gabojnë apo të bëjnë padrejtësi kur dijetarët mbrojnë të vërtetën. Andaj, shkrimin tonë le ta përfundojmë me këtë hadith fisnik të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të:

“Xhuhadi më i mirë është të thënë e të vërtetës përballë udhëheqësit zullumqar.” (Keshfu'l-Hafa, hadithi nr: 4577.)

Medhhebi i Imam Ebu Hanifes është medhhebi më i përhapur në botën islame. Ebu Hanifja është një shembull ideal për ne me dijen, moralin, qëndrimin, modestinë, mirësinë, tolerancën dhe cilësitë e tjera të larta të tij.

Predikimi i Islamit nga umeti

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Të gjithë të dërguarit e Allahut ua kanë dhënë umeteve të tyre si detyrë kryesore predikimin e atyre që kanë mësuar ndaj brezave të mëvonshëm. Edhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), këshillën në lidhje me çështjen që mundëson zhvillimin e shkencave islame e ka shprehur në Hytben e Lam-tumirës në formë të përgjithshme dhe zyrtare me fjalitë e mëposhtme:

“...Ata që gjenden këtu prej jush le t’ua thonë (ato që dëgjuan) atyre që nuk gjenden këtu...¹, ...Sepse ata që gjenden këtu mund t’ia çojnë fjalën dikujt që kupton më mirë.”² “Allahu ia ndriçoftë fytyrën atij që dëgjon fjalën time, e mëson bukur përmendsh dhe ua transmeton edhe të tjerëve siç e ka mësuar!”³ Edhe kufirin e përgjegjësisë së predikimit e ka vendosur duke u shprehur: “Kush gënjen duke m’u referuar mua me vetëdije, le të përgatisë vendin e tij në xhehenem!”⁴

Nëse marrim parasysh edhe faktin që i Dërguari i Allahut (a.s.), përgjatë jetës së tij të bekuar ka dërguar letra

ftese në Islam dhe i ka ngarkuar me detyrën e predikimit si mësues dhe udhëzues disa sahabë duke i dërguar në vende të ndryshme, në pah del një detyrë dhe pozitë themelore që mund ta quajmë “Ftesa që umeti bën për në Islam”.

Risalet do të thotë profeci. Profecia është një detyrë fisnike e lidhur me vullnetin dhe zgjedhjen e Allahut Teala. Ndërsa detyra e ftesës për në Islam që ka umeti, do të thotë “detyra e predikimit që i është ngarkuar umetit” si një rezultat i natyrshëm i detyrës së profecisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ajetet në suren Al Imran që kanë lidhje me këtë çështje, detyrën e predikimit e tregojnë prej shkaqeve të madhështisë së umetit të Muhamedit (a.s.):

“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.” (Al Imran, 104)

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...” (Al Imran, 110)

Në këto dy ajete fisnike shprehet qartazi se detyra kryesore e umetit të Muhamedit dhe veçanërisht e dijetarëve të këtij umeti është predikimi i Islamit.

Dijetarët të cilët janë në pozitën e verethetu'l-enbija/trashëgimtarët e pejgamberëve në umet, janë të parët që ngarkohet me këtë përgjegjësi. Musa Xharullah Bigijefi (v. 1949) ka një shprehje shumë me vend: “Detyra e predikimit (përveç cilësisë së profecisë) pas të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ka mbetur umeetit. Domethënë, ditët tonë janë brenda periudhës së predikimit të Islamit nga umeti.”⁵

Bigijefi ka bërë një tekst në lidhje me veçoritë dhe mirësitë e umetit të Muhamedit (a.s.). Në këtë tekst ndër të tjera, ai ka shkruar se detyrat që i janë dhënë të Dërguarit të Allahut (a.s.), i janë dhënë edhe umetit. Ai e vërteton këtë nga dyzet këndvështrime dhe e shtjellon çështjen nën titullin: “Të gjitha përgjegjësitë dhe autoriteti i të Dërguarit të Allahut (a.s.), i kanë mbetur trashëgimi Umetit Islam.” Ndërsa rezultatin e shpreh nga një këndvështrim i ndryshëm: “Sot feja nuk ka asnjë rregull që umeti ta ketë harruar krejtësisht apo ndaj të cilit është i shkuajdesur.”⁶ Domethënë, umeti i Muhamedit është një umet që posedon misionin dhe trashëgiminë e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Meqë nuk do të vijë pejgamber tjetër pas të Dërguarit të Allahut (a.s.), edhe ky umet është umeti i fundit. Për këtë arsye, detyra e tij e predikimit është një detyrë që do të vazhdojë deri në kiamet. Detyra e predikimit të popujve të mëparshëm ka qenë derisa atë detyrë ta merrte një pejgamber dhe umet tjetër. Ndërsa detyra e predikimit që ka umeti i Muhamedit (a.s.), është e vazhdueshme në bazë të kufijve dhe rregullave që kemi dhënë më sipër.

Dështimi që buron nga umeti në këtë çështje, vihet re se natyrisht është bërë shkak për lindjen e disa hezitimeve rreth pozitës dhe rolit të sunetit në zhvillimin individual dhe shoqëror. Këto hezitime kanë sjellë menjëherë edhe kërkimet për rrugëzgjdhje. Kjo është krejt e natyrshe.

RISALET DO TË THOTË
PROFECI. PROFECIA ËSHTË
NJË DETYRË FISNIKE E
LIDHUR ME VULLNETIN
DHE ZGJEDHJEN E ALLAHUT
TEALA. NDËRSA DETYRA E
FTESËS PËR NË ISLAM QË
KA UMETI, DO TË THOTË
“DETYRA E PREDIKIMIT
QË I ËSHTË NGARKUAR
UMETIT” SI NJË REZULTAT I
NATYRSHËM I DETYRËS SË
PROFECISË SË TË DËRGUARIT
TË ALLAHUT (A.S.).

E VËRTETA E QARTË

E vërteta e qartë që e ka dëshmuar historia e Islamit dhe e një-rëzimit është kjo: Njeriu i parë është pejgamberi i parë. Meqë fjala Sunet në kuptimin leksikor do të thotë ecuri apo gjendje, në për herë të parë e kemi njohur atë edhe në planin individual, edhe në atë shoqëror nëpërmjet stilit të jetës dhe prijësisë së Adem-it (a.s.). Domethënë, mënyra e jetesës së një njeriu-pejgamberi gjendet në bazën e aventurës së njeriut në këtë botë si faktori dhe elementi i vetëm i zhvillimit. Për këtë arsye, vlerat që vullneti hyjnor dëshiron t’ia japë njeriut në

plan individual dhe atë shoqëror që nga Ademi, jepen nëpërmjet pejgamberëve dhe prijësisë së tyre. Kjo është një e vërtetë historike shumë e qartë.

Këtë të vërtetë mund ta shprehim edhe në këtë mënyrë: Strukturat dhe mënyrat e jetesës individuale dhe shoqërore që janë prishur apo që kanë ndryshuar në mënyrë negative që në zanafillë, gjithmonë janë ripërtërirë sipas shembullit dhe prijësisë së një të Dërguarit të Allahut që mund t’i thuhet “resul” apo “nebi”. Kjo ripërtëritje është bërë në përputhje me tevhidin dhe duke i dhënë përparësi besimit. Kjo ripërtëritje në fjalë është shndërruar në zhvillim. Se sa herë janë dërguar profetë, nuk mund ta dimë. Ajo që dimë është se profecia e fundit është realizuar me dërgimin e Pejgamberit (a.s.), në plan universal. Marrja përsipër e predikimit të Islamit pas Profetit nga umeti brenda kufijve dhe rregullave që i kemi përmbledhur më sipër, është një gjendje edhe e natyrshe, edhe strukturore.

Dalja herë pas here e pejgamberëve të rremë është edhe një argument tjetër që umeti duhet ta marrë përsipër detyrën e predikimit të fesë. Marrja përsipër e kësaj detyre të shenjtë dhe themelore nga umeti brenda kushteve dhe teknikave të caktuara, do t’i parandalojë tentativat e rreme dhe të pavërteta.

■ **REFERENCAT:** 1) Buhari, Ilm, 9, 10; Fiten, 8; Tevhid, 24; Muslim, Haxh, 446; Ebu Davud, Tetavvu’, 10; Tirmidhi, Haxh, 1; Nesai, Haxh, 111; Ibn Maxhe, Mukaddime, 18; Darimi, Menasik, 72; Ahmed ibn Hanbel, Musned, IV, 31, 32, V, 4, 37, 39, VI, 385, 456. 2) Buhari, Fiten, 8; Ilm, 9, Haxh, 132; Tirmidhi, Ilm, 7. Në lidhje me këtë hadith që shpreh një të vërtetë krejt të natyrshe, është e pamundur të kuptohet Fazllurrahmani, i cili pohon se ky hadith i akuzon sahabët me mungesë të të kuptuarit dhe se për këtë arsye është një hadith i dobët. (Shik. Problemi i Metodologjisë Islame Përgjatë Historisë, fq. 62-63, Ankara, 1997.) 3) Ebu Davud, Ilm, 10; Tirmidhi, Ilm, 7; Ibn Maxhe, Mukaddime, 18, Menasik, 76; Darimi, Mukaddime, 24; Ahmed ibn Hanbel, Musned, I, 37, III, 225, IV, 80, 82, V, 183. 4) Shikoni shënimin numër 3 të kësaj pjese (fq. 41). 5) Për informacion më të detajuar në lidhje me këtë çështje shik. Bigijef, Kitabu’s-Sunneh, (përktheu M. Gërmez), fq. 67-88, Ankara, 2014. 6) Vepra e lartpërmendur, fq. 85.

Dija që të afron te Allahu

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu Teala thotë: ***“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”*** (Al Imran, 104)

Domethënë se ndërmjet umetit islam duhet të dalë një xhema që do ta këshillojë popullin në çdo çështje dhe do ta njoftojë për ato që janë të lejuara dhe ato që janë të ndaluara në shariat. Ja pra, ata që japin këshilla dhe ata që i marrin këshillat janë ata që do të shpëtojnë në këtë botë dhe në botën e përtejme.

Ngaqë urdhërimi në të mirë është farz kifaje, atëherë ky farz bie kur disa nga umeti e kryejnë këtë detyrë. Nëse urdhërimi në të mirë lihet krejtësisht, i gjithë umeti i Muhamedit bie në mëkat.

Muadhi (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“Me marrjen e dijes arrihet njohja e madhështisë së Allahut Teala dhe në pah lind frika kundrejt Tij. Marrja e dijes është adhurim. Diskutimi rreth dijes është tesbih. Të folurit për dijen është xihad. Të mesuarit e atij që nuk di është lëmoshë. Nëse ajo u jepet atyre që e meritojnë, atëherë ajo është afrim te Allahu. Dija është ndarësja e hallallit nga harami dhe argumenti i rrugës së banorëve të xhenetit. Dija është ndihmëse në kohë të vështirë dhe shoqëruese në udhëtim. Ajo është argument në fatkeqësi dhe gëzime. Dija është armë kundër armikut. Ajo është stoli pranë miqve. Allahu Teala ka lartësuar shumë popuj me dije dhe i ka bërë ta përdorin atë në mirësi. Engjëjt e nderuar e duan miqësinë me njerëzit e ditur. Andaj, i prekin dhe i përkëdhelin ata me flatrat e tyre për t’i nderuar. En-*

gjëjt kërkojnë falje për dietarët. Madje, edhe peshqit në det dhe kafshët luten për ata, sepse dija është jeta e zemrave. (Ndërsa vdekja e zemrave është injoranca.) Dija është drita e syve. Allahu Teala ua jep dijen robërve të devotshëm të Tij.” (Imam Birgivi, Tekmile, 48.)

Ebu Dherrri (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, ka thënë: *“O Ebu Dherr! Mësimi i një ajeti nga libri i Allahut në mëngjes është më mirë për ty se sa të falësh njëqind rekatë namaz nafile. Nëse mëson një çështje prej dijes në mëngjes, është më mirë për ty se sa të falësh një mijë rekatë namaz nafile.”*

Abdullah ibn Omeri (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Adhurimi më i mirë është mësimi i dijes së fikhut dhe fetarizmi më i mirë është largimi nga haramet.”*

Edhe në një hadith tjetër i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Largohu nga gjërat që janë haram, do të jesh njeriu më i devotshëm.”* (Tirmidhi, nr: 2305)

Ali ibn Ebi Talibi (r.a.), ka thënë: Pjekuria e kësaj bote është në katër gjëra:

- 1- Dietari të punojë me dijen.
- 2- Injoranti të mos hezitojë nga mësimi i dijes.
- 3- I pasuri të mos shfaqë koprraci në pasurinë e tij.
- 4- I varfri të mos e shesë ahiretin për këtë botë.

Nëse dietari nuk punon me dijen e tij, nëse injoranti heq dorë nga marrja e dijes, nëse i pasuri shfaq koprraci në pasurinë e tij dhe nëse i varfri e shet ahiretin për këtë botë, atëherë do të thotë se ata do të shkatërrohen.

Namazi i cili na mbron nga mëkatet

— Sadik Dana —

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

“...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...” (Ankebut, 45)

Kurse i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë në një hadith, i cili transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.):

“Si thoni? Nëse dikush nga ju pastrohet pesë herë në ditë në një lumë që gjendet përpara shtëpisë, a ngelet më papastërti në trupin e tij?” Sahabët e nderuar thanë: “Nuk ngelet asnjë papastërti.”

“Ja pra, edhe pesë kohët e namazit janë njësoj si kjo. Me anë të namazit Allahu na i fshin të gjitha mëkatet.” (Buhariu dhe Muslimi)

Përpara se të falë namaz, besimtari duhet të marrë abdestin sipas sunetit. Ai duhet të bëjë kujdes për farzet, sunetet, mustehapet (gjërat e pëlqyera në fe) dhe edukatën e abdestit.

Pasi merret abdesti duke zbatuar të gjitha kushtet, radha i vjen faljes së namazit. Namazi është bërë farz natën e Miraxhit. Nga mirësitë që iu dhuruan të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, natën e Miraxhit, përfitojnë ata që falin namazin. Për këtë arsye namazi është Miraxhi i besimtarit.

Gjatë namazit, kur besimtari ndodhet në këmbë, duhet ta drejtojë shikimin te vendi i sexhdes; kur është në ruku, duhet të shohë majat e gishtërinjve të këmbëve; kur gjendet në sexhde, duhet të shohë majën e hundës dhe kur ulet, duhet të shohë ndërmjet dy duarve. Nëse shikimi drejtohet në këto vende dhe sytë nuk rrëshqasin diku tjetër, mund të dalë në pah gjendja e nënshtrimit në namaz dhe zemra mund të shpëtojë nga mendimet e kësaj bote. Është prej sunetit që në ruku gishtërinjtë e duarve

të mbahen të hapur, kurse në sexhde të ngjiten për njëri-tjetrit. Këto janë disa gjëra që duhen pasur parasysht.

Të mbajturit e gishtërinjve të hapur apo të ngjitur nuk është diçka e kotë që s’duhet vlerësuar. Nuk ka mirësi më të madhe për ne sesa zbatimi i Islamit.

Imam Rabbani (k.s.), thotë:

“Pasi të kemi përvetësuar besimin, duhet patjetër të mësojmë urdhrat dhe ndalesat e fesë sonë. Është e domosdoshme të mësojmë farzet (obligimet), vaxhipet, gjërat hallall dhe haram, mekruhet (gjërat e urryera në fe) e dyshimet dhe të veprojmë siç na kërkohet prej tyre. Çdo mysliman duhet ta mësojë Ilmihalin (libër me rregullat bazë të fesë). Nuk quhet me besim të plotë një mysliman që nuk i ka mësuar këto. Myslmani duhet të zbatojë urdhrat e Allahut Teala dhe të përpiqet të jetojë ashtu siç kërkon Ai. Ajo që Allahu (xh. xh), urdhëron dhe pëlqen më së shumti të bëjë besimtari, është falja e namazit pesë kohë në ditë, sepse namazi është shtylla e fesë dhe Miraxhi i besimtarit.

LUTJAJONË

O Zot! Na bëj prej atyre që e falin siç duhet namazin! Padyshim se namazi mbart një sërë misteresh, prandaj na i bëj të ditura këto mistere! Na e shto besimin e sinqeritetin ndaj Teje dhe na e zbukuro moralin, në mënyrë që ta kryejmë adhurimin ndaj Teje me nënshtrim të plotë. Ti nuk ke as fillim e as fund, je më i Madhi i të mëdhenjve! As madhështia Jote nuk ka kufi. Ti je më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve dhe Falës i madh.

Kurse ne jemi krijesat e Tua të dobëta. Na mëshiro o Zot! Na i fal mëkatet që kemi bërë dhe mëkatet që bëjmë pa qenë të vetëdijshëm!



PËRSËRI PENDIM

PËRSËRI PASTRIM NGA MËKATET

— Vahit Gëktash —

Pendimi është recetë shpëtimi për njeriun. Është arratisje nga dëshpërimi, depresioni, papastërtia dhe nga çdo gjë e keqe që e sulmon shpirtin. Pra është strehim te esenca, te natyrshmëria njerëzore. Është një mbledhje e vetes pas shpërqendrimit dhe një “stop!” i thënë ndaj tërbimit të nefsit. Është kërkimi i një limani të sigurt dhe dalje nga errësira në dritë. Është riekzistenca me thirrjen: “Eja o rob i im!”, në një kohë kur të janë mbyllur

NËSE PENDIMI DHE LUTJA BËHEN DUKE QARË, ATËHERË KJO BËHET SHKAK PËR PRANIMIN E TYRE. KUR BËHET ISTIGFAR, DUHET TË KETË SINQERITET, LOT DHE KËMBËNGULJE PËR TË MOS IU KTHYER MË MËKATIT. PRANDAJ NË TEUBE LOTËT E PENDIMIT JANË SHUMË TË RËNDËSISHËM. PËR T’U AFRUAR TE ALLAHU I MADHËRUAR, NJË NGA FAKTORËT KRYESORË JANË LOTËT QË DËRDHEN ME PENDIM.

Pendohem o Zot për gabimet në të cilat kam rënë. Për mëkatet që kam bërë me vetëdije dhe pa vetëdije.

Abdurrahim Rumi



të gjitha dyert, është ngritja në këmbë me “dorën” e Zotit kur je rrëzuar dhe askush nuk ta ka zgatur dorën. Është rilindja jonë, mbështjellja e krahëve tanë të plagosur, kërkimi i shërimit të shpirtit të plagosur, të pastruarit pasi jemi ndotur, është pastrimi deri në atë gradë siç ishim kur lindëm nga nëna. Sa shumë nevojë kemi për një pendim, për t’u pastruar sërish, për ta bërë shpirtin si atë të një fëmije! Për këtë arsye, le të pendo kemi sërish, t’i kërkojmë sërish falje Allahut dhe të ripastrohemi.

Në gjuhën arabe fjala “teube”, do të thotë të kthehesh, të drejtohesh, të ndjesh pendim për

mëkatet dhe veprimet e këqija.¹ Njerëzit e zakonshëm pendohen për gjynahet, ndërsa njerëzit që kanë nivel të lartë pendohen për shkujdesjen.²

Një nga temat kryesore të tasavufit (mistikës) është zemra. Largimi i errësirës dhe pikëllimit nga zemra bëhet me anë të teubes, istigfarit, pendimit dhe përgjërimit ndaj Allahut Teala.³ Për këtë arsye, teubeja (pendimi) nga shumë sufi është konsideruar si grada e parë në tasavuf.

Sami Efendiu e përkufizon kështu istigfarin: “Përveç kërkimit të faljes së mëkateve dhe mbulimit të tyre nga Allahu Teala, istigfar quhet edhe kërkimi i mëshirës me përmendjen e Allahut (xh.xh) dhe kryerjes së adhurimeve si namazi etj., që bëhen shkak për mëshirë dhe falje të mëkateve.”⁴

Sipas Kushejrit, i cili ka qenë prej sufive të periudhës së parë, teube do të thotë që ta lësh mëkatin duke pasur frikë nga ndëshkimi i Allahut (xh.xh.). Ndërsa inabe do të thotë edukim edhe i të fshehtës së bashku me nefsin që ka filluar të rregullohet me teube. Gjithashtu kemi edhe “evbe” e cila është grada më e përparuar e teubes. Evbe do të thotë t’i drejtohesh vetëm Zotit (xh.xh.), për të fituar kënaqësinë e Tij.⁵

Sami Efendiu thotë në lidhje me teuben:

“Për atë që Allahu ia ka mundësuar bërjen e teubes dhe istigfarit, padyshim ka përgatitur edhe praimin e tij.”⁶ “Në istigfar gjendet lutja për mbulimin e gjynahut. Në fjalën “Subhanallah”, gjendet lutja për zhdukjen e mëkatit. Kjo është një fjalë e vogël, por ka një kuptim dhe përfitim mjaft të madh. Kurse me Hamdin falënderohet Allahu Teala.”⁷ Për këtë arsye, istigfari është mënyra e vetme që njerëzit të shpëtojnë nga ndëshkimi.⁸

“Njeriu bën mëkate për shkak të injorancës së

tij. Por nëse pas kësaj pendohet dhe e përmirëson sjelljen, Allahu është Gafurr (i Mëshirshëm) dhe Rrahim (Falës). Për ata që pendohen Allahu Teala e ka bërë farz faljen.”⁹

Sado të mëdha t’i ketë mëkatet njeriu, nuk duhet ta presë shpresën nga Allahu Teala, sepse mëshira dhe falja e Tij janë më të mëdha se çdo gjë. Të zmadhosh mëkatin do të thotë të shkëpusësh shpresën nga Allahu i Madhëruar. Kjo është gjendja kur shkëputet shpresa nga Allahu (xh.xh.). Shkëputja e shpresës nga Allahu Teala është kufër. Teubeja (pendimi) duhet të mbështetet me vepra dhe adhurime, por nuk duhet t’u besojmë vetëm veprave dhe adhurimeve.¹⁰

Në ajetin fisnik thuhet: “**Kush bën një vepër të mirë sa një grimcë, do ta marrë shpërblimin e saj. Kush bën një vepër të keqe qoftë sa një grimcë, edhe ai do ta marrë ndëshkimin e saj.**”¹¹ Nisur nga ky ajet, besimtari duhet ta arrijë dashurinë e Allahut Teala duke iu bindur Atij. Këtu është edhe shpëtimi.”¹²

“**Përrjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.**”¹³ Në këtë ajet fisnik Allahu (xh.xh), së pari ka shprehur pendimin. Andaj, pendimi nevojitet i pari, në mënyrë që veprat dhe besimi të pranohen e të plotësohen.¹⁴ Për këtë arsye, tarikatet kanë pasur si prioritet teuben (pendimin).

Sami Efendiu e transmeton kështu një fjalë që vjen nga Umeri (r.a.): “Të heqësh dorë nga mëkati është më e lehtë se të preokupohesh me pendimin.”¹⁵ Prandaj, mbyllja e rrugëve që të shpien në atë mëkat, në vend që të pendohesh për një mëkat pasi e ke kryer atë, është qëllimi kryesor i tasavufit (mistikës islame).

Sami Efendiu na jep këto këshilla të transme-



tuara nga Imam Gazaliu: “O bir! Ngrihu natën për tehexhud (namaz nate)! Bëj istigfar në kohën e agimit! Ky është urdhër i Allahut. Ky urdhër nuk është lënë në dëshirën tënde, por është obligim për ty.”¹⁶

Koha e agimit është një kohë ku begatia, bereqeti dhe mirësia është më e madhe. Në këtë kohë rrezatimi i dritës hyjnore është më i madh se në kohët e tjera.¹⁷

Allahu Teala na bën të ditur se besimtarët në kohën e agimit janë në gjendje istigfari. Xhaxha Hysejri nga Bursa tregon disa këshilla të Sami Efendiut në lidhje me këtë çështje: “Një ditë pas takimit me Sami Efendiun, më tha: Në kohën e agimit bëni istigfar. Bëni një teube të madhe, një sejjidu’l-istigfar, një kelime-i tevhid dhe këndon salavatet. Nëse ky amanet kryhet veçanërisht në kohën e agimit, atëherë quhet se ke përfituar. Nëse nuk neglizhohet, kjo do të bëjë të fitoni mirësi që do t’ju gëzojnë në këtë botë dhe në ahiret. Në kohën e seherit (agimit) Allahu Teala pret lutjet e robërve të Tij.”¹⁸

Këto fjalë të Sami Efendit në lidhje me kohën e agimit, i transmeton i ndjeri Dursun Aksoj Efendi: “Sami Efendi na këshillonte të ngriheshim në kohën e agimit duke na thënë: “Në kohën e seherit dyert e kërkimit janë të hapura. Adhurimi, lutja dhe çdo lloj kërkese që i drejtohet Allahut në këtë kohë, pranohen nga Ai (xh.xh).”¹⁹

Sami Efendi, pasi jep shembullin e Ademit (a.s.) dhe pendimin që ai bëri pasi u përzu nga xheneti, kujton se ai iu lut Allahut me fjalët: “O Zot, unë i bëra keq vetes, andaj më fal!”²⁰ - dhe bëri për një kohë të gjatë istigfar me lot në sy. Pas kësaj thotë:

“Këta njerëz të mëdhenj që kanë bërë mëkate kaq të vogla në jetën e tyre, kanë derdhur kaq shumë lot pendimi. Mendoj se çfarë duhet të bëjnë vallë ata që nuk ndalojnë së mohuari. Pendimi

është një sapun që të pastrohet nga papastërtitë e shpirtërore. Nëse robi heq dorë nga veprat e këqija dhe e rregullon gjendjen e tij, edhe Allahu Teala e ndreq atë dhe ia kthen mirësitë që ka humbur.”²¹

Një nga përfitimet e teubes dhe istigfarit është se parandalojnë fatkeqësinë. Në këtë ajet fisnik vihet në fokus kjo gjendje: “Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t’i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij.”²²

I nderuari, Abdullah Sert në lidhje me këtë temë tregon një anekdotë të tillë: “Në vitin 1974 në Gediz ra tërmet. Në atë kohë Sami Efendi thërret Musa Efendiun që t’u vijë në ndihmë vëllezërve në Gediz. Për më tepër, ai i thotë: ‘Thuaju atyre të bëjnë istigfar’.”²³

Nëse pendimi dhe lutja bëhen duke qarë, atëherë kjo bëhet shkak për pranimin e tyre. Kur bëhet istigfar, duhet të ketë sinqeritet, lot dhe këmbëngulje për të mos iu kthyer më mëkatit.²⁴ Prandaj në teube lotët e pendimit janë shumë të rëndësishëm. Për t’u afruar te Allahu i Madhëruar, një nga faktorët kryesorë janë lotët që derdhen me pendim.²⁵

Sa bukur e përkufizojnë Sami Efendiun këto fjalë të thëna për të: “Ishte i buzëqeshur në lidhje me njerëzit, por ata që e njihnin nga afër e vinin re se me sa sinqeritet qante. Atij i pëlqente më shumë të heshte sesa të fliste; më shumë të qante sesa të qeshte. Kur dikush këndonte Kuran, ai meditonte mbi kuptimin e ajeteve fisnike dhe qante kur dëgjonte disa ajete kuranore.”²⁶

Teubeja, istigfari, të qarët me sinqeritet, meditim dhe lotimi duke kënduar e dëgjuar Kuranin Fisnik do të na bëjnë të gjejmë sërish vetveten, do t’u falin zemrave të nxira dhe të ngurtësuarat filladin e pranverës dhe do të na mundësojnë ekzistencën me Allahun Teala!

■ **REFERENCAT:** 1) Tehanevi, Keshshafu’l-Istilahati’l-Funun, I, 162; Ibn Manzur, Lisanu’l-Arab, I, 233. 2) Et’hem Xhebexhiogllu, Fjalori i termave dhe shprehjeve të Tasavufit, Botimet Otto, Ankara, 2015, fq. 493. 3) Mahmud Sami Ramazanogllu, Muhasebe, Botimet Erkam, Stamboll 2013, vëll. 6, fq. 47. 4) Mahmud Sami Ramazanogllu, Muhasebe 3, Botimet Erkam, fq. 105. 5) Abdulkërim Kushejri, er-Risale, përgatiti Sulejman Ulludag, Botimet Dergah, Stamboll 2003, fq. 190. 6) Ramazanogllu, Muhasebe 4, fq. 180. 7) Ramazanogllu, Muhasebe 6, fq. 33. 8) Ramazanogllu, Lufta e Bedrit dhe tefsiri i sures Enfal, fq. 164. 9) Ramazanogllu, Muhasebe 6, fq. 192. 10) Ramazanogllu, Muhasebe 6, fq. 167. 11) Zilzal, 7-8. 12) Ramazanogllu, Muhasebe 6, 193. 13) Furkan, 70. 14) Ramazanogllu, Muhasebe 6, fq. 193. 15) Ramazanogllu, Omeri (r.a.), fq. 5. 16) Ramazanogllu, Muhasebe 4, fq. 122. 17) Ramazanogllu, Muhasebe 3, fq. 107. 18) Abdullah Sert, Bisedat fetare Irfan, fq. 155; “Kohët e takimit me miqtë e Allahut”, Alltënolluk, Shkurt 2014, nr: 336, fq. 38. 19) Selman Tan, “Me vëlla Dursun Aksojin para se të ndërronte jetë 2”, Alltënolluk, nr: 361, Mars, 2016. 20) Kasas, 16. 21) Ramazanogllu, Tefsiri i sures Bakara, fq. 147. 22) Enfal, 33. 23) Abdullah Sert, Bisedat fetare Irfan, Botimet Erkam, Stamboll 2017, fq. 170. 24) Ramazanogllu, Lufta e Tebukut, fq. 70. 25) Ramazanogllu, Muhasebe 6, fq. 194. 26) Zahide Topçu – Mehmet Topçu, Bisedat fetare të të mëdhenjve, Botimet Erkam, Stamboll, 2013, fq. 185.

Ai (a.s.), është udhëzuesi edhe për pastrimin e neftsit

Doç. dr. Mustafa Karabaxhak

Kuptimi leksikor i fjalës tezkije është pastrim dhe dëlirje. Ndërsa kuptimi terminologjik i saj është pastrim i shpirtit nga papastërtitë shpirtërore. Edhe njëra prej detyrave të të Dërguarit të Allahut (a.s.), është pastrimi i njeriut nga papastërtitë shpirtërore dhe lartësimi i tij shpirtërisht. Në Kuranin Fisnik thuhet:

“O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u lexojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë (rregullat e fesë) e t’i pastrojë (nga gjynahet)! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!” (Bakara, 129)

“Po kështu, (për të plotësuar mirësinë Time ndaj jush) ju kam sjellë një të Dërguar nga mesi juaj, i cili ju lexon shpalljet Tona, ju pastron (nga gjynahet), ju mëson Librin (Kuranin) e Urtësinë (rregullat e fesë) dhe ju mëson ato gjëra që nuk i keni ditur.” (Bakara, 151)

PASTRIMI ME SPROVA

Edhe pse tezkija është njëra prej detyrave të profetëve, njerëzit nuk pastrohen apo nuk shpëtojnë vetëm duke thënë besuam. Zoti i Lartësuar na njofton se vdekjen dhe jetën e ka krijuar për t’i sprovuar njerëzit: **“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”** (Mulk, 2) Gjithashtu, Allahu i Madhëruar na njofton se absolutisht do ta sprovtojë çdo mysliman duke u shprehur: **“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit.”** (Bakara, 155)

Për të kaluar me sukses nga këto sprova të vështira patjetër duhet udhëzimi i të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, sepse, ngaqë Kurani Fisnik i ka zbritur atij, atëherë ai është njeriu që e di dhe e zbaton atë më së miri. Kurani Fisnik te disa tema nuk ka hyrë në detaje dhe ia ka lënë të Dërguarit të Allahut (a.s.), shpjegimin e tyre. Prej këtyre temave mund të përmendim namazin, agjërimin, haxhin, etj. I Dërguari i Allahut (a.s.), duke thënë: **“Falenë namazin siç më shikoni mua duke e falur!”** (Buhari, Ezan, 18.), na ka treguar rekatet, kohën dhe mënyrën e faljes së pesë vakteve të namazit. Gjithashtu, duke thënë: **“Mësojini prej meje ibadetet që do t’i bëni në haxh!”** (Muslim, Haxh, 310.), na ka njoftuar se një haxh i vërtetë mund të kryhet vetëm duke pasuar atë. Përndryshe, haxhi nuk mund të kryhet duke bërë tavaf Qabenë me fërshëllima dhe rrahje duarsh siç vepronin politeistët e Mekës: **“Lutja e tyre në Shtëpinë e Shenjtë ishte vetëm me fërshëllima dhe rrahje duarsh...”** (Enfal, 35)

Allahu i Lartësuar na paralajmëron kundrejt shoqërive që nuk e pranojnë udhërrëfimim e të Dërguarit të Allahut (a.s.), duke na thënë: **“Hebrenjtë thonë: “Uzejri është i biri i Allahut”, të krishterët thonë: “Mesihu është i biri i Allahut”. Këto janë fjalët e tyre, nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e jobesimtarëve të mëparshëm. I vraftë Allahu! Si po shmangen (nga e vërteta)!”** (Teube, 30)

Ai (a.s.), është udhëzuesi ynë edhe për t’u pastruar shpirtërisht

Ne në kuptimin e vërtetë të fjalës kemi nevojë për udhëzimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në mënyrë që ta pastrojmë neftsit. Asnjëherë nuk duhet të devijojmë drejt ekstremizmit në asnjë çështje. Resulullahu (a.s.), i ka qortuar ata që kanë dashur ta teprojnë prej sahabëve dhe u ka kërkuar që ta marrin atë për shembull. Siç na njofton Aishja, (r.a.), Pejgamberi ynë i nderuar gjithmonë i urdhëronte sahabët që të bënin punë për të cilat kishin fuqi. Kur sahabët e nderuar i thoshin: **“O i Dërguari i Allahut! Ne nuk jemi si ti. Allahu t’i ka falë ty gabimet që mund t’i kesh bërë dhe ato që mund t’i bësh.”**, Pejgamberi nxehet aq sa shenjat e zemërimit i dukeshin në qafë dhe pastaj u thoshte: **“Padyshim se unë jam më i devotshmi dhe ai që e njuh më së miri Allahun prej jush.”** (Buhari, Iman, 13.)

Një herë Aishja po i tregonte të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, për një grua që quhej Havla që falte shumë namaz dhe po e lavdëronte atë. Pejgamberi ynë i nderuar ia ktheu: **“Lërinë (gjërat e tilla)! Bëni ato që keni mundësi! Vallahi ju bezdiseni, ndërsa Allahu nuk bezdiset!”** (Buhari, Iman, 32; Muslim, Musafirin, 221.) Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), pa dikë duke falur namaz gjatë mbi disa shkëmbinj, tha: **“O njerëz! Juve ju duhet rruga e mesme. Për Zotin, ju bezdiseni, ndërsa Allahu nuk bezdiset!”** (Ibn Maxhe, Zuhd, 28.)

Në një hadith që e transmeton Ebu Hurejre (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), na tregon se esenca e fesë është lehtësimi dhe se për këtë arsye duhet të mbajmë rrugën e mesme duke u shprehur: **“Padyshim se kjo fe është e lehtë. Çdo njeri që do të përpiqet duke e stërmunduar veten (në mënyrë që t’i ketë veprat pa asnjë të metë) në çështjen e kësaj feje, kjo fe do ta mposhtë atë. Atëherë mbani rrugën e mesme. Afrojuni (Atij edhe nëse nuk mund t’i bëni gjërat e plota) dhe gëzohuni (me adhurimet dhe veprat e vazhdueshme edhe nëse janë të paktë). Kërkoni ndihmë nga Allahu në mëngjes, në mbrëmje dhe në një pjesë të natës.”** (Buhari, Iman, 29.)

Thesaret e humbura

— Ferudun Ozdemir —

Një ditë sulltani vendosi të dilte në rrugët e qytetit së bashku me vezirin e tij. Vërejti se të gjithë ishin të përkushtuar duke i bërë shërbimin e duhur punës dhe për këtë i shprehu një lloj kënaqësie vezirit i cili e shoqëronte. Rrugës vendosën të vizitojnë një treg dhe mu në hyrje të tij u përballën me një farkëtar i cili nuk pushonte së qari. Qante aq shumë sa që gjatë gjithë ditës nuk i afrohej më as edhe një klient. I habitur, sulltani tha me vete:

«Çudi! Çfarë halli mund të ketë ky njeri? Sikur ta dinim do e ndihmonim sado pak.»

Menjëherë iu drejtua vezirit duke i thënë:

«Mësojeni hallin e këtij të gjori dhe më tregoni sa më parë!»

Vazhduan ecjen duke shëtitur në çdo rrugë të qytetit teksa u përballën me një bahçe pemësh frutore. Nuk po u besonin syve të tyre! Kopshtari priste nën një pemë molle, më pas i ngjitej pemës me gëzim por më vonë zbriste duke qarë. Sulltani nuk arriti t'i jepte një domethënie kësaj pamjeje.

«Çfarë ka ky kopshtar? Përse vepron kështu? Nuk po kuptoj asgjë!»- mendoi ai i habitur dhe menjëherë iu drejtua përsëri vezirit:

«Përse vepron kështu ky njeri, mësoje menjëherë!»

Sulltani vazhdoi përsëri rrugën së bashku me vezirin e tij. Klima ishte aq e përshtatshme sa nuk po i bëhej të ndalonte. Gjëlberim, aromë lulësh, kthjelltësi qielli, ishte një mrekulli... Rrugës u përballën me një lypsar të verbër. E çuditshme ishte që njerëzit i falnin diçka në dorë por asnjëri nuk kalonte pa e goditur me shuplakë në qafë. Sa herë goditej lypsari thoshte: «Ju falënderoj, ju falënderoj!»

Sulltani i habitur mendoi:

«A thua janë çmendur këto njerëz dhe unë akoma nuk e di?»

Pastaj i inatosur me veten tha:

«Unë jam sulltani i këtij vendi! Këto njerëz duhet të kenë një arsye që veprojnë kështu, por unë nuk di asgjë! Kush e di edhe sa e sa të tjerë mund të jenë si këta.»

U kthye përsëri nga veziri dhe i tha:

«Dëgjoje hallin e këtij lypsari dhe menjëherë më informo!»

Sulltani u kthye në saraje por atë nuk e zuri gjumi nga ajo çfarë kish parë. Të nesërmen veziri urdhëroi të silleshin në saraje të tre, farkëtar, kopshtari dhe lypsari. Të frikësuar ata u detyruan t'i përgjigjeshin thirrjes së sulltanit dhe kur mbërritën në saraje i pari filloi të tregonte farkëtar:

«Një ditë para dyqanit tim kaloi një person që shiste pula. E ndala dhe bleva dy prej tyre. E thirra ndihmësin dhe e porosita t'i dërgonte në shtëpinë time për t'i gatuar. Njërin e lashë për familjen time ndërsa tjetrën e mora për vete.

«Kam shumë punë», i thashë atyre, «Mbase do punoj tërë natën.»

Pak para kohës së akshamit çiraku më solli pulën e gatuar. Isha aq i uritur sa që menjëherë shtrova tryezën dhe fillova të haja. Në atë moment u shfaq një mace. Nuk e kuptova nga erdhi. E kuptova që edhe ajo ishte e uritur dhe nuk pushonte së mjaullituri. Por prapë së prapë unë nuk i dhashë asgjë. Më kishte mbetur vetëm një kofshë dhe një krah i pulës. Sapo kisha filluar të haja krahun kur macja foli:

«Nëse ma jep atë krah do të të jap njëqind mone-dha ari.» E folura e saj më habiti por përsëri nuk e dëgjova. Tanimë kisha marrë në duar kofshën kur përsëri ajo foli:

«Mos e ha atë! Ma jep mua! Në këmbim do të të jap një thesar!»

Por unë e dëbova macen dhe e hëngra edhe kofshën. Sapo e kisha ngrënë kur macja u zhduk dukë

lënë pas një rreze drite. U afrova, ç'të shoh! Një vrimë, dhe nga kjo vrimë dukej një thesar. Sa herë zgjatja duart thesari humbiste. Po çmendesha! Sa herë largohesha thesari shfaqej përsëri, por sa herë afrohesha ai humbiste. Prandaj që nga ajo ditë unë nuk pushoj së qari...»

Tani e kishte radhën kopshtari. Ai filloi të tregonte:

«Një mëngjes hyra në bahçe për të mbledhur frutat. Kisha hipur në një pemë molle ku vëreja një zog. Nuk kisha parë asnjëherë një të tillë kaq të bukur. Zgjata dorën për ta kapur, por papritmas ai më rrëmbeu dhe e pashë veten duke fluturuar. Pasi fluturuam për një copë herë zbritëm në një kopsht trëndafilash. Ishte i mrekullueshëm! Nuk kisha parë e as imagjinuar të ketë trëndafila në ato ngjyra aq të bukura. Po çmendesha! Duke u endur në kopsht para m'u shfaq një i moshuar. U ulëm në një qoshe bashkë dhe ai filloi të më fliste:

«Atë zog ta dërgova unë! I kërkova të të rrëmbente dhe të të sillte tek unë. Të kam birësuar.» Më pas më mori dhe më dërgoi në një saraj madhështor. Aty ndodhej një thesar i papërshkrueshëm. Plaku foli përsëri:

«Tanimë jam moshuar mor djalë! Së shpejti do më trokasë vdekja! Nëse pranon të bëhesh biri im, e gjithë kjo pasuri është e jotja.» E pranova me shumë dëshirë propozimin e tij dhe sapo u largua unë menjëherë rrëmbeva një unazë dhe e futa në xhep. Nuk vonoi shumë dhe plaku u kthye, por fytyra i kishte ndryshuar dhe i mërzhitur e thirri zogun duke i thënë:

«Ktheje këtë njeri nga e ke marrë! Unë nuk dua një pasardhës të tillë!

Zogu më rrëmbeu dhe më solli tek pema. Tani e shoh atë sa herë jam nën pemën e mollës. Ngrihem mbi pemë por zogu zhduket. Dhe kështu unë zbres duke qarë...

Kjo ishte historia e kopshtarit. Sulltani dhe veziri po i dëgjonin me habi teksa radhën e kishte tashmë lypsari:

«Unë isha një njeri që gëzoja shëndet të plotë. Nuk isha i verbër. Isha i lumtur. Zotëroja 70 kuaj

me të cilët transportoja mallrat e tregtarëve. Kisha një punë që më jepte shumë para, nuk kisha nevojë për askënd. Por për shkak të pangopësisë sime humba gjithçka.

Një ditë një tregtar kërkoi nga unë që t'i transportoja mallrat në një qytet tjetër. Ramë në ujdë në këmbim të një pagese të mirë. Rugës tregtari më tregoi që i tërë malli që transportonte përbëhej nga monedha ari. Papritmas dëshira për të zotëruar një pasuri të tillë m'i errësoi sytë dhe fillova të mendoja gjëra që kurrë nuk i kisha imagjinuar. Vendosa ta vras tregtarin dhe ndalova kuajt. Me tha që nuk kishte kohë të humbiste dhe se duhet të lëviznim sa më shpejt. Por unë nuk e dëgjova dhe i thashë:

«Do të të vras dhe e gjithë kjo pasuri do jetë e imja!» Tregtari më propozoi të me jepte gjysmën e arit por nuk pranova. I doja të gjitha! Më duhej ta vrisja! As unë nuk e dija se zotëroja një zemër të tillë kaq të sëmurë...Në momentin kur kisha marrë thikën për ta vvarë,

«Ndal!»- tha ai. «Kam diçka që kur e lyen njërin sy mund të shikosh të gjitha thesaret e nëndheshme.»

«Ma lyej syrin, ta shohim!» - i thashë.

Ah sikur mos t'i thoja. Nxori nga xhepi i tij një lloj lapsi për sy dhe me të vërtetë fillova të shoh thesare të padukshme. I kërkova menjëherë të më lyente edhe syrin tjetër.

«Jo, nuk bën!»- tha ai,

«Nëse lyen edhe syrin tjetër do verbohesh.»

Por unë nuk e besova dhe i rrëmbeva nga duart lapsin më cilën lyva edhe syrin tjetër.

Nuk vonoi shumë dhe sytë mu errësuan. U verbova! Tregtari mori kuajt e mi dhe u largua.

Sa herë njerëzit më falin diçka i kërkoj atyre të më godasin me shuplakë për të shpëguar gabimin tim.»- përfundoi historinë e tij dhe lypsari...

Sulltani i dëgjoi me vëmendje të tre historitë, të farkëtarit, kopshtarit dhe lypsarit. U ndihmoi me pasurinë e tij dhe u dha nga një detyrë në saraj: Secili do tregonte historinë e tij njerëzve. Do u tregonte që njerëzit të zinin mend!

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI



"Thirri njerëzit për haxh dhe ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta."

(Haxh, 27)

Falitorja e shenjtë në Mekë është tempulli i parë i themeluar dhe dedikuar plotësisht adhurimit të Allahut. Ndërtuesit e saj janë dy profetë të mëdhenj babë e bir, njëri u hodh në zjarr si dënim për injorimin që i bëri adhurimit të idhujtarisë kurse tjetri si bindje ndaj urdhrit të babait, e dorëzoi veten për tu sakrifikuar. Kjo është shtëpi e zgjedhur për myslimanët si kible (pikë orientimi gjatë adhurimit).

Drejtimi kah qabja është themelore në kryerjen e namazit por edhe për ibadete të tjera sepse ajo është shtëpia e parë e shenjtë e ndërtuar për ibadet në sipërfaqen e tokës duke qenë edhe shenjë udhëzimi për gjithë besimtarët. Kjo është kibla që bën të mundur që të gjithë besimtarët kudo ku janë në të katër anët e botës ta ndjejnë vetën si një organizëm i vetëm, ky bashkim vjen si pasojë e adhurimit të një Zoti të vetëm, besimit të një Pejgamberi dhe drejtimit drejt një drejtimi. Ajo është një shtëpi ku çdo kush e ndjen veten të sigurt dhe kështu ka qenë gjatë gjithë historisë para dhe pas Islamit.

Pastaj Allahu urdhëron Ibrahimin të ftojë njerëzit për të vizituar këtë shtëpi simbol të monoteizmit, dhe e garanton se do t'i përgjigjen ftesës së tij dhe njerëzit do dynden nga të gjitha anët për të

vizituar Qaben, vendin e shenjtë në këmbë apo me mjete të tjera udhëtimi. Për hir të lidhjeve historike dhe shpirtërore Allahu e bëri obligim, për bashkësinë myslimane, kryerjen e pelegrinazhit në faltoren e shenjtë. Ritet jetëdhënëse të kësaj vizite të shenjtë gjallërojnë ndjenjat e besimit dhe bindjes, dhe i forcojnë dhe më shumë ndjenjat e përkushtimit ndaj Zotit. Fjalët e thëna janë plot me domethënie fisnike. Haxhi që është edhe shtylla e pestë themelore e Islamit së pari është rit fetar, por në mënyrën islame pra është edhe tubim politik edhe panair tregtar, të gjitha së bashku. Ky është vendi i njohjes, është vendi ku takohet kjo botë me botën tjetër. Besimtarët këtu mblidhen nën një flamur të vetëm, flamurit të besimit, nën këtë flamur ku humbet çdo dallim racor. Kjo shtëpi është e mbrojtur nga Allahu dhe që nga koha e Ibrahimit (a.s.) deri më sot vazhdon të qëndrojë në funksionin e saj dhe do vazhdojë deri në fund. Miliona besimtarë vazhdojnë të vijnë edhe sot e kësaj dite si përgjigje e thirrjes së Ibrahimit (a.s.). Kjo do jetë kibleja e myslimanëve deri në Ditën e Kiametit. Të gjithë besimtarët mysliman do të kthehen nga Qabja pa dallim kombi, race, gjuhe apo ngjyre.

Sipas një transmetimi nga Ebu Katade (r.a.) Pejgamberi (a.s.) është pyetur rreth agjërimit të ditës së Arafatit dhe është i përgjigjur duke thënë::

“Agjërimi i saj shlyen mëkatet e vitit të kaluar dhe vitit pasardhës.”

Dita e Arafatit është dita e nëntë e muajit Dhilhixhe, një ditë para ditës së bajramit. Dita e Arafatit është e veçantë, pasi qëndrimi në Arafat është prej kushteve të Haxhit. Muhamedi (a.s.) ka thënë “Haxhi është Arafat.”

Prej agjërimeve vullnetare është edhe agjërimi ditën e Arafatit. Meqenëse dita e Arafatit është dita kryesore e haxhit, pra dita kur pelegrinët plotësojnë haxhin, nuk është e këshillueshme që të agjërohet nga pelegrinët. Kjo ditë për ata është si një ditë feste. Kurse për besimtarët që nuk kanë shkuar për të kryer haxhin, agjërimi në këtë ditë është e pëlqyeshme. Siç na informon Pejgamberi (a.s.) se agjërimi në këtë ditë shlyen mëkatet e vitit të kaluar

dhe vitit pasardhës. Dijetarët thënieën “shlyen mëkatet” e kanë komentuar si shlyen mëkate e vogla sepse për mëkatet e mëdha është kusht pendimi i sinqertë. Kurse falja e mëkateve për vitin e ardhshëm është komentuar nga dijetarët si mbrojtje nga rënia në mëkate, pra për hir të agjërimit të kësaj dite Allahu i mbron besimtarët nga mëkatet në të ardhmen. Kurse një grup tjetër e ka komentuar shlyerjen e mëkateve të ardhshme pasi të kryhen në vitin e ardhshëm edhe ato janë të falura. Vlen të theksohet se nuk është shume e rëndësishme mënyra se si falen mëkatet por lajmi i mirë për shlyerjen e mëkateve për dy vjet si pasojë e agjërimit për hir të Allahut në këtë ditë të bekuar.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Mirësitë dhe mëshira e Allahut është bollshme.
2. Agjërimi në ditën e Arafatit është ekuivalent me faljen e mëkateve për dy vjet.

Një Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A X I -

5. SADAKAJA DHE DHURIMI

Pas duave dhe kërkimit të faljes, ajo që i bën më tepër dobi të vdekurit është sadakaja e dhënë në emër të tij.

Abdurrahman ibn Ebi Amra tregon se nëna e tij dëshironte të lironte një rob. Ajo e shtyu për në mëngjes lirim, por ndërroi jetë pa ardhur mëngjesi. Abdurrahmani pyeti Kasim ibn Muhammedin:

“Nëse unë liroj një rob, a ka dobi nëna ime prej kësaj?”

Kasimi u përgjigj:

“Sa’d ibn Ubade ka shkuar tek i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe e ka pyetur:”

«Nëna ime ndërroi jetë. Nëse unë liroj një rob në emër të saj, a ka dobi për të?»

«Po!» - ishte përgjigjur i Dërguari i Allahut, (a.s.).” (Muuatta, Itk, 13; shih. Buhari, Uesaja,15.)

Djali i Ebu Bekrit (r.a.), Abdurrahmani, ka vdekur në gjumë dhe nëna jonë Aisheja (r.anha) ka liruar shumë robër në emër të vëllait të saj. (shih. Muuatta, Itk, 14.)

Të gjitha këto, tregojnë se një besimtar që ka ndërnuar jetë, mund të ketë dobi prej duave, sadakave dhe dhurimeve që bëjnë të afërmit dhe vëllezërit e tij besimtar që janë ende gjallë, gjë e cila i motivon edhe më shumë besimtarët drejt mirësive.

Ibn-i Abbasi (r.a.), tregon:

“Një person shkoi tek i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe e pyeti:

«O i Dërguar i Allahut! Nëna ime ka ndërnuar jetë ndërkohë që kishte ende një muaj borxh për të agjëruar. A ta shlyej borxhin në emër të saj?»

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e pyeti:

«A do t’i kishe shlyer borxhet e pasurisë në emër të nënës, nëse ajo do të kishte të tillë?»

«Po, do t’i kisha paguar!»- tha ai.

Atëherë i Dërguari i Allahut ,(a.s.), sqaroi:

«Borxhi ndaj Allahut meriton edhe më tepër të paguhet!» (Muslim, Sijam, 155.)

Të sëmurët dhe të moshuarit, të cilëve u dobësohet trupi përditë e më shumë, duhet të kompensojnë agjërimet e tyre kur të shërohen ose duhet ta lënë në testament kompensimin e atyre ditëve. Nëse ekziston një testament i tillë dhe një e treta e pasurisë së lënë mjafton për çuar në vend testamentin, trashëgimtarët e kanë për detyrë të paguajnë kompensimin. Por nëse një e treta e pasurisë së lënë nuk mjafton për të çuar në vend testamentin ose nëse nuk ekziston ndonjë testament fare, atëherë është e këshillueshme që trashëgimtarët të paguajnë këtë kompensim në formë dhurimesh.

Edhe pse gjatë udhëtimit, sëmundjes, shtatzënisë, zisë për bukë, vuajtjeve të tepërta, etj., është e lejuar të mos agjërosh ose ta ndërpresësh agjërimin e filluar, këto arsytetime nuk e lejojnë mos kompensimin e ditëve që nuk janë agjëruar. Sapo të përfundojë shkak i arsytimit, ato ditë duhen agjëruar kaza. Nëse këta persona kanë ndërnuar jetë pa e plotësuar kompensimin, trashëgimtarët e tyre duhet ta paguajnë këtë kompensimin. Ky veprim, sipas dijetarëve Islam, është konsideruar i lejuar, e madje, i këshilluar!

Po ashtu është thënë se shpagimi për agjërimet e pa mbajtura, jepet edhe pas vdekjes së atyre personave, që pa asnjë arsye nuk kanë agjëruar gjatë jetës, e as që i kanë plotësuar kaza më vonë. Madje ky shpagim mund të konsiderohet si “iskat”¹ për borxhin e agjërimit që ka i vdekuri. Mirëpo, lidhur me këtë temë, mes dijetarëve ka pasur kundërshtime dhe debate.

Debati i sipërpërmendur përqendrohet tek “nama-zi” dhe “agjërimi” për shkak se ato janë adhurime trupore. Ndërsa shpagimi për kurbanin, zotimin, zekatin, e të tjera detyrime si këto, të cila i ndjeri nuk i ka kryer gjatë jetës, konsiderohet e pranueshme që të kryhen nga trashëgimtarët sipas testamentit ose sipas dëshirës dhe mundësive të trashëgimtarëve, në mungesë të ndonjë testamenti. E në fakt, në këto raste ka përputhje të borxhit me shpagimin dhe përveç kësaj këto lloj adhurimesh kanë lidhje

1. **Iskat:**Nëse dikush ka vdekur pa bërë kompensimin apo shpagimin e borxheve apo të adhurimeve si namazi, agjërimi, kurbanin, zotimi, etj., trashëgimtarët e tij duhet t’u paguajnë një sasi të caktuar të varfërve, me qëllim që i vdekuri të shpëtojë prej këtyre borxheve.



me të drejtat e personave të tretë. Gjithashtu, është i lejuar caktimi i një përfaqësuesi për shpërgimin e adhurimeve në pasuri.

Në themel të këtyre mendimeve, me tepër se ndonjë argument ligjor, gjendet dëshira e mirë e mbështetur tek shpresa dhe kujdesi.

6. LEXIMI I KURANIT

Leximi i Kuranit Fisnik dhe dhurimi i sevapit të këtij leximi, për personat që kanë vdekur, është një prej mirësive që mund të bëhet në emër të tyre.

Leximi i Kuranit, e në mënyrë të veçantë i sures JaSin, me qëllim që i vdekuri të përfitojë mëshirën hyjnore, është një metodë e njohur dhe e zbatuar nga të gjithë. Në një hadith fisnik thuhet:

“...JaSin është zemra e Kuranit. Nëse dikush e lexon duke kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe botën tjetër, atij do t’i falen gjynahet. Suren JaSin lexojani edhe të afërmve tuaj të vdekur.” (Ahmed, V, 26.)

Ndërsa në një hadith tjetër thuhet:

“Kur të vdes ndonjë prej jush, varroseni pa e vonuar shumë. Dhe kur ta varrosni, dikush prej jush le t’i lexojë suren Fatiha tek koka dhe pjesën e fundit të sures Bekare (amenerresulu) tek këmbët.” (Taberani, Kebir, XII, 340; Dejlemi, I, 284; Hejthemi, III, 44; Dejlemi, Musned, I, 284.)

Ala ibn el-Lexhlaxh ka transmetuar se në prag të vdekjes, i ati Lexhlaxhi, u ka lënë këtë porosi:

“Kur të më varrosni, thoni (Bismil’lah ue ala sunneti Resulil’lah),² pastaj më hidhni dhé sipër. Tek koka më këndon fillimin dhe pjesën e fundit të sures Bekare. Me të vërtetë, unë kam qenë dëshmitar kur Abdullah ibn Omeri e ka konsideruar të bukur këtë praktikë.” (Bejhaki, *es-Sunenu’l-Kubra*, IV, 56)

Po ashtu, edhe i biri i Ala ibn el-Lexhlaxhit, Abdu-rrahmani ka thënë:

2. (Po të lëmë amanet te Zoti ty) Me emrin e Allahut dhe sunnetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.)!

“Babai më tha:

«Biri im! Kur të vdes bëj një varr si sarkofag! Kur të më varrosni, thoni (Bismil’lah ue ala milleti Resulil’lah), pastaj më hidhni dhé sipër me lopata. Tek koka më këndon fillimin dhe pjesën e fundit të sures Bekare. Unë kam dëgjuar se kështu ka urdhëruar i Dërguari i Allahut, (a.s.).»” (Hejthemi, III, 44.)

Janë interesante edhe këto fjalë, të cilat sahabi Amr ibn As (r.a.), ua ka thënë të pranishmëve si porosi në prag të vdekjes:

“Kur të më shtini në varr, prisni në krye të varrit aq kohë sa ç’duhet për të therur një deve e për t’ia copëtuar mishin, në mënyrë që të gjej mundësi që me anë të pranisë suaj të mësohem me jetën e re dhe t’i përgatis përgjigjet që do të më duhet t’ua jap përfaqësuesve të Allahut!” (Muslim, Iman, 192)

Imam Neueui i cili e citon këtë hadith në veprën e tij, ka transmetuar këto fjalë të imam Shafiut (r.alejh):

“Këndimi i ajeteve dhe sureve në krye të varrit është mustehab. Kurse këndimi i plotë i Kuranit (hatme) është më i bukur!”³

Siç transmetohet edhe në një hadith fisnik, kur Sa’d ibn Muadhi ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i fali namazin e xhenazes dhe pasi e futën në varr e i hodhën dhé sipër, qëndroi tek varri bashkë me sahabët, duke bërë tesbihë dhe duke thënë tekbire.

Ndërsa një prej dijetarëve të mëdhenj të brezit të tabiinëve, Imam Sha’bi thotë:

“Kur u vdiste dikush nga të afërmit, ensarët e vizitonin shpesh varrin e tij dhe këndonin Kuran pranë tij.”⁴

Po ashtu, Imam Sha’bi ka thënë:

“Ensarët lexonin suren Bekare pranë të vdekurit.” (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, II, 445/10848.)

Gjithashtu, edhe Xhabir ibn Zejdi, prej tabiinëve,

3. Neueui, Rijadu’s-Salihin, f. 293

4. Ebu Bekir ibn Hallal, el-Kirae inde’l-Kubur, Bejrut, 1424, fq. 89. Nr: 7.



“...JaSin është zemra e Kuranit. Nëse dikush e lexon duke kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe botën tjetër, atij do t’i falen gjynahet. Suren JaSin lexojani edhe të afërmve tuaj të vdekur.” (Ahmed, V, 26.)

lexonte suren Ra'd pranë të vdekurit. (shih. Ibn-i Ebi Shejbe Musannef, II, 445/10852.)

Siç kuptohet nga të gjitha këto transmetime, vizita e varreve, përhëndetja me selam e banorëve të varreve, lutja dhe kërkimi i faljes për ta, bamirësia dhe leximi i Kuranit në emër të tyre, është mëshirë edhe për të gjallët edhe për të vdekurit.

Fjalët dhe praktikat e Profetit tonë (a.s.) dhe shokëve të tij në lidhje me vizitën e varreve, na tregojnë qartë se si duhet të veprojmë në këtë çështje, pa kaluar në ekstreme.

7. NGUSHËLLIMET

Shkuarja për ngushëllim tek njerëzit të cilëve u ka vdekur ndonjë i afërm ose kanë pësuar ndonjë fatkeqësi, me qëllim për t'iu gjendur pranë e për t'i këshilluar me durim, është një detyrë e rëndësishme shoqërore.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do ta veshë me rroba nderi myslimanin, i cili e ngushëllon vëllain e fesë në rastin e një fatkeqësie.” (Ibni Maxhe, Xhenaiz, 56)

Biri i njeriut është krijuar i dobët. Ai ka nevojë për mbështetje dhe ngushëllim në raste fatkeqësie e hidhërimi. Për këtë arsye, përcjellja e xhenazes dhe ngushëllimi janë detyra të rëndësishme Islame dhe njerëzore. Neglizhimi i tyre është gjynah dhe mangësi e madhe për njeriun.

Përveç kësaj, të mos harrojmë se nesër edhe ne do të kemi shumë nevojë për një vizitë ngushëllimi, që sot mund të na duket e tepërt për vëllain tonë. Nëse dëshirojmë të gjejmë një degë ku të mbahemi në kohë nevojë, duhet të përpiqemi që sot të ndajmë hidhërimin e vëllezërve tanë dhe t'ua qajmë hallet atyre. Një vëllazëri e vërtetë kërkon që ashtu siç ndahen gëzimet, ashtu të qahen edhe hallet së bashku me vëllezërit e fesë.

8. GABIMET QË BËHEN PAS TË VDEKJES SË DIKUJT

Detyra e fundit që besimtarët kanë ndaj njëri-tjetrit, në jetën e kësaj bote të përkohshme, është pjesëmarrja në varrimin e vëllait të fesë, falja e namazin të xhenazes dhe varrosja e tij. Përveçse detyra e fundit ndaj të vdekurit, kjo në të njëjtën kohë është edhe shenjë respekti dhe vlerësimi ndaj të afërmeve të tij.

Myslimanit i ka hije që të jetë pranë vëllait të fesë si në momente gëzimi, ashtu edhe në momente hidhërimi. Dhe pikërisht vdekja është momenti më i

hidhur dhe më mësimdhënës i jetës. Në ceremonitë e varimit zemrat zbuten në klimën e medimit të thellë dhe dhimbjes e hidhërimit që shkakton ndarja. Ata që arrijnë të marrin mësim prej vëllait të tyre të vdekur, gjejnë mundësinë e përsiatjes, në aspektin e shtimit të kujdesit ndaj urdhrave të Allahut të Madhëruar për pjesën tjetër të jetës së tyre.

Sot përballemi shpesh me gjendje dhe veprime që bien në kundërshtim me parimet hyjnore dhe nuk përputhen aspak me etikën Islame. Këto bid'ate (risi) dhe gabime burojnë nga injoranca, indiferenca, interesi ose ndikimi i feve dhe kulturave të huaja. Kështu mund të përmendim:

- *Dërgimin e kurorave me lule në xhenaze.*

- *Vendosjen e xhenazes mbi altar dhe homazhet.*

- *Dërgimin e xhenazes në vendin ku ka punuar kur ka qenë gjallë dhe mbajtjen e fjalimit tek koka e tij.*

- *Përcjelljen e xhenazes duke e shoqëruar me bandë muzikore ose me muzikë funebre.*

- *Pritjen e xhenazes në morg ose frigoriferë pa pasur arsye.*

Në Islam i jepet përparësi varrosjes së shpejtë të xhenazes, pa e pritur gjatë. Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka bërë shumë paralajmërime. Për shembull, kur Talha ibn-i Bera (r.a.) u sëmurë, Profeti ynë (a.s.) i vajti për vizitë dhe kur u largua prej aty, i porositi kështu të pranishmit:

“Shoh që Talhas i është afruar vdekja. Nëse ndërton jetë më lajmëroni! Veproni shpejt në përgatitjen dhe qefinosjen (e xhenazes), sepse nuk është mirë që xhenazja e një myslimani të pritet gjatë pranë familjes së tij!” (Ebu Daud, 34.)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka thënë kështu Aliut (r.a.):

“Tre gjëra mos i vono! Namazin që i ka hyrë koha, xhenazen e përgatitur (për varrim) dhe gruan pa burrë së cilës i ke gjetur njeriun e përshtatshëm (për ta martuar).” (Tirmidhi, Salat, 13/171.)

Po ashtu edhe larja e xhenazes me ujë të ftohtë apo të valuar është e gabuar. Në fakt, xhenazja duhet të lahet me ujë të vakët, duke treguar respekt ashtu siç tregohet edhe për një të gjallë.

Ummu Kajs bint-i Mihsan (r.anha), tregon:

“Djali im ndërroi jetë dhe unë u hidhërova shumë. Ashtu e mërzitur, i thashë atij që po e lante:

«Mos ma laj djalin me ujë të ftohtë se do ta vrasësh!»



Ukkashe (r.a.), shkoi menjëherë tek i Dërguari i Allahut dhe e lajmëroi për ato që thashë unë. Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), buzëqeshi dhe tha:

«Kështu thotë ajo?! Atëherë jeta e saj u zgjat!»

Transmetuesi i këtij hadithi, ka thënë: “Ne nuk kemi parë askënd tjetër të jetoj më gjatë se ajo grua.” (Nesai, Xhenaiz, 29.)

Një tjetër prej gabimeve, që haset shpesh në ditët tona, është edhe bartja e xhenazes për ta varrosur në një vend tjetër.

Xhenazja mund të varroset vetëm në qytetin ku ka vdekur, në një varrezë myslimane. Nëse nuk ka varrezë të tillë, atëherë gjendet një vend i përshtatshëm. Kjo është një çështje me rëndësi, sepse ashtu siç bëhet kujdes për të qëndruar me njerëzit e mirë gjatë jetës, ashtu duhet të bëhet kujdes që edhe pasi të vdesë myslimani të varroset midis njerëzve të mirë.

Një nga qëllimet e shërbimit ndaj xhenazes është kujtimi i vdekjes, meditimi për botën tjetër dhe marrja e mësimi prej ndodhisë. Për të mos e zbehur këtë qëllim, disa dijetarë nuk e shohin të pëlqyeshme as leximin e Kuranit, tekbirëve dhe dhikrit që mund të bëhet me zë të lartë, gjatë përcjelljes së xhenazes. Në shërbimet ndaj xhenazes, ku duhet të mbizotërojë modestia, thjeshtësia dhe sinqeriteti, nuk është e drejtë të bëhen ceremoni luksoze që çojnë në shpërdorim të tepërt.

Tregohet se ndër sahabët fisnikë Usejd ibn Hudajr (r.a.), ka qenë një njeri shumë i virtytshëm. Ai thoshte shpesh:

“Nuk kam asnjë dyshim se do të jem prej banorëve të Xhenetit nëse arrij të qëndroj vazhdimisht në këto tri gjendje:

1. Nëse ruaj gjendjen shpirtërore që ndjej kur lexoj Kuran apo kur e dëgjoj atë nga dikush tjetër.

2. Nëse ruaj vazhdimisht gjendjen shpirtërore e cila më kaplon kur dëgjoj bisadat e Profetit (a.s.).

3. Nëse përjetoj vazhdimisht gjendjen që ndjej gjatë përcjelljes së xhenazes drejt varrezave. Sa herë që ndodhem në ndonjë xhenaze mendoj me vete: “Vallë, çfarë do t’i ndodhë kësaj xhenazeje, si do të vejë halli i saj dhe ku do ta shpien më në fund?!” (shih. Ahmed, IV, 351; Hakim, III, 326/5260.)

Përveç këtyre, nuk lejohet as përzjerja e grave me xhematin e burrave në namazin e xhenazes dhe as shkuarja e tyre për të përcjellë xhenazen tek varri, pa qenë e domosdoshme.

Namazi i xhenazes dhe detyra e pjesëmarrjes në varrim, të cilat konsiderohen virtyte për burrat, nuk janë parë të përshtatshme për gratë dhe është pranuar si “*tenzihen mekruh*”⁵, sepse gratë kanë në natyrën e tyre ndjenja të theksuara të dhembshurisë dhe mëshirës dhe në raste të tilla hidhërimi, është shumë e mundur që ato të bëjnë veprime të papëlqyeshme.

Një nga gratë sahabe, Ummu Atijje (r.anha), ka thënë:

“Ne grave na është ndaluar pjesëmarrja në (namazin e) xhenaze. Por, përcjellja e xhenazes nuk na është ndaluar në mënyrë të prerë.” (Buhari, Xhenaiz, 29, l’tisam, 27; Muslim, Xhenaiz, 34-35.)


Mirëpo edhe nëse gratë nuk përzihen me burrat, futja në rresht për të falur namazin e xhenazes është mekruh. Madje edhe falja e tyre në namazet me xhemat është e lejuar me disa kushte. Kushti më i rëndësishëm është ruajtja nga përzjerja burra-gra. I Dërguari i Allahut, (a.s.), në lidhje me njërin prej dyerve të Mesxhidit Nebeui ka thënë:

“*Sikur t’ia lëmë grave këtë derë!?*”

Pas kësaj, burrat nuk e përdorën më atë derë. (shih. Ebu Daud, Salat, 53/571.)

Ndërsa pas namazit, me qëllim që burrat të mos përziheshin me gratë, Profeti (a.s.) ngrihej pasi gratë ishin shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre. Pas tij ngriheshin edhe sahabët. Në mënyrë të veçantë, namazi i sabahut falej pa u zbardhur ende mirë. Gratë ngriheshin sapo jepnin selam dhe duke u mbështjellë me rrobat e tyre futeshin nëpër shtëpi. Ashtu siç

5. **Mekruh:** Një vepër e cila edhe pse nuk është e haram/ e ndaluar me fe, ajo lejohet vetëm në raste të veçanta dhe urrehet të veprohet në gjendje normale. Ndërsa “*tenzihen mekruh*”, nënkupton veprën e cila është e papëlqyeshme, por më pranë hallallit.



nuk i njihje njeri, ndonjëherë as ato nuk e njihnin njëra-tjetrën.⁶

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), po dilte prej xhamisë, vuri re se burrat po përziheshin me gratë dhe duke iu drejtuar grave tha:

“Mos ecnin në mes të rrugës, por në anë të saj!”

Pas kësaj, gratë filluan të ecnin në anë të murit, aq sa rrobat e tyre ngecnin nëpër mur. (Ebu Daud, Edeb, 167-168/5272.)

Njëherë, në periudhën Emeuite, nëna jonë Aisheja (r.anha) vuri re se gratë po përziheshin me burrat. Për këtë arsye ajo tha:

“Nëse i Dërguari i Allahut, (a.s.), do t’i kishte parë gratë që veprojnë kështu, do t’i ndalonte ato nga ardhja në xhami, njësoj siç i ndalojnë bijtë e israilit gratë e tyre.” (Buhari, Ezan, 163.)

Edhe pse Islami i jep një rëndësi të jashtëzakonshme faljes së namazit me xhemat, për të ndaluar përzierjen e burrave me gratë, ai i ka liruar gratë nga kjo përgjegjësi dhe ka ligjësuar se për gruan është më e virtytshme të falet në shtëpi se sa në xhami. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Mesxhidët më të mirë për gratë janë qoshet e shtëpive të tyre!” (Ahmed, VI, 297.)

Nisur nga kjo, sidomos në kohë fitnesh, është më e përshtatshme që gratë t’i falin në shtëpi namazet e tyre. Mirëpo, në kohët kur nuk bëhet fjalë për fitne, nëse gratë dëshirojnë të shkojnë në xhami për të falur namazin, ato duhet të shkojnë pa u zbukuruar dhe pa u parfumosur.

Ndërsa në dy xhamitë e shenjta (Qabeja dhe Xhamia e Profetit), për shkak të shenjtërisë së vendit, gratë që kanë ardhur për umre apo për haxh mund t’i falin në xhami me xhemat të gjitha namazet, përfshirë edhe atë të xhenazes. Megjithatë, ato duhet të mos zbukurohen, të mos parfumosen, të ruhen nga përzierja me burrat dhe nga shkaktimi i çdo lloj ngatërrese apo fitneje.

Gjithashtu edhe vajtimi me kujë pas të vdekurit është një veprim i ndaluar.

Sipas transmetimit të Enes Ibni Malikut (r.a.), i Dërguari i Allahut, (a.s.), kaloi pranë një gruaje e cila po vajtonte duke bërtitur në krye të një varri dhe i tha:

“Ki respekt ndaj Allahut dhe bëj durim!”

Gruaja u përgjigj:

“Më lër rehat! Halli që më ka rënë mua, s’ të ka rënë ty!”

Gruaja nuk e kishte njohur Profetin (a.s.). Mirëpo më pas, kur i thanë se ai që ia këshilloi të ketë respekt dhe durim, ishte vetë Profeti (a.s.), ajo nxitoi për tek shtëpia e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), hyri brenda dhe tha duke kërkuar falje:

“Unë nuk ju njoha.”

Ndërsa Profeti (a.s.), tha:

*“Durimi i vërtetë, është ai në momentin e parë të fatkeqësisë.”*⁷

Në një rast tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Xhenazja nuk pasohet as me zë (me kujë) e as me zjarr!” (Muuatta, Xhenaiz, 13; Ebu Daud, Xhenaiz, 46/3171.)

Zgjatja e zisë me javë e me muaj të tërë, duke qëndruar të hidhëruar gjithë kohën, është po ashtu një veprim i papërshtatshëm.

Edhe përfolja pas të vdekurit dhe harrimi i tyre janë veprime jo të drejta.

Gjithashtu, edhe falja e namazit në drejtim të varrit dhe ndërtimi i ndonjë faltoreje apo xhamie mbi varr janë të ndaluara.

Një gabim tjetër është edhe punimi i varreve në mënyrë luksoze e madhështore, duke i mbushur ato me lavde dhe shprehje të tepruara. Kjo nuk përshtatet as me moralin Islam e as me etikën njerëzore.

Sado i virtytshëm të ketë qenë ai që ka vdekur, myslimani duhet të ruhet nga shprehjet absolute që nënkuptojnë garancinë që ai person është prej banorëve të Xhenetit. Kjo ndodhi e shpreh shumë bukur këtë të vërtetë:

Një nga sahabët që ishte i njohur për përkushtimin që kishte ndaj adhurimit, Uthman ibën Madh’ un (r.a.), ndërroi jetë në qytetin e Mendinës, në shtëpinë e një gruaje të quajtur Ummu’l-Ala. Kjo grua tha:

“O Uthman! Beto hem se në këtë moment Allahu Teala po të gostitë me të mira.”

Profeti i Allahut, (a.s.), ndërhyu:

“Nga e di ti se Allahu është duke e gostitur?”

Gruaja tha:

“Beto hem për Allahun që nuk e di!”

Profeti (a.s.) sqaroi:

“Shikoni! Uthmani ndërroi jetë. Unë personalisht për të shpresoj të mirën prej Allahut. Mirëpo, megjithëse jam Profet, as unë nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua dhe me ju.”

Ummu’l Ala ka rrëfyer:

“Beto hem për Allahun se pas kësaj ndodhie, nuk fola më në lidhje me askënd.” (Buhari, Tabir, 27)

Një nga gjërat më të rëndësishme, që ua drithëron zemrat robërve të mirë, është frika se mos merren në llogari përpara Allahut për shkak të lavdërimeve të tepërta që u bëjnë njerëzit. Shembull i kësaj, është edhe i nderuari Halid Bagadadi, i cili është cilësuar si *“dielli i ditjeve”* në dije dhe urtësi. Ai ka lënë ama-

6. shih. Buhari, Ezan, 162-166.

7. Buhari, Xhenaiz 32, 43; Ahkam 11; Muslim, Xhenaiz 14-15. Shih edhe Ebu Daud, Xhenaiz 23; Tirmidhi, Xhenaiz 13; Nesai, Xhenaiz 22.

net që pas vdekjes së tij, të mos shkruhen shprehje lavdëruese në gurin e varrit të tij.

Edhe leximi i Kuranit dhe bërja e hatmes “kundrejt pagesës”, gjatë varrimit ose pas tij, është konsideruar bid’at (risi në fe). Këtu bëjnë pjesë edhe këndimi i mevludeve “kundrejt pagesës” apo shtrimi i drekave e darkave me rastin e përvjetorëve të të ndjerit.

Me leximin e Kuranit me rastin e vdekjes së dikujt, shpresohet shpërblimi për atë që e lexon dhe dobia për të vdekurin. Mirëpo kryerja e këtij shërbimi kundrejt një pagese, bëhet shkak që ata të cilët lexojnë Kuranin, të mos e bëjnë këtë për hir të Allahut por për hir të pagesës që do të marrin, gjë e cila çon në humbjen e vlerave dhe të shpërblimeve.

Një prej zakoneve, që konsiderohet bid’at, është edhe “turi/qarkullimi i borxhit të adhurimeve”⁸, i cili zbatohet pas varrimit të të vdekurit. “Iskat”-i, që bëhet për të shpëtuar të vdekurin nga borxhet e adhurimeve nuk duhet të kthehet në një hile.

Imam Muhammedi, duke u nisur nga lejimi i shpagimit që bëhet për agjërimet të cilat nuk mbahen për shkaqe të detyrueshme dhe që as nuk mund të plotësohen më vonë si kaza, ka përdorur metodën e kijasit/analogjisë për të gjykuar në të njëjtën formë edhe në lidhje me namazet e pa falura. Ky veprim është quajtur “*iskat-i salat*”. Në bazë të këtij gjykimi, për çdo namaz të pa falur, duhet të plotësohet nevoja një ditore e një të varfri për ushqim ose të dhurohet një sasi parash të barasvlershme me këto nevoja. Ky dhurim duhet t’i kalojë nevojtarit pa bërë asnjë ndryshim në sasi.

Në këtë mendim të Imam Muhammedit, gjenden tre dobi të rëndësishme:

- 1) Nxitja për dhurim dhe fitimi i sevapeve nga ana e atij që dhuron.
- 2) Gëzimi i nevojtarëve dhe lutja që i bëjnë ata të vdekurit.
- 3) Shpresa në faljen dhe mëshirën e Allahut të Madhëruar ndaj të vdekurit.

Për fat të keq, në ditët e sotme ka shumë njerëz që

8. **Turi i borxhit:** Ky është një veprim që konsiderohet si hile dhe ka për qëllim të paguajë borxhin e adhurimeve të të vdekurit kur pasuria që ka lënë ai me testament, ose një e treta e pasurisë së tij nuk mjafton për t’i paguar këto borxhe. Pasi konstatohet se pasuria nuk mjafton për të larë borxhet e adhurimit, trashëgimtarët e të vdekurit i japin një të varfri aq para sa gjenden aktualisht. Më pas -në bazë të marrëveshjes-, i varfri, pasi deklaron “*i pranova*”, ua fal ato para atyre që ia dhanë, të cilët bëjnë të njëjtin veprim në formë turi/qarkullimi, derisa të lahet komplet borxhi.

abuzojnë në zbatimin “iskat”-it, duke përdorur hilen e “turi/qarkullimit”, gjë e cila e nxjerr këtë zbatim nga qëllimi i tij kryesor dhe bie ndesh me shpirtin e Islamit. Me anë të kësaj metode, bëhet përpjekje për shpagimin e adhurimeve të pakryera, me dhurime që në fakt nuk janë bërë.

Me qëllim që dikush, i cili ka ndërruar jetë, të shpëtojë prej borxhit të namazeve që mund të mos i ketë falur, nxirret një sasi parash dhe në vend që këto t’i jepen një të varfri në mënyrë të sigurtë, -për fat të keq- shpesh herë ato kalojnë dorë më dorë midis disa personave të cilët deklarojnë shprehjet “*e pranova*” dhe “*e fala*”. Me këtë metodë, gjoja shtohet sasia e parave që dhurohen, edhe pse jo në mënyrë faktike por vetëm juridike. Mirëpo, ky zbatim është vetëm një bid’at i shëmtuar me të cilin mashtrohen vetëm ata që besojnë se një gjë e tillë e shton sasinë e parave dhe e lanë borxhin e të vdekurit.

Më e habitshmja është se këtë metodë e përdorin sidomos të pasurit, të cilët shpresojnë se do të arrijnë diçka me këtë veprim. Mbi të gjitha, kjo tregon një mungesë logjike, të cilën mund ta përdorin ata që e shikojnë Islamit në mënyrë negative dhe me syrin e kritikës. Po ashtu kjo mund të shihet edhe si një përpjekje për të mashtuar Allahut.

Një problem tjetër që shfaqet pas vdekjes së dikujt, është edhe kaplimi prej lakmive personale dhe armiqësisia midis të afërmve për shkak të trashëgimisë.

Besimtarët duhet ta ndajnë trashëgiminë në mënyrën që ka dëshiruar Allahu i Madhëruar dhe nuk duhet t’i lënë vend shkëputjes së lidhjeve farefisnore për këtë shkak.

Për fat të keq, në ditët tona, shumë njerëz që i kanë dobësuar lidhjet me besimin dhe Islamit, nuk tregojnë pëlqim ndaj gjykimit të Allahut në ndarjen e trashëgimisë, duke shkaktuar kështu zemërim dhe armiqësi midis të afërmve.

Mirëpo, për ata që nuk i binden urdhrave të Allahut në lidhje me këtë çështje, janë ligjëruar kërcënime të rënda. Ndërkohë që në Kuranin Fisnik shumë çështje

9. Një zbatim i tillë nuk ka ekzistuar as një kohë e Profetit (a.s.), as në kohën e tabiinëve dhe as në atë të tabi inëve. Në fakt, “*iskati*” është lejuar në fund të shekullit të II hixhri, ndërsa “*turi/qarkullimi*” është futur në përdorim në shekullin e V hixhri. Mirëpo, ky zbatim që është bërë traditë dhe pandehet se mbështetet në burimet Islame, bëhet shkak i koprracisë në dhurim dhe i përtacisë në adhurime. E në fakt, ky është një bid’at (risi) dhe nuk ka mbështetje në Islam. (Hayrettin Kahraman, Ebediyet Yolcusunu Ugurlarken, s. 81-85.)

*Për fat të keq,
në ditët tona, shumë
njerëz që i kanë dobësuar
lidhjet me besimin dhe Islamit,
nuk tregojnë pëlqim ndaj
gjykimit të Allahut në ndarjen
e trashëgimisë, duke shkaktuar
kështu zemërim dhe armiqësi
midis të afërmve.*



janë trajtuar në mënyrë të përgjithshme, çështja se si do të ndahet trashëgimia është shpjeguar me detaje dhe me shprehjet më të qarta¹⁰:

“Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut. Atë që i ibndet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshite, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Kjo është fitorja e madhe.” (Nisa, 13.)

“Ndërsa atë që nuk i ibndet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojnë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.” (Nisa, 14.)

Gjithashtu edhe në lidhje me çështjen e organizimit të ceremonive, mevludeve apo hatmeve të Kuranit për të shtatat, të dyzetat, etj., nuk ka asnjë të dhënë që mbështetet në Kuran apo sunnet.

Për një mysliman që ka ndërruar jetë duhet kërkuar falje, duhet bërë bimirësi në emër të tij dhe duhet lexuar Kuran vazhdimisht. Por nëse këto bëhen vetëm në ditë të caktuara, atëherë mund të harrohet i ndjeri në ditët e tjera. Nga ana tjetër, njerëzit që nuk i dinë këto gjëra, mund të pandehin se këto lloj ceremonish janë rregulla të Islamit.

Mendohet se zakoni i të shtatave, të dyzetave, etj., pas vdekjes, mund të jetë shfaqur nga frika e njerëzve se nëse i vdekuri nuk kujtohet të paktën në këto raste, ai mund të harrohet fare. Mirëpo, mundësia që një person të harrohet plotësisht po të mos ishin këto lloj ceremonish, në një farë mënyrë është një tregues i hidhur se ai person nuk ka lënë kujtime të vlefshme në zemrat e njerëzve. Aliu (r.a.) ka këshilluar:

“Qëndro me njerëzit e mirë e besnikë! Krijë miqësi me ta (me qëllim që karakteri dhe personaliteti i tyre të ndikojë tek ty)! Bëj një jetë aq të drejtë sa që sa të jesh gjallë njerëzit të të kërkojnë, e pas vdekjes tënde t’i marrë malli!..”

Njerëzit e mirë kanë bërë një jetë plot me shërbime në rrugë të Allahut, duke lënë pas breza të denjë, kujtime të bukura, vepra të dobishme dhe lutje mirësie. Edhe pse trupat e tyre gjenden tashmë në tokë, emrat e tyre vazhdojnë të jetojnë në zemra për shekuj të tërë.

9. DISA BESËTYTNI NË LIDHJE ME XHENAZEN

Tashmë dihet se në shumë vende janë shfaqur disa besëtytni në lidhje me xhenazën dhe vdekjen, të cilat

nuk kanë asnjë lidhje me Islamin. Disa prej këtyre besëtytnive, të cilat nuk duhet të merren kurrë për bazë janë:

- Në shtëpinë ku natën ulërin një qen (ose në oxhakun e së cilës këndon ndonjë kukuvajkë) do të vdesë dikush, ose prej asaj familjeje, ose prej ndonjë familjeje tjetër të afërt.

- Nëse në orët e vona të natës jepen enë, si tenxhere, tava, tepsi, etj., nga një shtëpi në tjetrën, ky veprim ndjell vdekjen.

- Nëse gërshërët mbeten të hapura, kjo nënkupton se ato do të presin qefin.

- Gjilpëra me të cilën qepet qefini duhet të thyhet, përndryshe ndjell fatkeqësi e vdekje.

- Nëse kazani i ujit me të cilin lahet i vdekuri nuk kthehet përmbys pas larjes së xhenazes, nënkupton se aty do të vdesë dikush tjetër.

- Nëse prej një shtëpie del një xhenaze, enët e ujit që ndodhen aty duhet të boshatisen. Nëse nuk boshatisen, për shkak se Azraili (a.s.) ka prekur ujin e tyre, atëherë aty do të vdesë dikush tjetër.

- Nëse një prej sendeve të shtëpisë bie apo thyhet vetvetiu, kjo tregon se në atë shtëpi do të vdesë dikush.

- Nëse këpuca kthehet përmbys ndërkohë që hiqet nga këmba, në atë shtëpi do të vdes dikush.

- Në shtëpinë nga ka dalë një xhenaze, nuk fiket drita deri në 40 ditë, me qëllim që kur shpirti i të vdekurit të kthehet, ta gjejë dhomën e tij të ndriçuar.

Lista e këtyre besëtytnive është shumë më e gjatë. Prandaj ne duhet t’i japim rëndësi të madhe edukimit fetar, njohurive dhe mësimi të dijeve Islame, me qëllim që të ruajmë edhe veten, edhe pasardhësit tanë.

10. GABIMET QË BËHEN GJATË VIZITAVE NË VARREZA

Lidhja e leckave pranë varreve apo tyrbeve, ngjitja e gurëve, hedhja e parave, spërkatja me kripë, prerja e kurbanit në oborrin apo pragun e varrezave e tyrbeve, ndezja e qirinjeve, lutja drejtuar të vdekurit në varr, etj., janë disa prej gabimeve që bëhen gjatë vizitave në varreza.

Lidhja e leckave në varreza është një ritual i trashëguar prej shamanizmit, sipas besimit të të cilit çdo mal, përrua, liqen e lumë, pemë e madhe dhe shkëmb, ka të zotin e vet. Këto qenie shpirtërore, që quhen “Izi”, kërkojnë kurbane prej njerëzve. Ata ato

“Qëndro me njerëzit e mirë e besnikë! Krijë miqësi me ta (me qëllim që karakteri dhe personaliteti i tyre të ndikojë tek ty)! Bëj një jetë aq të drejtë sa që sa të jesh gjallë njerëzit të të kërkojnë, e pas vdekjes tënde t’i marrë malli!..”



10. shih. Nisa, 11-12.

dëmtojnë këdo që nuk bën kurban për ta. Mirëpo këto genie shpirtërore janë aq modeste saqë mund t'i kënaqësh edhe me një copë leckë, një tufë qimesh kali e madje edhe me një copë guri që hidhet si kurban. Prej kësaj besëtytnie ka lindur edhe zakoni i lidhjes së leckave apo hedhja e diçkaje në varre. E për fat të keq gjurmët e këtyre besimeve të kota është e mundur t'i gjesh ende mes njerëzve të paditur.

Nëse nuk ruhemi me kujdes të madh prej këtyre besëtytnive që kanë lidhje me besimin, do t'i shkaktojnë njeriut disfatë në botën tjetër, sepse besimi monoteist nuk pranon as edhe idhujtarinë më të vogël.

Selman Farisiu (r.a.) transmeton se Profeti (a.s.) ka treguar një ndodhi shumë mësimdhënëse:

“Një person hyri në xhenet për një mizë.”

Të pranishmit thanë:

“Si është e mundur kjo, o i Dërguari i Allahut?!”

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Dy persona kaluan pranë një populli që adhuronte një idhull. Ata nuk lejonin të kalonte njeri, derisa të ofronte diçka për idhullin. Njërit prej tyre i thanë:

«Ofro diçka për këtë idhull!»

Ai u përgjigj:

«S'kam ç'të ofroj!»

I thanë:

«Jep qoftë edhe një mizë!»

Ai i ofroi një mizë (si kurban) dhe e lanë të kalonte. Person në fjalë hyri në zjarr.

Pastaj i thanë edhe tjetrit:

«Ofro edhe ti diçka!»

Ai iu përgjigj:

«Nuk ofroj asgjë (kurban) për dikë tjetër veç Allahut!» Ata e vranë këtë person e ai fitoi Xhenetin.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 203.)

Edhe ndezja e qirinjve nëpër varre është një zakon i mbetur prej adhuruesve të varreve.

Një gabim tjetër i rëndë është edhe rrotullimi rreth varrit të një njeriu që konsiderohet i mirë (i shenjtë), sikur bën tavaf rreth Qabesë.

Vepra të tjera që nuk përputhen aspak me besimin Islam janë edhe:

- Vizatimi i gjërave të dëshiruara në këtë botë, si shtëpi, makinë, fëmijë, etj., në dyert e tyrbeve.

- Marrja e një sasive dheu prej vendit të tyrbeve me qëllim shërimi, hedhja ose ngjitja e parave në to.

- Puthja e tyrbeve, fërkimi i tyre me dorë dhe hyrja në to duke u përkulur me shpresën dhe besimin se do të zgjidhet një hall ose do të plotësohet një dëshirë, janë

Njeriu është shumë i dobët. Gjithkush dhe gjithçka është nevojtar për Allahun e Madhëruar. Dhe dihet mirë se vetëm Allahu i dëgjon lutjet dhe i plotëson ato. Disa njerëz, kur shkojnë tek varret e njerëzve të

mirë ose edhe në mungesë të tyre, fillojnë e u luten me shprehje të tilla si: “O filan më shëro!” ose “O filan ma plotëso këtë dëshirë!”, etj., por këto veprime konsiderohen shirk ndaj Allahut të Madhëruar.

Këto shprehje që aludojnë se dikush tjetër përveç Allahut mund të eliminojë problemet dhe të menaxhojë gjithësinë e ngjarjet, nuk duhet të përdoren absolutisht në asnjë mënyrë. Është detyrë e çdo muslimani paralajmërimi ndaj veprimeve, vazhdimësia e të cilave të çon drejt shirkut, qoftë edhe për shkak të injorancës apo pakujdesisë. Mirëpo, edhe ata që e teprojnë duke konsideruar “shirk” edhe vizitat e varreve që bëhen në përputhje me etikën Islame, në emër të kundërshtimit të veprimeve të gabuara, nuk bëjnë gjë tjetër veçse të njëjtin gabim në aspektin e kundërt.

Ashtu si për çdo çështje, edhe në lidhje me vizitën e varreve, Islami parashikon ekuilibrin dhe rrugën e mesme. Fjalët dhe praktikat e Profetit tonë (a.s.) dhe shokëve të tij janë shembulli më i mirë për ne, që na tregojnë se si duhet të veprojmë lidhur me këtë çështje, pa shkuar në ekstreme. Padyshim se sahabët e nderuar e kanë ditur më mirë se ne çfarë është “shirk” e çfarë është “teuhid”. Kjo ndodhi është një përgjigje shumë kuptimplote ndaj atyre që e teprojnë duke konsideruar “shirk” vizitën e varreve:

Një ditë, kalifi Emeuit, Mervan ibn Hakemi, vuri re një person i cili kishte vënë kokën tek guri i varrit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ai mendoi se personi po bënte një veprim në kundërshtim me Islam, prandaj duke e kapur për jake i tha:

“Çfarë mendon se po bën?”

Mirëpo kur njeriu e ktheu kokën, Mervani pa se ishte Ebu Ejjub el-Ensariu (r.a.)! Ky sahab i dashuruar pas Profetit (a.s.) tha:

“Po, unë e di se ç'po bëj! Unë erdha te i Dërguari i Allahut, (a.s.), e jo te guri, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), të thotë:

«Kur punët e fesë t'i marrin përsipër njerëz kompetentë, mos u shqetëso! Por kur njerëz jokompetentë të fillojnë të përzihen në këtë punë, ke gjithë të drejtën të shqetësohesh e të qash.» (Ahmed Ibni Hanbel, V, 422; Hakim, IV, 560/8571.)

Nga kjo ngjarje kuptojmë se të konsideruarit shirk të vizitës së varreve që bëhet në përputhje me etikën Islame, është i pavend. Shirk bën personi që konsideron një të gjallë apo të vdekur, si të fuqishëm për të bërë dobi apo dëm si Allahu i Madhëruar.

Shkurtimisht, gjatë vizitave në varreza duhet të bëjmë kujdes të madh ndaj rregullave dhe etikës Islame. Po ashtu duhet të ruhemi e të mos i shërbejmë përhapjes së gabimeve që çënojnë Islam. Si besimtarë që jemi, ne duhet t'ia bëjmë të ditur familjes dhe rrethit tonë botëkuptimin e drejtë të Islamit në lidhje me çdo çështje dhe të bëjmë një jetë në përputhje të plotë me sunnetin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).



ESH-SHEKUR

MIRËNJOHËSI DHE SHPËRBLYESI PAMASË

— Ilir Hoxha —

Kuptimi i vërtetë i fjalës “shukr” është “të tregosh, të ekspozosh”. Ndërsa e kundërta e “shukr”-it është “kufër”, që do të thotë “të mbulosh”. Ai që shpërblen shumëfish edhe për pak interesim që tregohet ndaj tij, quhet “shekur”. Ndërsa ai që i konsideron gjithnjë të pamjaftueshme mirësitë dhe begatitë që i dhurohen, quhet “kefur”.

Kur emri “shekur” i atribuohet Allahut, do të thotë se, “Allahu e shpërblen shumëfish robin e Tij, qoftë edhe për pak vepra të mira”. (shih. Tegabun, 17.) Siç shprehet edhe Imam Gazaliu, për shkak se është Shekur, Allahu i Madhëruar e shumëfishon mirësinë për të cilën falënderohet dhe shpërblen pafundësisht me mirësi në botën tjetër për veprat e mira që bëhen në këtë botë. Për këtë arsye, kur të mirët të vendosen në Xhenet, e madhërojnë Allahun me dy emra: Me emrin “Gafur”, sepse u ka mbuluar gjynahet dhe me emrin “Shekur”, sepse i ka shpërblyer shumëfish për mirësitë e pakta që kanë pasur. (shih. Fatir, 34.)

Nga Kur’ani Fisnik kuptojmë se Allahu i Madhëruar, i Cili e cilëson Veten si Shekur, nuk i konsideron mirësitë dhe adhurimet që bëjnë robërit thjesht si “detyrë” për ta, por si një shkak për t’u bërë mirë atyre, duke i shpërblyer shumëfish ashtu siç i ka hije madhësisë së Tij. (shih. Fatir, 30.)

Emri hyjnor “Shekur”, i cili kalon katër herë në Kur’an, në tre prej tyre bashkëshoqërohet me emrin

“Gafur”. (shih. Fatir, 30, 34; Shura, 23.) Në ajetin 17 të sures Tegabun, ku emri Shekur vjen para emrit Halim, që shpreh “mos nxitimin e Allahut në dënimin e robërve”, mësojmë edhe njëherë që t’i japim një shans tjetër mirësisë.

Manifestimi më i madh i emrit Shekur, është të jesh një rob shumë falënderues e mirënjohës. Të arrish t’i shohësh mirësitë si mirësi dhe t’u përgjigjesh atyre me falënderim, është një mirësi më vete. Kjo gjendje është rruga e vetme e vërtetë e ndjenjës së kënaqësisë që kërkon shpirti njerëzor dhe jo të gjithë e kanë fat. Njeriu që ka këtë botëkuptim, hutohet dhe s’di si të falënderojë përballë mirësive të Allahut pavarësisht gjynaheve të shumta që ka. Ja pra, kjo pikë, shpreh vetëdijen ndaj paaftësisë për të falënderuar siç duhet, që është edhe grada më e lartë e falënderimit. Robi që arrin këtë shkallë, nuk mund të mposhtet nga asnjë skamje. Për shkak se falënderimi është një mirësi më vete, ai që e arrin këtë shkallë i ka bërë mirësi të madhe vetes së tij. (shih. Lukman, 12-14.)

Ashtu si Allahu, i Cili i shpërblen shumëfish robërit e Tij për pak mirësi që bëjnë, edhe njerëzit tek të cilët manifestohet morali i emrit Shekur, ndjejnë mirënjohje të madhe edhe përball mirësive më të vogla që u bëhen dhe u përgjigjen atyre duke ua kthyer shumëfish.

Në të njëjtën kohë, emri esh-Shekur, na mëson të


mos e përçmojmë asnjë mirësi, qoftë prej atyre që na bëhen ne, qoftë prej atyre që bëjmë ne. Në disa prej haditheve profetike, na bëhet e ditur se disa prej mirësive që duken të thjeshta, mund të bëhen shkak i shpëtimit prej dënimit dhe hyrjes në Xhenet, gjë e cila tregon se Allahu, i Cili është Shekur, nuk sheh sasinë e mirësive, por cilësinë e tyre. Dhe kjo na motivon edhe më tepër që të fokusohemi tek mirësitë pa thënë pak apo shumë.

Përkufizimi i mirësisë për njerëzit, ndryshon në bazë të asaj që ka rëndësi për ta. Shumë njerëz vënë kushte të atilla për të ndjerë mirënjohjen ndaj mirësisë, saqë pothuajse nuk u hyn në sy asnjë lloj mirësie. Prandaj, në lidhje me këtë çështje ne duhet të marrim për bazë kriteret që ka vendosur Zoti ynë i Madhëruar në Librin e Tij kur përmend ato që quhen mirësi. Edhe me një analizë të shkurtër, do të vëmë re se ato që konsiderohen mirësi tek Allahu, nuk janë vetëm ato që mund të quhen privilegj për një pjesë të vogël njerëzish, por edhe ato që mund

t'i zotërojnë të gjithë pa asnjë dallim, qoftë i pasur apo i varfër, i fortë apo i dobët, mashkull apo femër, i zi apo i bardhë. Për shembull, shiu, nata, dita, bimët, profetët e Zotit, etj.

E rëndësishme është të jesh i vetëdijshëm për mirësitë, qofshin materiale apo shpirtërore. Ata që e arrijnë këtë, e falënderojnë vazhdimisht Allahun duke kujtuar mirësitë që vijnë prej Tij. (shih. Duha, 11.) Prej tyre nuk dëgjon kurrë ankesa. Ata e dinë se falënderimi i një mirësie bëhet duke e ndarë atë me të tjerët. Dhe, kur e bëjnë këtë, ata nuk sillen sikur po bëjnë ndonjë mirësi, por sikur e kanë për detyrë. (shih. Insan, 8-9.)

O Zot! Mos na dëno me zemërngushtësi dhe me privimin prej syve që do të shohin, prej shpirtit që do ta ndjejë, prej gjuhës që do ta shqiptojë dhe prej zemrës që do ta ndajë çdo gjë që e mbush zemrën e njeriut me mirënjohje në këtë botë! O Shekur! Na ruaj prej pangopësisë që bren nga brenda njerëzit mosmirënjohës dhe egoistë!



Sahabi bujar

EBU'D-DAHDAH

- R A D I J A L L A H U A N H U -

— Mustafa Erish —

Ebu'd-Dahdahu (r.a.), ishte një sahab bujar që i dhuroi të Dërguarit të Allahut (a.s.), vreshtin e tij me gjashtëqind pemë hurmash!.. Ai ishte një sahab që mundahej dhe përpiquej për t'i mësuar çështjet islame!.. Njihej si ligjëruesi i ensarëve. Ai jetonte nën mbrojtjen e Amr ibn Aufit që i përkiste degës Beli të fisit Kudaa. Emri i plotë i tij ishte Thabit ibn ed-Dahdaha. Njihej me llogarin "Ebu'd-Dahdahu". (Istiab, IV, 1646-1647.)

Ebu'd-Dahdahu (r.a.), kishte një zemër të mbushur plot me dashurinë ndaj dijes. Ai përpiquej për t'i mësuar çështjet islame dhe nuk hezitonte për të pyetur. Le të shohim pyetjet që ia ka bërë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe përgjigjet që ka marrë nga ai në lidhje me dy çështje. Tregon Abdullah ibn Mes'udi (r.a.):

Kur zbriti ajeti fisnik në lidhje me "Karzi hasen /hua e bukur që i jepet Allahut": "**Kush do t'i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t'ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni.**" (Bakara, 245), Ebu'd-Dahdahu, radijall-llahu anhu, erdhi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e pyeti: "O i Dërguari i Allahut! A po na kërkon borxh Allahut?" Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: "Po, o Ebu'd-Dahdah. Allahu po kërkon borxh!"

Nisur nga kjo përgjigje, Ebu'd-Dahdah (r.a.), i kapi dorën të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Vreshtin me 600 pemë hurmash që kam po ia jap borxh Allahut!" Pastaj shkoi te vreshti i tij duke ecur në këmbë dhe u ndal te hyrja. Bashkëshortja dhe fëmijët e tij ishin aty. Ai i tha bashkëshortes:

"O Ummu'd-Dahdah! Dilni nga vreshti, sepse këtë vresht ia kam dhënë borxh Allahut..." Bashkëshortja ia ktheu: "O Ebu'd-Dahdah! Paske

bërë një tregti me shumë fitim! Allahu ta bekoftë tregtinë!" Ata menjëherë dolën nga vreshti dhe ia dorëzuan atë të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Pejgamberi ynë i nderuar u kënaq shumë nga ky veprim i Ebu'd-Dahdahut (r.a.) dhe e lavdëroi atë. Pastaj menjëherë i ka dha këtë përgëzim: "Në xhenet ka pemë hurmash të mëdha me degë plot fruta të përgatitura për Ebu'd-Dahdahun!" (Isabe, VII, 100-102; Muslim, Xhenaiz, 89; Ahmed, III, 146.)

Pyetja e dytë e Ebu'd-Dahdahut (r.a.), që ia ka bërë të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishte në



lidhje me familjen. Pra, ishte në lidhje me gjendjet e menstruacioneve të grave. Ai një ditë po qëndronte me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në Mesxhidu'n-Nebevi. Aty gjendej edhe një grup prej sahabëve. Çështja në lidhje me gjendjet e menstruacioneve të grave që ia kishte preokupuar mendjen po e shqetësonte ngaqë vazhdonte pa ndryshuar si në kohët e kaluara. Në periudhën e xhahilijetit njerëzit nuk i mbanin në shtëpi gratë me menstruacione dhe nuk hanin e pinin me ato siç vepronin edhe adhuresit e zjarrit dhe çifutët. Kjo gjendje vazhdoi e tillë edhe pas ardhjes së Islamit.

Ebu'd-Dahdahu (r.a.), deshi ta pyeste të Dërguarin e Allahut (a.s.), për këtë çështje që e shqetësonte dhe të mësonte në lidhje me të. Për këtë arsye, i tha: “O i Dërguari i Allahut! Si të sillemi kundrejt grave me menstruacione? A t’u afrohem i atyre (për marrëdhënie), apo jo?” Nisur nga kjo pyetje, u shpall ky ajet fisnik:

“Të pyesin ty (Muhamedi) për të përmuajshmet e femrave. Thuaju: “Ajo është gjendje e dëmshme.” Prandaj, gjatë kësaj kohe, mos iu afroheni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen...” (Bakara, 222)

Shpallja e këtij ajeti fisnik nga Allahu Teala, ia mbushi me prehje shpirtërore zemrën Ebu'd-Dahdahut (r.a.). (Tefsiri i Ruhu'l-Bejan, vëll. 2,

fq. 343; Përkthimi i Isabes, vëll. 1, fq. 287.)

Ebu'd-Dahdahu (r.a.), është i njohur edhe me ligjërimin dhe trimërinë e tij. Një kujtim në lidhje me thirrjen e tij që ua ka bërë sahabëve ditën e Uhudit, transmetohet si më poshtë:


Ditën e Uhudit u përhap lajmi se i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, kishte rënë dëshmor. Për këtë arsye, një pjesë prej sahabëve filluan të largoheshin. Ja, pikërisht në ato momente Ebu'd-Dahdahu (r.a.), u dha kurajë sahabëve të nderuar me fjalët e tij. Kështu që e parandaloi largimin e tyre. Ai u tha kështu atyre:

“O Ensarë! Nëse Muhamedi është vvarë, padyshim që Allahu është i gjallë, sepse Ai nuk vdes. Andaj, luftoni për fenë tonë dhe mbrojeni atë!”

Sapo sahabët e nderuar i dëgjuan këto fjalë, filluan të mblidheshin. Ata u bashkuan dhe e sulmuan armikun. Ebu'd-Dahdahut (r.a.), në ato momente para i doli Halid ibn Velidi. Pasi Ebu'd-Dahdahu (r.a.), mori një goditje prej tij, ra dëshmor. (Përkthimi i Isabe, vëll. 1, fq. 287; Vakidi, Megazi.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu na e mundësoftë që të përfitojmë nga guximi, trimëria, dashuria për dije dhe morali i lartë për të dhënë në rrugë të Zotit që kishte Ebu'd-Dahdahu! Amin!



EBU'D-DAHDAHU (R.A.), ISHTE NJË SAHAB
BUJAR QË I DHUROI TË DËRGUARIT TË
ALLAHUT (A.S.), VRESHTIN E TIJ ME
GJASHTËQIND PEMË HURMASH!.. AI ISHTE NJË
SAHAB QË MUNDOHEJ DHE PËRPIQEJ PËR T'I
MËSUAR ÇËSHTJET ISLAME!..

Një udhëtim me Sheherazaden

(PJESA E PESTË)

— Nuredin Nazarko —

Mënyra e të jetuarit është jeta vetë me të gjitha dimensionet e saj, ku vazhdimisht njeriu është përballë sfidës së të qenit njeri. Zgjedhja që bën secili është përgjegjësi personale. Secila qenie ka karakteristikat e veta, të cilat janë unike dhe të papërsëritshme. Prandaj dhe mënyra e të jetuarit për çdokënd është unike dhe e papërsëritshme. Ajo do të ngjyroset më ngjyrën e të gjitha gjendjeve që përjeton njeriu. Do të ketë formë dhe përmbajtje sipas përjetimeve që sjellin sfidat jetësore.

Secili ka sfidat e veta. Po ashtu ka dhe mënyrën e vet të të reaguarit ndaj këtyre sfidave. Përballë një vështirësie, përballë një vendimi që duhet marrë, secili ka mënyrën e vet të të arsytuarit dhe të të gjykuarit, sesi do ta trajtojë gjendjen ku ndodhet. Qëllimi final i vendimit që merret duhet të jetë drejtësia dhe mirësia, por askush nuk mund të detyrohet të mbërrijë në të njëjtin vendim sikundërse mund të ketë mbërritur dikush tjetër. Nëse njerëzit do të detyroheshin që për çdo sfidë, gjendje, vendim, të reagonin po njësoj, atëherë bukuria dhe shumëngjyrësia e jetës do të merrnin fund. Njëtrajtësimi i shoqërisë është qëllim i totalitarizmave dhe jo i vlerave morale mbi themelin e të cilave merren vendimet për gjendjet ku mund të ndodhet njeriu. Pasojat në totalitarizimin e mënyrës së jetesës janë fatale.

Nuk duhen imponuar qeniet njerëzore për t'u njëtrajtësuar si në formë ashtu dhe në përmbajtje. I duhet dhënë gjithësecilit hapësira ku mund të matë pulsën e fuqisë në marrjen e vendimeve për mënyrën e të jetuarit sipas drejtësisë. Pa këtë hapësirë do të ketë krijesa të deformuara, të cilat do të bëjnë zgjedhje jo mbi luftën e brendshme për të marrë një vendim të caktuar, por zgjedhje të cilat duhet të jenë në përputhje me orientimet e dikujt tjetër. Me fjalët që themi dhe me veprat që kryejmë duhet të nxitim frymëzimin drejt së mirës dhe jo të imponojmë formën tonë të mënyrës së të jetuarit edhe pse bazohet në themelin e drejtësisë. Ne duhet të jetojmë sipas mënyrës që kemi zgjedhur. Të tjerë do të jetojnë sipas mënyrës që kanë zgjedhur. Me rëndësi është të gjendet gjuha e mirëkuptimit dhe në përfundim secili bashkëndahet me frytet e zgjedhjes që ka bërë.

Hierarkia është prej natyrshmërisë. Çdo gjë që është ka hierarkinë e vet. Çdo gjë që ekziston ka hierarkinë e vet. Hierarkia duhet lidhur me vlerat morale dhe jo me imponimin e dhunshëm përmes instrumenteve shtypës e detyrues. Natyra njerëzore, dhe jo vetëm, e kërkon

hierarkinë, sepse nuk mund të ndërtohet një shoqëri ku të gjithë janë të barabartë mes të barabartëve. Të barabartë janë në nisje, në lirinë për të zgjedhur, por jo në karakteristikat të qenies. Ndryshimi mes njerëzve e kërkon medoemos prezencën e të parit. Dikush duhet të drejtojë, duhet të respektohet dhe t'i dëgjohej fjala nëse gjykon me drejtësi. Nëse veprohet kësisoj, natyrshmëria çon drejt paqësimit, pasi që jo të gjithë mund të drejtojnë në të njëjtën kohë. Më të diturit, më të vjetrit, më të mençurit duhen dëgjuar me vëmendje dhe me respekt. Mosbindja ndaj hierarkisë shkakton tollovi, ku nuk njihen rregullat, traditat, dhe duke mos u njohur as nuk zbatohen. Çdokush duhet të presë kohën e tij. Nëse është për të drejtuar të tjerët, drejtimi do t'i vijë. Nëse nuk është nuk ka për t'i ardhur, por do t'i vijë diçka tjetër që do të jetë më mirë për të.

Arti, muzika, poezia janë manifestim i gjendjeve e përjetimeve të njeriut. Dhimbja, vaji, gëzimi, hareja manifestohen përmes kompozimit, duke bërë që melodia e shpirtit të marrë formën dhe përmbajtjen e përjetimit. Kompozimet më të bukura ndoshta janë ato që vijnë si shprehje e mungesës dhe përmallimit për atë që mungon me prezencën e vet. Çfarëdo forme apo përmbajtje të kenë këto melodi, kompozimi tyre është frymëzim, që vjen vetëm në një çast dhe humbet për të mos u kthyer më me të njëjtin vrull e pasion. Nëse shohim një vepër arti, lexojmë një poezi apo dëgjojmë një melodi përmes instrumenteve të caktuara, janë të gjitha shfaqje të gjendjeve të shpirtit njerëzor, ku duket qartë që roli fizikes është pothuaj i pandjeshëm në frymëzimin e tilla veprave.

E gjithë jeta është vetëm një çast. Çasti është ai që i jep formë dhe përmbajtje jetës. Ashtu si orteku nis nga një masë e vogël bore, ashtu si zjarri i madh nis me një shkëndijë, edhe jeta nis me një çast. Ngjarja e një çasti të degdis në rrjedha ngjarjesh të tjera të cilat përplotësojnë dalëngadalë mozaikun e jetës. Dhe kur e sheh gati të përfunduar këtë mozaik kujtesa të nxjerr tek çasti i parë i vendosjes së gurit të parë. Çdo çast është pikënisje për një mozaik të ri. Dhe në fund bashkimi i të gjithë mozaikëve na jep pamjen e jetës. Shumëngjyrësi që ta ka ënda ta kundrosh me të gjitha shfaqjet dhe dimensionet. Për të patur këtë panoramë nevojitet durim, durim për të përballuar padurimin, pasi që njeriu nga veta natyra është i ngutur dhe kërkon medoemos të përshpejtojë atë që nuk mund të vijë përveç se në çastin që duhet të vijë.

Kultura E TELEVIZORIT

— Zahit Genç —

Disa objekte, mjete etj., janë ose të mira ose të këqija në varësi të përdorimit të tyre. Ndërsa disa të tjera, sido që të përdoren gjithmonë janë të dëmshme për njeriun, ngaqë në strukturat e tyre gjendet e keqja. Këtë mund ta themi edhe për vetë njeriun, edhe për ndonjë organ të tij. Siç mund të bëjmë punë të mira me duart, mund të bëjmë edhe punë të këqija me këto gjymtyrë. Aq sa është e mirë një dorë që ledhaton një fëmijë apo një jetim, aq e keqe është edhe një dorë që ngrihet për të goditur një njeri me të padrejtë.

Një mjet tjetër i shekullit tonë që është shumë influencues në edukim, që u drejtohet syve e veshëve, që është shumë i rëndësishëm dhe shumë i përhapur, është televizori që e dini të gjithë. Disa programe që u shfaqen njerëzve me anë të kanaleve televizive në ditët e sotme, është e pamundur të themi se janë të dobishme nëse i analizojmë nga aspekti i dijes, besimit, edukatës dhe moralit. Asnjë njeri me mendje të shëndoshë nuk i konsideron të dobishme këto programe. Mendimtari dhe shkrimtari i madh, Xhemil Meriçi thotë në lidhje me këtë temë: “Unë nuk e pranoj një fenomen që quhet kultura e televizorit. Televizori është një lloj afioni që është shpikur për njerëzit rrugaçë që e kanë humbur dinjitetin dhe që asnjëherë nuk e kanë fituar zakonet për të lexuar dhe menduar.”

Këtë po e them me shumë keqardhje: Në ditët e sotme me qindra mijëra gjimnazistë, dhjetëra mijëra studentë dhe të diplomuar, nuk kanë dijeni për këtë shkrimtar të madh. Ndoshta nuk kanë lexuar as edhe një rresht nga shkrimet e këtij shkrimtari.

Xhemil Meriçi thotë se libri ka qenë, është dhe

do të mbetet mbartësi i kulturës. Gjithashtu thotë: “Kultura e televizorit është një mashtrim që e kanë shpikur ata që kanë vendosur t’i ndërpresin lidhjet me kulturën. Televizori është një lodër djallëzore që e ka futur në vatrën tonë të gjithë imoralitetin e perëndimit.”

Pasi Xhemil Meriçi humbi sytë fizikë, iu hapën sytë e zemrës. Atij i ndodhën shumë ndryshime në botën e besimit dhe të mendimit. Ai mbron mendimin se televizori nuk do ta bëjë perëndimor njeriun tonë, por ka për ta zhytur duke u shprehur: “Ata që e pandehin të vjellin e kapitalizmit si një ushqim i shëndetshëm, janë të predispozuar për të vuajtur nga stomaku.”

Në ditët e sotme, veçanërisht në vendin tonë, koha e harxhuar që kalohet duke ndjekur televizor është shumë e madhe. Programet e televizorit patjetër duhet të përshtaten me vlerat e besimit, moralit dhe traditës sonë. Ato duhet të jenë cilësore dhe nuk duhet të na e çojnë dëm kohën.

Sot televizori është më shumë i dëmshëm se sa i dobishëm. Ne jemi të obliguar ta mbrojmë veten e pasardhësit tanë dhe të mos harrojmë se nesër do të japim llogari për çdo gjë.

Asnjëherë nuk mund ta harroj këtë fjalë që e ka thënë një dijetar i madh mysliman për sëmundjen e televizorit që i ndyn sytë e zemrat tona dhe që e shkatërron kohën e jetën tonë: “Dëmin që armiqët tanë nuk na e kanë bërë dot për një vit ndaj besimit dhe moralit tonë, na e ka bërë televizori.” Unë mendoj se ne duhet të mendojmë thellë rreth kësaj fjale.

KUJTTESA

është çlirim

— Edison Çeraj —

E dëgjojmë dhe e lexojmë shpesh se historia përsërit vetveten. Në fakt, në shumë raste përdoret kuturu, si për t'i dhënë një ton intelektual bisedës, siç ndodh me përdorimin banal të Don Kishotit. Pakkush e vret mendjen për ta kuptuar siç duhet. Ka një marrëveshje absurde për kuptimin e kësaj thënieje pa ia diskutuar asnjëherë atë.

Thënia “historia përsërit vetveten”, ose thjesht “historia përsëritet” është e lidhur pazgjidhshmërisht me fenomenin ose çështjen e harresës, sepse thënia e plotë, me autor George Santayana, e shpreh qartë këtë lidhje: “Ata që nuk e kujtojnë të shkuarën janë të dënuar ta përsërisin atë.” Pra, diçka që ka ndodhur në të shkuarën ndodh për së dyti në të tashmen ngaqë ne priremi kah harresa. Në këtë

rast është njësoj si të thuash “e keqja përsëritet”, pasi bëhet fjalë për anën e errët të së shkuarës, për atë anë që duhet të bëhet mësim për ne që të mos përsëritet, sipas parimit njeriu i zgjuar nuk bie dy herë në të njëjtën grackë.

Një rast me peshë përcaktuese kur historia përsëritet është edhe ideja e përhapur gjithandej – kryesisht në formë të pavetëdijshme – se Zoti është tërhequr nga bota apo krijimi në tërësi, duke e lënë atë në mëshirë të fatit, ose në dorë të njeriut, ose në një zhvillim/ecuri të vetvetishme. Një prej studiuesve më të rëndësishëm të feve, Mircea Eliade, në librin “E shenjtja dhe profania”, argumenton se një ide apo një besim i tillë është i lashtë:

HAPI I PARË
DREJT LIRISË SË
BRENDSHME ËSHTË
ÇLIRIMI NGA
IDHUJT.

“I tërhequr në qiell, Ndyambi, zoti i epërm i hererove, e ka braktisur njerëzimin në duart e perëndive më të vogla. «Përse u dashka t’i blatojmë flije?», shpjegon një fashatar i fisit. «Ne s’kemi pse i druhemi atij, meqë, ndryshe nga shpirtrat e të vdekurve tanë, ai s’na bën asnjë të keqe.» Qenia e Epërme e tumbukëve është tepër e madhërishme «për t’u marrë me punët e rëndomta të njerëzve». I tillë është edhe Njankuponi i zezakëve të Afrikës Perëndimore që flasin gjuhën tshi; ai nuk ka kult dhe nderohet vetëm në rrethana të pazakonta, pra në raste zie buke, epidemish apo pas ndonjë stuhie të dhunshme; në kësi rastesh njerëzit e pyesin se në ç’mënyrë e kanë fyer. Dzingbe (Ati i Përbotshëm), qenia e epërme e eueve, grishet vetëm kur pllakos thatësia. «O ti qiell, që të falemi, e madhe është thatësia; le të reshë pra shi, le të freskohet toka, le të lulëzojnë fushat!» Largësia dhe pasiviteti i Qenies së Epërme shprehet në mënyrë të shkëlqyer në një thënie të giriamëve të Afrikës Lindore, që e përshkruajnë zotin e tyre si më poshtë: «Mulugu (Perëndia) është lart, hijet poshtë!» Bantutë thonë: «Me ta krijuar njeriun, Perëndia nuk kujdeset më për të.» Negritot përsëdytin: «Perëndia është larguar prej nesh!» Popujt fang të kullotave të Afrikës ekuatoriale e përmbledhin filozofinë e tyre fetare në një këngë:

Zoti (Nzameja) është lart, njeriu poshtë.

Zoti është Zot, njeriu njeri.

Secili në vend të vet, secili në shtëpi të tij.

Nuk ka nevojë të japim shembuj të tjerë. Kudo në këto fe primitive, qenia e epërme qiellore duket se ka humbur rëndësinë fetare; nuk ka vend në kult për të. Kurse mitet e paraqesin duke u tërhequr gjithnjë e më larg njeriut, derisa shndërrohet në një *deus otiosus*. Megjithëkëtë, ai kujtohet dhe grishet si streha e mbrame, pra *vetëm pasi kanë dështuar të gjithë perënditë dhe perëndeshat, paraardhësit dhe demonët*. Sikundër shprehen oraonët: «I kemi provuar të gjitha, por të kemi ende ty, që të na ndihësh.» Dhe ata flijojnë një këndes të bardhë, duke thirrur: «Zot, ti je Krijuesi ynë, kij mëshirë për ne!»¹

Edhe thënia e Nietzsche-s, “Zoti vdiq”, tingëllon familjare në këtë kontekst. Si të thuash, meqë Zoti na paska lënë në mëshirë të fatit, atëherë Ai është i pamundur si i tillë, ose nuk do t’ia di për ne.

Pikërisht Nietzsche dhe më pas Heidegger-i na e kanë ndriçuar ndoshta më shumë se kushdo tjetër

këtë terrnajë qenësore. Të gjitha shenjat tregojnë se problemi është te ne që kemi harruar dhe vazhdojmë të harrojmë, dhe kur e harron një gjë, është njësoj sikur ajo gjë nuk ekziston. Ja pse Nietzsche shpalli “vdekjen” e Zotit, domethënë: duke qenë se ne e kemi harruar (“vrrarë”), atëherë është njësoj si të ketë vdekur, pasi Ai nuk zë më asnjë vend në jetën tonë; nuk kemi lënë asnjë shenjë të Tij në hapësirat tona private dhe sidomos publike e kështu me radhë. Ne e kemi vrrarë e Atë me harresë.

Diku në veprën e tij mbi Nietzsche-n, Heidegger-i shkruan se Nietzsche-ja flet për Zotin sipas Krishterimit, pra për Zotin që na ka paraqitur kjo fe, dhe jo për Zotin si të tillë, pavarësisht se e trajton në një mënyrë jo të krishterë.

Teomorfizmi është paradhoma e ateizmit ose e harresës (një trajtë e së cilës është edhe agnosticizmi). Pra, kur njeriut apo një qenieje tjetër i japim cilësi të Zotit/Hyjnisë, rrjedhoja përfundimtare është se Zoti është pamundësi, domethënë i pamundur si i tillë, ose absurd i kulluar, ndoshta thelbi i absurdit. Këtu qëndron origjina e çorientimit dhe e ligështimit të qenies në periudhën e ashtuquajtur moderne, sepse ka mbetur pa qendër. Së këndejmi, edhe koha dhe hapësira janë tëhuajësuar, sepse kanë humbur shenjtërinë orientuese në vetëdijen e qenies. Ato nuk janë më shenja/mrekulli që na orientojnë në këtë udhëtim, që i përkasin dhe i flasin çdo individ, por fenomene që i përkasin fizikës moderne, diku larg nesh. Ka një analfabetizëm në nivel ontologjik të njeriut të kësaj kohe në marrëdhënie me natyrën. Tashmë natyra është një libër i mbyllur që mund t’i qasen vetëm shkencëtarët. Natyrisht që e njëjta gjë vlen edhe për kohën dhe hapësirën.

Pse të mendojmë për pak çaste se jemi ne ata që jemi tërhequr nga vetja, nga zëri i brendshëm, duke u dhënë pas mijëra zërash që na rrethojnë, e për rrjedhojë jemi përballur me një shkretëtim të pakapërcyeshme kontradiktash që na ka bërë të dorëzohemi. E megjithatë zëri brenda nesh është ende aty, veçse ai nuk flet me fjalë, dhe si i tillë nuk mund të dëgjohet me veshë – ai dëgjohet vetëm me qenie. Për ta thjeshtuar: ai dëgjohet vetëm me zemër, por, fillimisht duhet të çlirohemi nga ideja se zemra është vetëm një organ që pompon gjak.

Zemra pompon edhe lirinë, për të cilën gënjehemi se do të na e sigurojë ky apo ai autoritet. Cilido qoftë dhe sido qoftë autoriteti, ai nuk bën gjë tjetër veçse e kufizon lirinë, ose e asgjëson tërësisht atë.

Hapi i parë drejt lirisë së brendshme është çlirimi nga idhujt.

1. Eliade, M. (2019) “E shenja dhe profania”, f. 92-3, përkth.: Azem Qazimi dhe Denata Qazimi. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.

Krenohu ME ISLAMIN

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“O ju që keni besuar. Kini frikë Zotin ashtu siç i ka hije madhësisë së Tij dhe mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë”**. (Ali Imran: 102).

Ne të gjithë tashmë e dimë, se Islami është feja që përhapet me shpejtësinë më të madhe në botë dhe numri i myslimanëve rritet dita-ditës. Por ne e dimë gjithashtu, se ndaj kësaj feje dhe pasuesve të saj ka presion shumë të madh. Ushtrohet presion brenda trojeve dhe botës islame, ku ata persona që kapen pas fesë dhe bëhen praktikantë, etiketohen si ekstremistë e radikalë. Por ka presion edhe në vendet e Perëndimit, ku ka myslimanë. Njerëzit i etiketojnë këta myslimanë, gratë dhe fëmijët e tyre si njerëz të huaj dhe jo pjesë e atyre vendeve. Edhe në trojet tona ushtrohet presion mbi myslimanët, duke na quajtur si “njerëz që ecin kundër rrymës”.

Sot jetojmë në atë kohë, kur dikush ka frikë, se nëse e marrin vesh se është mysliman, mund ta nxjerrin nga puna, prandaj mundohet ta mbajë të fshehtë besimin e tij. Sot është koha kur dikush ka ndrojtje, nëse dikush e merr vesh se gruaja e tij mban hixhab (shamia e kokës për myslimanet), apo se fëmijët e tij falen në xhami. Sot është koha, kur njerëzit e japin selamin nëpër dhëmbë, nga frika se mos e dëgjojnë njerëzit përreth tij.

Unë i bëj thirrje vetes time, juve dhe të gjithë atyre që i lexojnë këto rreshta: “Mos kini turp, mos kini frikë. Jini krenarë se jeni myslimanë, se Islami vetëm ua shton krenarinë ndjekësve të tij dhe asnjëherë nuk i poshtëron ata. Jini krenarë por jo mendjemëdhenj, se mendjemadhësia nuk është krenari. Jini

krenarë që jeni myslimanë, sepse jeni pasues të asaj feje, që Zoti e ka zgjedhur dhe që e do”.

Kur profeti (a.s.) bëri haxhin dhe ditën e Arafatit ishte përpara qindra mijëra haxhinjve, Zoti i zbriti ajetin kuranor: **“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha për ju Islamin fe”**. (Maide: 3). Disa kohë pasi profeti (a.s.) kishte ndërruar jetë, një hebre takoi Umerin (r.a.) dhe i tha: “O Umer. Ju kemi zili ju myslimanëve, se keni një ajet në librin tuaj. Po të na kishte zbritur ne ai ajet, do ta kishim bërë festë atë ditë”. Umeri e pyeti: “Për cilin ajet e ke fjalën”. Çifuti i citoi ajetin që përmendëm më lart. Atëherë Umeri (r.a.) ia ktheu: “Ne nuk kemi një, por dy ditë feste, se ky ajet ka zbritur ditën e xhuma dhe ne ditën e xhuma e kemi festë për çdo javë. Gjithashtu ky ajet ka zbritur ditën e Arafatit dhe ajo është festë për ne, sepse ajo është dita më e madhe e vitit”. Prandaj i lutemi Zotit ta pranojë Islamin tonë, të jemi të kënaqur për këtë Islam dhe Zoti të jetë i kënaqur me ne.

Vëllezër dhe motra! Jini krenarë që jeni pjesë e kësaj feje, sepse po ndiqni fenë e profetëve të Zotit. Le të thotë dynjaja, se Islami është feja e turqve apo e arabëve. Për Zotin nuk është as e turqve e as e arabëve, por është feja e profetëve të Zotit. Dëgjojini dëshmitë e tyre dhe do të çuditëni kur të merrni vesh, se ata të gjithë kanë thënë të njëjtën fjalë: **“Unë jam mysliman”**.

Këtë e tha Nuhu (a.s.): **“Zoti më ka urdhëruar, të jem prej myslimanëve”**. (Junus: 72). Këtë fjalë e ka thënë Ibrahim (a.s.). Kur Jakubit (a.s.) po i vinte

vdekja, ai i mbledhi fëmijët e tij dhe u tha: **“Mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë”**. (Bekare: 133). Këtë dëshmi e tha Musai (a.s.), kur iu drejtua Beni israilëve me fjalët: **“...mbështetuni Zotit, nëse me të vërtetë jeni myslimanë”**. (Junus: 84). Këtë fjalë e tha Isai (a.s.). Kur ai e ndjeu se njerëzit e rrethuan dhe nuk e besonin, u tha shokëve të tij: **“Kush del dhe më ndihmon në rrugë të Zotit. Ata i thanë: ”Ne të ndihmojmë në rrugën e Zotit, por ti dëshmo, se ne jemi myslimanë”**. (Ali Imran: 52).

Islami është feja e të gjithë profetëve të Zotit. Nëse dikush të thotë, se ky vend përpara se të jetë mysliman, nuk ka qenë i tillë, thuaji atij se këta njerëz përpara se të kenë qenë të krishterë apo jomyslimanë, kanë qenë myslimanë, se Islam do të thotë ta besosh Zotin me një besim të pastër dhe t'i dorëzohesh totalisht Zotit. Sa për dijeni të gjithë profetët e Zotit kanë qenë besimtarë të një Zoti dhe kanë qenë dorëzuar plotësisht tek Ai. Prandaj të gjitha fetë e tyre mund të quhen Islam dhe të gjithë ata quhen myslimanë.

Jini krenar për këtë fe, e cila e pranon tekstin, por nuk e mohon mendjen. Kjo fe e respekton shpirtin, por nuk e neglizhon trupin. Jini krenar për këtë fe, e cila gjithmonë të kujton ahiretin, por të fton t'i mbash këmbët në dynja dhe të mos e harrosh as atë. Jini krenar për këtë fe, e cila na mëson t'i lutemi Zotit: “O Zot na jep të mira në këtë botë, të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit”. Pra e fillojmë lutjen me të mirat e dynjasë, por nuk i harrojmë as të mirat e ahiretit. Kjo është feja jonë, ky është Islami ynë. Ajo është feja e mendjes, e trupit, e shpirtit, feja e dynjasë dhe ahiretit. Beto hem në Zot, se ai që ndjek këtë fe, nuk do të humbasë asgjë nga kjo dynja. Çdokush që ndjek këtë fe, do t'i marrë të gjitha të mirat e dynjasë, por përveç saj do të marrë edhe të mirat e ahiretit.

Ju bëj thirrje edhe njëherë të jeni krenarë që jeni pjesë e kësaj feje dhe që quheni myslimanë, se kjo është feja që ia ruan njeriut mendjen, nderin, i ruan familjen dhe atdheun. Kjo fe e ka ndaluar alkoolin dhe drogën, përpara se bota të shkatërrohet prej tyre. Sot shohim se shkaktari kryesor i ç'rregullimeve në botë janë pijet alkoolike dhe lëndët narkotike. Këto po shkatërrojnë shumë njerëz, madje ka edhe njerëz të mirë, që po shkatërrohen prej tyre. Ndërsa për një mysliman nuk është e nevojshme të investohen

miliarda, që të ndalet droga e alkooli, sepse ai nuk i konsumon pijet alkoolike, pasi kjo është e ndaluar në fenë tonë. Ky mysliman i ka besuar Zotit, para se t'i besojë ligjit, madje një mysliman e ka siklet, kur dikush ia nxjerr alkoolin dhe drogën përpara syve. Sikur njerëzit ta ndiqnin këtë fe, këto miliarda do të shpenzoheshin aty ku do të ishte më e dobishme dhe jeta e njerëzve do të përmirësohej.

Islami është ajo fe, që ndaloi imoralitetin dhe tradhtinë bashkëshortore, përpara se të shkatërrohet familja. Sot po shkatërrohen familjet e njerëzve dhe Zoti na ruajt prej këtij shkatërrimi. Po shkatërrohen familjet e atyre, që dikur kanë pasur nder dhe kurrrë nuk e kanë menduar, se familja e tyre mund të shkatërrohet nga imoraliteti. Por fatkeqësisht sot ka politikanë dhe njerëz me pozitë shumë të lartë, të cilët shkatërrojnë familjet dhe karrierat e tyre, sepse nuk kanë frikë Zotin tek nderi i tyre. Të jeni të sigurt, se ata nuk e bëjnë këtë gjë nga injoranca, por vetëm për faktin se zemrat e tyre janë të bo-shatisura nga besimi dhe turpi. Prandaj profeti (a.s.) thoshte: **“Kur nuk ke turp, bëj çfarë të duash”**.¹ Njerëzit që bëjnë tradhti bashkëshortore, ruhen gjatë gjithë kohës, nga frika se mos i shohin kamerat. Ndërsa një mysliman përpara se të ketë frikë se mos e shohin kamerat apo gruaja e tij, ka frikë Zotin e gjithësisë, i Cili është me të në çdo vend. Ai njeri që kapet pas kësaj feje, për Zotin hidhe ku të duash, se me lejen e Zotit do të jetë i sigurt dhe i ndershëm, pasi ai ka frikë Zotin dhe Allahu do ta ruajë këtë njeri.

Islami është ajo fe, e cila e vlerësoi familjen si pasurinë më të madhe. Prandaj një mysliman nuk toleron tek familja e tij, pasi profeti (a.s.) tha: **“Unë jam më i miri se të gjithë për familjen time, prandaj edhe ju duhet të jeni të mirë për familjet tuaja”**.² Prandaj sot njeriu që ka familje, le ta dijë se ka një pasuri që nuk matet me miliarda, ndërsa njeriu që nuk ka familjen, ta dijë se është fukarai më i madh.

Kjo fe e vlerësoi nderin e njeriut si vlerën më të shenjtë. Nëse njeriu ka nder, është gjithmonë me ballin lart, por nëse humb nderin, nuk i vlen edhe nëse ka gjithë dynjanë në dorë, sepse ai ka turp të dalë përpara njerëzve, madje ka turp dhe nga vetja e tij.

**“KUSH DEL DHE MË
NDIHMOM NË RRUGË
TË ZOTIT. ATA I THANË:
”NE TË NDIHMOM NË
RRUGËN E ZOTIT, POR TI
DËSHMO, SE NE
JEMI MYSLIMANË”**.

1. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (6120).

2. **Hadith i vërtetë**. Tirmidhiu (3895) dhe Ebu Daudi (4899). Shejh Albani dhe Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

Kjo fe i vlerësoi fëmijët si dhuratë dhe si amanet prej Zotit. Prandaj një mysliman e vlerëson fëmijën. Fëmija nuk është prona jote e as pasuria jote. Ai është dhuratë prej Zotit të gjithësisë dhe është amanet, për të cilin do të pyetesh përpara Zotit.

Kjo fe i jep status çdo lloj njeriu, sado i varfër qoftë ai. Për Zotin ka disa njerëz, që askush nuk i njeh, por kur këta hyjnë në këtë fe, ndihen se janë prezent, janë të gjallë, janë dikushi. Një prej këtyre njerëzve ishte Bilali (r.a.). Ai ishte skllav dhe askush nuk e llogariste atë për njeri. Ai luftonte për një kafshatë bukë. Por ditën që u bë mysliman, ai sakrifikoi çdo gjë që kishte, se e pa që kjo ka vlerë të madhe tek Zoti, edhe pse ndoshta nuk ka vlerë tek njerëzit.

Një xhaminë e profetit (a.s.) ishte një grua me ngjyrë, e cila pastronte xhaminë. Ajo quhej Umu Mihxhen. Pjesa më e madhe e njerëzve nuk e njihnin atë. Kur vdiq ajo, profeti (a.s.) nuk u njoftua. Mirëpo vetë profeti (a.s.) kur nuk e pa më, pyeti: “**Ku është ajo grua që pastronte xhaminë**”? I thanë: “Ka ndërruar jetë para disa ditësh o profet i Zotit”. Profeti (a.s.) tha: “**A nuk ju vjen zor që s’më keni treguar**”. Njerëzit i thanë: “Me siguri ti ke qenë i zënë me punë më të mëdha (duke nënkuptuar se ky njeri nuk mund të kishte aq rëndësi, sa të njoftohej profeti a.s.)”. Profeti (a.s.) tha: “**Më tregoni ku është varri i saj, se dua të shkoj dhe t’ia fal xhenazen tek varri**”. Pasi i fali xhenazen, të gjithë sahabët kishin dëshirë të kishin qenë në vend të asaj gruaje e vetë profeti (a.s.) t’ua falte xhenazen.³ Profeti (a.s.) e dinte, se para Zotit nuk ka njerëz të thjeshtë e njerëz të mëdhenj, por vetëm njerëz të devotshëm dhe njerëz të tjerë. Kush i përket kësaj feje dhe është i sinqertë, është i madh tek Zoti i gjithësisë.

Xhulejbibi (r.a.) ka qenë njeri shumë i thjeshtë. Ai nuk kishte as para, as rrobë e as shtëpi. Njëherë ai shkoi tek profeti (a.s.), i cili i buzëqeshi, sepse ishte mjeku i zemrave. Pastaj profeti (a.s.) i tha: “**O Xhulejbib! A ke dëshirë të martohesh**”? Ai qeshi dhe i tha: “O profet i Zotit, a po tallesh me mua? E kush ma jep mua vajzën për nuse?! Unë nuk kam as dërrhem, as shtëpi e as rroba. Si mund të martohem unë, duke qenë në këtë gjendje”? Atëherë profeti (a.s.) ia ktheu: “**O Xhulejbib! Shko tek filan shtëpi, trokit në derë dhe thuaju atyre: “Profeti (a.s.) më ka sjellë këtu, që të më jepni nuse**”. Xhulejbibi e ndoqi këshillën e profetit (a.s.) dhe shkoi e trokiti në derën e një prej fisnikëve të myslimanëve. Pasi

3. **Hadith i dobët.** Ebu Shejhu sipas Ibn Rexhebit në A’hualul kubur (190) dhe Sujutiun në Sherrhus-sudur (140). Ndërsa baza e hadithit është e vërtetë. Shiko Buhariun (458) dhe Muslimin (956).

iu hap dera, Xhulejbibi tha: “Unë jam Xhulejbibi! Më ka dërguar profeti (a.s.), që të më jepni vajzën tuaj për nuse”. Burri që i hapi derën, u fut brenda dhe i tha bashkëshortes së tij: “Xhulejbibi kërkon dorën e vajzës sonë”. Ajo tha: “Ah sikur të ishte dikush tjetër veç tij, sepse ai nuk ka asgjë”. Por vajza e tyre e dëgjoi këtë fjalë dhe u tha prindërve të saj: “A po e ktheni mbrapsht kërkesën e profetit (a.s.)? Përgjigjuni atij”. Ajo nuk e njihte Xhulejbibin. Edhe ajo do të kishte dashur ta kishte burrin pasanik, me famë e me status, por kur dëgjoi se ai ka ardhur me fjalën e profetit (a.s.), pranoi të martohet me të. Thonë që bënë një jetë shumë fisnike e të thjeshtë. Xhulejbibi ra dëshmor në një nga betejat e myslimanëve. Profeti (a.s.) i pyeti shokët e tij: “**Kush ka vdekur**”. Ata i thanë disa emra, por profeti ua ktheu: “**A nuk e shikoni se mungojnë edhe disa të tjerë**”. Ata i thanë se nuk mbanin mend njeri tjetër. Atëherë profeti (a.s.) tha: “**Unë nuk po shikoj Xhulejbibin. Ejani ta kërkojmë atë, se me siguri ka rënë dëshmor**”. Pastaj profeti (a.s.) e kërkoi Xhulejbibin dhe e gjeti të rrethuar nga 7 armiq. Ai i kishte varur të gjithë ata, pastaj kishte ndërruar jetë nga plagët e marra. Profeti (a.s.) u ul, e puthi në ballë, e mori në krah me duart e tij dhe tha: “**O Xhulejbib! Ti je pjesë e trupit tim e unë jam pjesë e jotja**”. Pastaj e futi në varr me duart e tij dhe atë ditë të gjithë sahabët thanë: “Ah sikur të kishim qenë ne në vend të Xhulejbibit”.⁴ Ky ishte Xhulejbibi, njeri shumë i thjeshtë, ndoshta pa famë e karrierë, por ai kishte vlerë të madhe tek Zoti dhe tek profeti (a.s.).

Umeri (r.a.) ka qenë nga ata njerëz që ka jetuar në xhahilje (në periudhën paraislame), ka jetuar edhe në Islam. Ai ka thënë një fjalë të madhe: “O njerëz! Ne ishim të humbur e të poshtëruar, por Zoti na bëri krenarë me këtë Islam. Sa herë që do ta kërkoni krenarinë jashtë Islamit, dijeni se do t’ju poshtërojë Zoti”. Në realitet ashtu ka ndodhur. Kur myslimanët kanë qenë krenarë me këtë fe, Zoti ju ka dhënë status e famë. Por kur ata e kanë kërkuar krenarinë jashtë kësaj feje, Zoti i ka poshtëruar, ashtu siç po i shohim myslimanët edhe sot e kësaj dite.

Kam një thirrje për të gjithë myslimanët në këtë vend: “O myslimanë! Mos rrini në këtë fe nga zori, se Zoti nuk ka nevojë për këtë. Mos rrini në këtë fe nga turpi, se tek Zoti nuk ka vend për turp. Lexoni për këtë fe dhe mësojeni atë. Po ju pëlqeu, ndiqeni dhe po s’ju pëlqeu, atëherë ju them pa hezitim IKNI, se Zoti nuk ka nevojë për dikë që rri në fenë islame për hipokrizi, për interes apo nga frika. Jini krenar

4. **Hadith i vërtetë.** Ahmedi (4/422). Shejh Shuajbi e vlerëson h - dithin të vërtetë.

me këtë fe, se për Zotin, nëse do të jemi krenarë me Islamin, Zoti do të na japë krenari dhe do të jemi faqebardhë në këtë botë dhe në botën tjetër”.

Një apel tjetër e kam për të gjithë ata të ashtuquajtur politikanë e analistë, të cilët përpiqen përditë që ta fshijnë Islamin dhe myslimanët nga harta e shqiptarëve, që t'i bëjnë këta njerëz të mendojnë se kanë qenë dikur, por sot janë ndryshe. Le ta dinë këta politikanë e analistë, se po bëhen si struci, i cili fut kokën në rërë, duke harruar se trupin e ka jashtë. Ne e dimë dhe gjithë bota e di, se shqiptarët kanë tre fe. Ka katolikë, ortodoksë dhe myslimanë, por këta të fundit janë më të shumtë, pra shumica e këtij populli janë myslimanë. Kush mohon Islamin, ai mohon shqiptarinë, prandaj askush nuk e fsheh dot realitetin. Nëse keni ndërmend ta fshini këtë fe nga faqja e dheut, atëherë unë po ju them, se jeni si ata që mundohen të fikin dritën e diellit me frymën e tyre, por do të lodheni kot, sepse drita e diellit nuk do të fiket asnjëherë. Kjo është feja e Zotit, është drita e Zotit. Sa herë që dikush mundohet ta fikë dritën e Zotit, Ai do ta bëjë këtë fe të triumfojë dhe ka garantuar për këtë.

Komandanti i ushtrisë perse, e cila ishte super-fuqi e asaj kohe, quhej Rustum dhe kishte nën komandën e tij 280 mijë ushtarë, të cilët i bindeshin fjalës së tij. Në një komunikim me komandantin e ushtrisë myslimane Sad Ibn Ebi Uekkas (r.a.), Rustum i kërkoi që t'i sillnin një ushtar të thjeshtë, që të dialogonte me të. Sadi zgjodhi një njeri shumë të thjeshtë, që ndoshta nuk njihej nga njerëzit deri në atë kohë. Emri i tij ishte Rib`ij Ibn Amir. Po ta shihje në pamje të jashtme, nuk të bënte përshtypje. Nga rrobat e tij e kuptoje, se ai nuk ishte njeri me status të lartë shoqëror. Sadi (r.a.) ia tha Rib`ij Ibn Amir-it: “Do të shkosh të flasësh me Rustumin, prandaj mos filozof, por thuaj atë që të thotë zemra”. Kur Rustum mori vesh, se po vjen i dërguari i ushtrisë myslimane, dha urdhër që të gjithë gjeneralët të vishnin rrobat e tyre ushtarake dhe të mbanin qëndrim gatitu. Agjë nuk pipëtinte. Ai deshi t'i tregonte këtij beduini arab, se kush ishin persët dhe në të njëjtën kohë deshi t'i tregonte atij, se epërsia e persëve ndaj myslimanëve ishte shumë e madhe. Kur Rib`ij Ibn Amir hyri tek Rustumi, ai po tërhiqte kalin për freri, ndërsa në dorën tjetër mbante heshtën. Ai eci serbes – serbes mbi qilimat e Rustumit, duke i shpuar ata me heshtën e tij. Me këtë veprim ai deshi t'i thoshte komandantit suprem pers: “Mua nuk më bëjnë përshtypje këto gjëra”. Pasi doli para Rustumit, ky i fundit i tha: “O njeri! Persët kanë civilizim, romakët kanë civilizim, indianët kanë civilizim! Po ju që keni ruajtur vetëm deve, dele e dhi, ju që gjithmonë keni vuajtur për

kafshatën e bukës, si guxoni të vini e të luftoni kundër nesh”. Rib`ij ia ktheu: “Ke të drejtë në këto që thua, madje ka më shumë se kaq. Ne jemi nga ata që vrisnim shoku – shokun, vetëm se deveja ime pinte ujë më shumë se deveja e tjetrit. Ne jemi ata, që ziheshim dhe vriteshim për gjëra qesharake. Por mësoje këtë gjë: Ne jemi nga ata njerëz, që Zoti na ka dërguar për t'i nxjerrë njerëzit nga adhurimi i njeriut, tek adhurimi i Allahut (xh.sh), Zotit të njeriut. Jemi dërguar për t'i nxjerrë njerëzit nga padrejtësitë e feve, në drejtësinë e Islamit. Ne jemi dërguar për t'i nxjerrë njerëzit nga ngushtësia e kësaj dynjaje, drejt hapësirave të kësaj bote dhe të ahiretit”. Kur dëgjoi këto fjalë, Rustumi u çudit pa masë, sesi një ushtar i thjeshtë arriti të dridh fronin e komandantit të një ushtrie gjigande. Kështu ishin këta njerëz. Ishin të thjeshtë, por shumë krenarë për fenë e tyre, prandaj Zoti i ngriti në këtë botë para miqve të tyre dhe përpara armiqve të tyre dhe me siguri do t'i lartësojë edhe në botën tjetër.

Krenohuni më këtë fe, se për Zotin nuk jeni nga ata që vidhni e që bëni korrupsion. Le të shikojnë kamerat e spiunët le të rrinë rresht pas jush. Ju keni frikë Zotin dhe çdo gjë që bëni apo çdo gjëje që i largoheni, e bëni këtë vetëm për Zotin dhe nuk rri ni me frikë se mos ju dalin të palarat. Ju nuk i tradhtoni familjet tuaja, sepse jeni besnikë në radhë të parë përpara Zotit e pastaj përpara familjeve tuaja. Sot ka shumë njerëz që kanë frikë shokun e tyre, i cili i di të palarat e tyre dhe mundohen ta mbajnë me të mira, që ai të mos i bëjë publike gabimet e tyre dhe ju betohem në Zot, se ia kanë frikën njëri – tjetrit.

Ndërsa ju myslimanë jini krenarë, se jeni njerëz që urdhëroni vetëm për mirë dhe ndaloni nga e keqja. Myslimanët i duan familjet e tyre dhe atdheun e tyre. Sikur ta dinte bota se çfarë ka në zemrat e myslimanëve, do të na kishin zili, se në zemrat tona ka vetëm dashuri për njerëzit, ose thënë më shkurt “Dashuri për të mirën dhe ndalim nga e keqja”. Prandaj jini krenarë për këtë fe, falënderoni Zotin që ju ka bërë pjesë të kësaj feje, se në këtë fe nuk hyn kush as me zor, as me imponim, por hyn vetëm ai që i përgjigjet ftesës së Zotit. Por e rëndësishme është, se më shumë se krenari me fjalë, duhet të jemi krenarë me veprat tona.

Zoti na bëftë krenarë me këtë fe dhe na bëftë shkak për lartësimin e kësaj feje. Zoti na ndihmoftë që ta jetojmë jetën me nder e sinqeritet si myslimanë, shpirtin ta dorëzojmë duke thënë shehadetin dhe të ringjallemi nën flamurin e profetit (a.s.).

Amin!..

PEMA

e krasitur

— Kybra Çoban —

Kopshtari kishte marrë gërshërët në dorë dhe me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë, ishte duke krasitur pemët. Duke sikur buzëqeshja e tij pasqyrohej edhe tek pemët... Në këto momente, djali që kishte dalë jashtë iu drejtua nënës i mërziut:

- Nënë! Ky kopshtari është duke u prerë pemët tona, shiko si i ka lënë qerose të gjitha!

Nëna buzëqeshi dhe e përqafoi të birin duke e inkurajuar me fjalët:

- Biri im i dashur, shiko me kujdes... Ato janë duke buzëqeshur. A nuk e shikon sa të lumtura që duken?

Fëmija foli i habitur:

ISLAMI ËSHTË FEJA E SË BUKURËS DHE SË MIRËS. NË NJË FAMILJE KU JETOHET SIPAS RREGULLAVE TË FESË, ALLAHU ZBRET LUMTURINË DHE QETËSINË. ALLAHU NA BËFTË NGA NJERËZIT QË JETOJNË SIPAS MORALIT ISLAM!

- Po, është e vërtetë. Duket sikur janë duke qeshur... Nënë, kopshtari është duke u prerë krahët, është duke i lënduar. Si mund të gëzohen pemët nga diçka e tillë?

Nëna filloi t'i shpjegonte të birit se ku qëndronte veçantia e gjithë kësaj:

- Shiko biri im, kopshtari e di shumë mirë punën e vet. Degët që ai pret janë pjesë që nuk i duhen më pemës, ato vetëm ndalojnë rritjen e saj. Kopshtari pret ato degë të kalbura, në mënyrë që pemët të rriten të shëndetshme dhe të japin fruta.

Fëmija shikoi një herë kopshtarin pastaj pemën me të cilën ai po punonte:

- E kuptova nënë e dashur. Kjo pemë është e lumtur, sepse tani është më e bukur dhe do të japë më shumë fruta. Kopshtari vetë është i lumtur, sepse po i bën mirë pemës...

Nëna e përkëdheli fëmijën dhe vazhdoi të fliste:

- A i kujton pemët e komshiut tonë, xhaxha Rifatit?

Fëmija mendoi disa çaste dhe u përgjigj:

- Po, i kujtoj. Pemët ishin të thara. Fytyrat e

tyre nuk buzëqeshnin kurrë, ishin shumë të mër-
zitura.

- Ato nuk kishin një kopshtar që të kujdesej për
to dhe të mund t'i shpëtonte nga mërzia e humbjes
së gjallërisë dhe bukurisë, - plotësoi nëna...

Fëmija po e dëgjonte nënën me shumë kujdes.
Ajo e kuptoi këtë gjë dhe shfrytëzoi rastin për të
vazhduar:

- A e kujton atë ditë kur babai kishte ndarë disa
para mënjanë për t'ua dhënë njerëzve në nevojë si
zekat... Motra jote e vogël ankohej duke kërkuar
arsyen e kësaj...

- Po e kujtoj, edhe unë jam zemëruar me babanë,
sepse i harxhonte paratë e tona...

Nëna buzëqeshi dhe vazhdoi të fliste:

- Biri im, pa mendo pak se për çfarë folëm pak më
përpara. Ti u mërzite për pemën që po krasitej...
A nuk mendon që kjo krasitje ishte e nevojshme
për pemën, sikur të mos ishte ashtu kopshtari nuk
do t'i priste degët e saj... E njëjta gjë ndodh edhe
me ne; Allahu (xh.sh.), nuk na kërkon asnjë gjë
që nuk na shërben. Allahu (xh.sh.), na urdhëron
që kush ka mundësi të japë zekat. Ja se çfarë ka
thënë Krijuesi ynë në Kuranin Famëlartë:

***“E që caktojnë një pjesë të pasurisë së tyre për
lypësin dhe për nevojtarin.”*** (Me'arixh, 24-25)

Ato para që babai i kishte ndarë për të varfrit
nuk ishin tonat, por e drejta e atyre njerëzve në
nevojë. Ashtu siç pema që hijeshohet nga krasitja,
ashtu edhe pasuria jonë begatohet nga dhënia e
zekatit. Sikur babai të mos ua jepte ato para nje-
rëzve në nevojë ne nuk do të kishim asnjë të mirë
prej tyre, sepse nuk na takojnë neve. Do të vinte
një hajdut për t'i vjedhur ose do të harxhoheshin
në shpenzime të kota. Sikur të ndodhte ashtu, ne
do të mërziteshim më shumë, kurse tani jemi të
lumtur, sepse kemi kryer detyrën që na ka caktuar

Allahu... E kemi ndarë pasurinë tonë me një njeri
në nevojë, e kemi gëzuar atë... Mos harro asnjë-
herë se çdo pasuri që harxhohet për hir të Allahut
e shton begatinë e familjes. Kujto pemët... Sikur
të mos e kishim dhënë zekatin pasuria jonë do të
ishte si një pemë e pakrasitur.”

Fëmija foli i emocionuar:

- E kuptova, e dashur nënë. Paratë e babait u
pastruan si një pemë e krasitur, vitin tjetër ato do
të jenë më të begata. Ne, kur i ndihmojmë njerëzit
që kanë nevojë, nuk duhet të mërzitemi por të
lumturohemi. A nuk është kështu?

Nëna buzëqeshi dhe i tha:

- Ashtu është, djali im i zgjuar. Çdo gjë që ne
zotërojmë është një amanet që Allahu na e ka
lënë për ta shfrytëzuar... Ne ia kemi lënë pemët
kopshtarit dhe ai kujdeset për to. Ai i krasit pemët
kur kanë nevojë ashtu siç japim ne zekatin. Në
qoftë se nuk e japim zekatin, do të bëhemi si pema
që nuk krasitet dhe kalbet.

Fëmija këtë herë foli me një ton të prerë:

- Nënë e dashur, a t'ua japim disa nga lojërat e
mia fëmijëve që nuk kanë lojëra; të luajnë edhe
ata.

Nëna iu përgjigj e kënaqur:

- Mirë biri im. Hajde futemi brenda dhe t'i fusim
në një kuti lojërat që ke dëshirë të dhurosh.

Nëna dhe fëmija u përqaftuan të gëzuar me njëri-
tjetrin dhe u futën brenda.

Islami është feja e së bukurës dhe së mirës. Në
një familje ku jetohej sipas rregullave të fesë, Alla-
hu zbret lumturinë dhe qetësinë. Allahu na bëftë
nga njerëzit që jetojnë sipas moralit islam!

Amin!





A ekziston te fëmija ynë vështirësia në të mësuar?

— Psik. Tuba Sëkmen —

“Gjendja që përjetojnë fëmijët, të cilët kanë vështirësi në të mësuar, është shumë e ngatërruar.”

Vështirësia në të mësuar është një problem, që ndikon më shumë negativisht në jetën arsimore të personave, e vështirëson të mësuarit në fusha të caktuara, por që nuk ka lidhje me shkallën e përgjithshme të inteligjencës së njeriut. Për personat që kanë vështirësi në të mësuar mund të jetë mjaft i vështirë dhe i ngatërruar leximi me dëshirë i disa faqeve të një libri, regjistrimi i një numri telefoni apo mbajtja e një shënimi në cepin e një libri. Edhe njerëzit që kanë shkallë të lartë inteligjence, mund ta përjetojnë këtë problem. Regjistrimi i diçkaje shumë të thjeshtë në kujtesën e tyre mund të kërkojë përpjekje dhe një kohë të gjatë.

“Vështirësia në të mësuar” ose siç njihet edhe me një emër tjetër “Çrregullimet specifike të të mësuarit”, janë një burim serioz stresi për nxënësit në periudhën e arsimimit. Për këta fëmijë, jeta arsimore dhe shkalla e suksesit akademik formon një

terren të rrëshqitshëm mendor. Sado që nxënësi të mundohet, nuk mund t’i bëjë ballë këtij problemi pa mbështetjen e specialistit.

Vështirësia në të mësuar është një gjendje e veçantë që zakonisht vërehet në një ose disa fusha së bashku. Të mësuarit e një fëmije me vështirësi dhe më ngadalë se moshatarët e tij në shkollën fillore, është një nga faktorët e parë dallues për diagnostikimin. Fëmija me çrregullime në të mësuar mund të hasë probleme në shkrim, lexim, në njërën, në të dyja ose në të tre fushat e aritmetikës. Në këto fusha vërehet një nivel përfitimi arsimor më i ulët se moshatarët e tij.

Nxënësit që kanë vështirësi në të mësuar, shpeshherë të lexuarit e kanë të vonuar dhe nuk mund t’i ndjekin rreshtat që lexojnë. Në kushte normale, kur një individ lexon disa rreshta, ashtu siç po bëni edhe ju tani, mund t’i ndjekë fjalët nga e majta në të djathtë pa u munduar shumë, por një njeri te i cili ekziston vështirësia në të mësuar, nuk e

ka qaq të lehtë t'i ndjekë fjalët njëra pas tjetrës. Prandaj, ndërkohë që vazhdon të lexojë, mund të kalojë lart ose poshtë rreshtit që lexon. Mund të "hajë" ndonjë rrokje gjatë leximit, të kalojë ndonjë shkronjë ose t'i ngatërrojë me njëra-tjetrën. Fjalën "lepur" mund ta lexojë "lepu", fjalën "derë", delë ose fjalën "mik", "mit" etj. Prandaj për ata që kanë vështirësi në të mësuar, seancat e leximit mund t'u bëhen një torturë, ndërsa të kuptuarit e atyre që lexojnë t'u kthehet në një ankth.

Disa fëmijë të tjerë, edhe pse të lexuarit e kanë në rregull, nuk mundën ta kopjojnë drejtë në fletore detyrën e shkruar në dërrasën e zezë. Detyrën e faqes 69, mund ta shënojnë si detyrë të faqes 96. Te fëmija që ka çrregullim në të shkruar (dizgrafi), evident është fakti se shkrimi i tij i palexueshëm është i njëjtë me gabimet që ka në shkrim. Ata që kanë vështirësi në të shkruar zakonisht, ndërsa shkruajnë, e kanë të vështirë ta vazhdojnë rreshtin e nisur, kalojnë poshtë ose lart rreshtit, harrojnë të lënë hapësirë mes fjalëve. Shkronjave si ç, i, ë, etj., mund të harrojnë t'u vënë pikat dhe bishtat. E kanë të vështirë të kujtojnë vazhdimin e shkronjave ose numrave. Për ta shkronja p, d, b, nuk janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ashtu siç përballemi në mënyrë të ndarë me problemet që shihen në fushën e leximit dhe shkrimit, këto dy probleme mund të shihen shpesh së bashku.

Vështirësia në të mësuar që dallohet në lidhje me aftësitë matematikore (diskalkuli) e vështirëson në të njëjtën mënyrë jetën shkollore të fëmijës. Në kushte normale, fëmija që ka marrë ose nuk ka marrë mësimë parashkollore, që ka arritur moshën për shkollën fillore dhe është rritur në qytet, për afërsisht nëntë numra i ka mësuar nga njerëzit përreth. Në sajë të tabelave që përdoren në jetën e përditshme, butonat e telekomandës, numrat e kateve në ashensor, numrat e dyerve, butonat e telefonit, fëmija që në moshë të hershme fillon t'i shohë numrat dhe me njohuritë që merr nga njerëzit përreth, mund ta bëjë lidhjen e këtyre numrave me emrat përkatës. Një fëmijë me diskalkuli mund të harxhojë një kohë më të gjatë për të mësuar kuptimin që shprehin numrat dhe shenjat matematikore. Pasi fillojnë shkollën, edhe pse e kuptojnë problemën në orën e matematikës, kur fillojnë të kryejnë veprimet, humbin në të.

Ndërkohë që nga individët normalë veprimet "9 + 3" dhe "6-3" mund të llogariten lehtë si "12" dhe "3", një fëmijë me diskalkuli të dy veprimet në pamjen e parë i koncepton të njëjta. Sidomos, ngaqë vështirësohen shumë në përlllogaritjen e orës, përjetojnë shumë probleme në lidhje me takimet.

Në çdo fushë që mund të ekzistojë vështirësia në të mësuar, prindërit të cilët kërkojnë t'i mbështesin fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë apo përsëritjen e mësimëve, lodhen dhe shqetësohen shumë. Në këto raste prindërit zakonisht thonë se fëmijët e tyre kanë problemin e përqendrimit, se nuk i kushtojnë vëmendje të plotë asaj që lexojnë apo shkruajnë. Por vështirësia kryesore që kalon fëmija, përveç mungesës së vëmendjes është çrregullimi i të mësuarit. Çrregullimi i të mësuarit është një gjendje e veçantë dhe e ndryshme nga mungesa e vëmendjes.

Çrregullimi në të mësuar është një çështje që e pengon shfaqjen e aftësive të fëmijët dhe e prish përshtatjen e tyre me ambientin përreth. Kjo gjendje, ashtu siç ndikon negativisht te vetëbesimi i fëmijës, bëhet shkak edhe për dobësimin e marrëdhënieve shoqërore. Fëmijët të cilët ndihen të përjashtuar nga shoqëria, me kalimin e kohës mund të përdorin lëndë të dëmshme dhe t'i drejtohen shoqërisë së gabuar.

Çrregullimi i të mësuarit ashtu si të gjitha shqetësimet e tjera mund të shihet në nivele të ndryshme. Çrregullimet që kanë nivel të ulët ose mesatar, mund të rregullohen duke u trajtuar. Ndërsa te çrregullimet e rënda trajtimi është shumë i rëndësishëm, por për fat të keq personi që ka çrregullim të rëndë të të mësuarit, nuk e ka shumë të lehtë të shpëtojë plotësisht nga ky çrregullim.

Dy kriteret më të rëndësishme të cilët realizojnë suksesin në trajtim, janë diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i vazhdueshëm. Sa kohë që vazhdon trajtimi, nxënësit me çrregullim mund ta vazhdojnë jetën shkollore pa u vështirësuar dhe nuk e humbin vetëbesimin.

Fillimi më herët i sezonit mësimor nga fëmijët, do të mundësonte që të konstatoheshin më herët fëmijët me çrregullime në të mësuar dhe do të kishte një përfitim të rëndësishëm në trajtimin e këtij çrregullimi.



Hudhra dhe Xhenxhefili

KURA E MREKULLUESHME PËR ZEMRËN DHE IMUNITETIN

Si hudhra, ashtu edhe xhenxhefili kanë vlera të mëdha kundër inflamacioneve.

TË DYJA KËTO PRODUKTE KANË QENË SUBJEKT STUDIMESH TË SHUMTA PËR VLERAT QË OFROJNË.

Hudhra dhe xhenxhefili janë dy produkte që përmbajnë vlera të shumfishta terapeutike dhe shëndetësore, për të mos përmendur këtu efikasitetin e tyre në recetat e gatimit.

Këto dy produkte kanë qenë subjekt studimesh, jo vetëm për efikasitetin në luftimin e infeksioneve, por edhe në parandalimin dhe zvogëlimin e inflamacioneve.

KUNDËR PLAGËVE

Hudhra lufton mykun, virozat dhe bakteret. E njëjta gjë vlen për xhenxhefilin.

Një studim i publikuar në “Journal of Microbiology” zbuloi se xhenxhefili kishte fuqi më të madhe kundër baktereve dhe ishte më efikas se sa antibiotikët tradicionalë që përdoren kundër dy lloje të infeksioneve bakteriale që hasen kryesisht në spitale.

KUNDËR INFLAMACIONIT

Si hudhra, ashtu edhe xhenxhefili kanë vlera të mëdha kundër inflamacioneve. Xhenxhefili përdoret shpesh për të trajtuar artritin, një sëmundje që shkaktohet nga inflamacioni.

Një studim i vitit 2013, i publikuar në revistën “Food and Chemical Toxicology” se alicina, sub-

stanca aktive e hudhrës ishte efikase në trajtimin e sëmundjeve kronike inflamatore.

KUNDËR QELIZAT MALINJE DHE TË VJELLAVE

Hudhra funksionon duke parandaluar zhvillimin e radikaleve të lira në disa mënyra.

Sipas kërkimeve ajo lufton bakteret dhe ndalon substancat që shkaktojnë mjaft probleme në organizëm. Për më tepër ajo promovon riparimin e ADN-së.

Xhenxhefili është përdorur prej kohësh në shumë kura bimore. Ai është mjaft efikas kundër problemeve me stomakun dhe të vjellave.

Xhenxhefili është i dobishëm veçanërisht për mbajtjen nën kontroll të refluksit të acidit dhe të vjellave.

PËR SËMUNDJET E ZEMRËS DHE TË FTOHTIT

Hudhra me xhenxhefilin ndihmojnë në parandalimin e sëmundjeve të zemrës, duke ulur tensionin e gjakut dhe ngadalësuar forcimin e arterieve.

Hudhra dhe xhenxhefili kanë aftësinë të parandalojnë të ftohtin dhe të forcojnë sistemin imunitar.

ÇAJI ME XHENXHEFIL DHE HUDHËR

Çaji me xhenxhefil dhe hudhër përdoret si një kurë natyrale kundër të ftohtit. Ai lehtëson këto simptoma, sipas Universitetit Clayton të Mijekësisë Natyrale.

Kërkimet tregojnë se përdorimi i këtij çaji ju jep

të gjitha avantazhet e hudhrës dhe xhenxhefilit si antibiotikë natyralë, kundër inflamacionit dhe për të lehtësuar dhimbjet e kokës apo të vjellat.

Gjithçka ju duhet është të shtoni tri hudhra të shtypura ndërkohë që përgatitni çajin tuaj të xhenxhefilit.

Çaji i përgatitur nga hudhra e njomë ose e thatë bashkë me xhenxhefilin përcjell shumë vlera shëndetësore.

Çaji i xhenxhefilit dhe hudhrës ka një shije të mirë, veçanërisht nëse kombinohet me mjaltë dhe limon. Ai është një alternativë e mirë për ata që vuajnë nga virozat ose i ftohti.

Në një gotë ujë zieni një copë të vogël rreth 1 cm xhenxhefil dhe 1-2 thelbinj hudhër.

Me xhenxhefilin dhe hudhrën mund të përgatitni një kombinim të ngjashëm me pastën, e cila përdoret edhe në gatim si salcë.

Ajo është e shëndetshme dhe shumë e shijshme në shumë dimensione. Nëse e përdorni qoftë për

marinim ose thjesht për aromë, gatimet tuaja do të marrin një nuancë tjetër aromatike. Mbi të gjitha përveç shijes, organizmi përfiton edhe efektet mbrojtëse.

Më poshtë do të gjeni një metodë të thjeshtë të përgatitjes dhe ruajtjes e salcës së hudhrës dhe xhenxhefilit

PËRBËRËSIT:

250 gramë xhenxhefil (të qëruar dhe të prerë hollë)

250 gramë hudhër (të qëruar dhe të prerë hollë)

1 lugë çaji me kripë

2-3 lugë gjelle me vaj ulliri cilësor

Udhëzimet: Përdorni një mikser ose shtypini përbërësit së bashku në havan deri sa t'i ngjasojë një salcë pesto. Hidhjeni salcën në një enë qelqi dhe ruajeni në frigorifer. Salcën mund ta përdorni në supë, gatimet me oriz, makarona e të tjerë. Organizmi juaj do t'ju jetë mirënjohës.

Hurmat e para farëzeza

PSE JU DUHEN PËR SHËNDETIN

Hurmat kultivohen anembanë Shqipërisë, veçanërisht në Berat, Përmet, Elbasan, Pogradec, por edhe në Lezhë, Tiranë etj.

Shqiptarët janë të çmendur pas hurmave, me apo pa fara qofshin ato. Të gjithë janë të mendimit që hurmat kanë qenë pjesë e traditës sonë prej shekujsh të tërë.

Pemët e këtyre hurmave gjenden në çdo rrugicë, shtëpi përdhese, lagje, pemishte apo edhe bahçe.

Hurmat e para farëzeza sapo kanë dalë në treg me një çmim prej 170-200 lekë për kg.

Hurmat kultivohen anembanë Shqipërisë, veçanërisht në Berat, Përmet, Elbasan, Pogradec, por edhe në Lezhë, Tiranë e gjetkë.

Emri botanik i hurmave është *Diospyros* që përkethehet "Fruti i Perëndive" dhe ky emërtim i shkon shumë për shtat.

Ky frut është kombinimi perfekt një fruti të plotë dhe me shumë lëng. Është i ëmbël, por jo trullësës që do të thotë se qiellzës suaj do t'i pëlqejë shija intriguese e hurmës.

Të ngrira, të ftohta, të freskëta, cilindo variant të hurmave të zgjidhni, kuleta juaj nuk do të zbrazet ndjeshëm.

Hurmat vijnë në varietete shumë të larmishme. Ato i gjeni në ngjyrë të verdhë deri tek ngjyra gështenjë. Ato kanë forma dhe variante të rumbullakëta, por asnjëherë njësoj.

Llojet më kryesore të hurmave janë ato farëbardha dhe farëzeza. Këto të fundit mund të shijohen kur janë krokante si mollët, por edhe të buta si pjeshkët.

Megjithatë nëse je i paduruar dhe zgjedh të provosh hurmat farëbardha kur janë të forta, atëherë do të kesh ndjesinë e fortë e të thatë në gojë.

Kur këto hurma janë të pjekura plotësisht, atëherë lëkura e tyre kthehet në një enë të mirëfilltë për një tul aq të mirë e aq të ëmbël sa i ngjan një reçeli të trashë. Vetëm atëherë ju do të keni mundësi të kuptoni se çfarë do të thotë të hash "Frutin e Perëndive".

Ka njerëz që preferojnë t'i hanë këto hurma të freskëta. Disa të tjerë preferojnë t'i ruajnë në frigorifer përgjatë gjithë vitit.

“BAYRAKTAR” PREZANTON PROTOTIPIN E AUTOMJETIT FLUTURUES

Shefi i kompanisë teknologjike turke “Bayraktar”, prodhuesit turk të dronëve, mjeteve fluturuese pa pilot, shpalsi prototipin e një automjeti fluturues që, nëse materializohet, do të ishte i pari i këtij lloji në vend.

“Kompania ka punuar në vizatimin teknik, dizajnimin, testimin, detajimin dhe prodhimin e këtij prototipi për tetë muaj”, njoftoi Selçuk Bayraktar në rrjetet sociale.

Automjeti fluturues i quajtur “Cezeri” pritet të kompletohet këtë shtator dhe mund të shfaqet në

Teknofest, festivalin më të madh në Turqi të hapësirës ajrore dhe teknologjisë.

Automjeti ka marrë emrin e inxhinierit të famshëm mysliman Al Jazari, i cili jetoi mes viteve 1136 dhe 1206.

Bayraktar gjithashtu nisi një anketë për të zgjedhur njërën prej katër ngjyrave për prototipin.

Kompania “Bayraktar”, e themeluar në vitin 1984, prodhon dronë të armatosur dhe të paarmatosur, sisteme kontrolli, simulatorë dhe sisteme për avionë.

SONDA KINEZE ZBULON NJË SUBSTANCË MISTERIOZE NË HËNË

Një substancë xhelatinoze misterioze, e ndritshme dhe me ngjyrë të pazakontë, u identifikua në anën e fshehur të Hënës, në bazën e një krateri të vogël nga sonda kinez Yu-Tu 2, që ka eksploruar tokën hënore që nga janari i kaluar.

Zbulimi misterioz daton në 28 korrikun e kaluar, kur Yu-Tu 2 ishte gati të fillonte procedurat e zakonshme për të mbrojtur qarqet e saj delikate nga nxehtësia e ditës së gjatë hënore (e cila zgjat rreth dy javë tokësore).

Pasi teknikët në qendrën e kontrollit të hapësirës ajrore të Pekinit ishin gati të dërgonin komandën e mbylljes, diçka e pazakontë do të dilte nga pamjet më të fundit të panoramës së marrë nga Yu-Tu

2: një krater i vogël që përmbante një material të çuditshëm.

Pas një takimi të shkurtër, teknikët kinezë vendosën ta mbanin aktiv roverin për një kohë më të gjatë, në mënyrë që ta bëjnë atë të lëvizë drejt perëndimit për të studiuar më mirë materialin misterioz falë përdorimit të spektrometrave infra të kuqe.

Ende nuk ka një shpjegim zyrtar (si dhe pamjet, të cilat nuk janë transmetuar akoma nga agjencia kineze hapësinore CNSA), por hipoteza më e besueshme është se është një material qelqi, i shkrirë nga nxehtësia e ndikimit të meteorit që do të kishte formuar kohët e fundit kraterin e vogël.



ZBULOHET "ÇELËSI" QË PËRQENDRON VËMENDJEN NË TRU

Identifikohet në tru "çelësi" nervor që na lejon të përqendrojmë vëmendjen.

Ai formohet nga tufa fibrash që lidhin korteksin cerebral ballor me strukturën themelore të bërtamave të bazës, sipas zbulimit të Universitetit të Milanos në bashkëpunim me institutin "IRCCS Humanitas".

Rezultatet, të botuara në revistën "Brain", do të ndihmojnë që mjekët kirurgë të jenë gjithnjë e më të saktë në ndërhyrjet në tru për të shmangur dëmtimin e rajoneve vendimtare gjatë heqjes së tumoreve.

Për të gjetur ndërprerësin e vëmendjes, studiuesit përdorën kombinimin novator të dy teknikave të hetimit: hartografia intraoperative e trurit dhe analiza e neuroimaging.

Falë stimulimit elektrik të drejtpërdrejtë të trurit, të kryer gjatë operacionit për heqjen e tumorit të trurit në pacientët zgjuar të përfshirë në testet neuropsikologjike, studiuesit ishin në gjendje të identifikonin në lobet frontale vendet e sakta të materies së bardhë të vendosur nën korteksin, që janë përgjegjëse për aftësinë për të përqendruar vëmendjen në një karakteristikë specifike të një stimuli vizual.

IDENTIFIKOHEN MOLEKULAT QË MUND TË NGADALËSOJNË PARKINSONIN

Përparimi i sëmundjes së Parkinsonit mund të ngadalësohet falë resolutivës, molekula të prodhuara nga trupi ynë për të shuar proceset inflamatorë dhe për të riparuar indet e dëmtuara nga ky proces, sipas studimit të ri të botuar në "Nature Communications" nga studiues të Universitetit të Romës "Tor Vergata", fondacioni "Santa Lucia IRCCS" dhe Universiteti Bio-Mjekësor i Romës.

Studiuesit zbuluan se pari një nivel të reduktuar të një resolvine specifike, Resolvina D1, te pacientët që vuanin nga kjo patologji dhe më pas ndërhyrje në mënyrë eksperimentale në modele laboratorike për të ribalancuar praninë e kësaj molekule të rëndësishme në organizëm.

Grupi studiues ishte në gjendje të ngadalësonte procesin neurodegenerues që karakterizon sëmundjen e Parkinsonit.

"Studimi na lejo të demonstrojmë se proteina alfa-sinuclein, e njohur për rolin e saj kryesor në zhvillimin e sëmundjes së Parkinsonit, shkakton një mosfunksionim të neuroneve dopaminergjike. Pasojat janë çrregullime motorike dhe konjitive, por edhe një rritje e neuroinflamacionit, të shoqëruara me nivele të reduktuara të resolvines D1 që kemi vërejtur në gjak te pacientët me sëmundjen e Parkinsonit", shpjegon Nicola Mercuri, profesori i Neurologjisë në Universitetin e Romës.



Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“A nuk e vëren ti,
se Allahun e lavdëron
çdo krijesë që ndodhet
në qiej dhe në Tokë,
madje edhe shpezët
krahëhapur?!
Çdokush e di se si t'i falet
e ta lavdërojë.
Allahu e di mirë
çfarë bëjnë ata.”

(Nur, 41)